




Hëna e Re


Viti XXXV | Nr.373 | Tetor 2022 | Rebiul Evvel - Rebiul Ahir 1444 | Çmimi 50 den



**GOSTIVAR: "MIRË SE ERDHE,
O RESULTALL-LLAH"**

**PËRJETIME QË DUA T'I
PREK (HYSEIN RIZAI)**

**PRANOHEN STUDENTËT
TANË NË 'EZ'HER'**



KËSHILLI EVROPIAN PËR FETVA DHE GJURMIME: AVOKAT NË EVROPË

Pyetje: A lejohet të punoj në gjykatë, apo si ndihmës avokat, në Evropë, sipas ligjeve dhe sistemit evropian?

Përgjigje: Në parim, lejohet puna si avokat apo ndihmës avokat, ngase kjo punë, në esencë, nuk është e ndaluar. Në të drejtën islame, kjo punë e ka statusin e autorizimit për rast gjyqësor para gjykatësit.

Për lejin e kësaj veprimtarie mund të merret si argument transmetimi që përcillet nga Buhariu dhe Muslimi në Sahihet e tyre, se i dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: “Vërtet, unë jam njeri, dhe ju parashtroji konteste tek unë për t’i zgjidhur. Ndodh që disa prej jush të jenë më elokuentë në paraqitjen e argumenteve të tyre sesa disa të tjerë, dhe unë gjykoj në bazë të asaj që e dëgjoj. Në favor të kujt gjykoj, për një të drejtë që, në fakt, nuk i takon, le ta dijë se atij i ndaj një copë zjarri.”

Pra, avokati apo ndihmësi i tij i sqaron gjykatësit të vërteta dhe fakte se personi që e ka autorizuar nuk mund t’i shprehë ato, për shkak se nuk ka aftësi shprehjeje, apo nuk e di të drejtën që i takon me ligj.



Avokati apo ndihmësi i tij shpërblehen për këtë veprim, ngase nga njëra anë, e ka ndihmuar një person të cilit i është bërë padrejtësi që ta arrijë të drejtën e tij dhe, nga ana tjetër, e ka ndihmuar gjykatësin që të gjykojë me drejtësi.

Kjo që e bën avokati apo ndihmësi i tij është kontribut për mirësi dhe kthim i të drejtave të personat që u takojnë. Personi që e pranon këtë punë obligohet që të jetë i sinqertë dhe ta përfaqësojë vetëm atë që është e drejtë; të mos pranojë të mbrojë njerëz që bëjnë padrejtësi, apo të ndihmojë që autorizuesi i tij të marrë diçka që nuk është e drejtë e tij, apo të përpiqet ta shfaqë dikë, për të cilin e di se është fajtor.

Ebu Davudi, Ahmedi dhe Ibn Maxheh kanë transmetuar prej Abdullah ibn Omerit se i dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka

thënë: “Kush ndihmon pa të drejtë dikë për ndonjë kontest të ngritur, e ka merituar hidhërimin e Allahut.”

Pagesa që e merr avokati dhe ndihmësi i tij është e lejuar, ngase juristët islamë kanë miratuar se i autorizuar për një kontest e ka të lejuar kompensimin që e merr, nëse mbron një çështje të drejtë; ndërkaq, e ka të ndaluar kompensimin që merr nëse mbron një çështje të padrejtë.

Për të gjithë vlejnjë fjalët e të Lartmadhërishtit: “Ja, ju jeni ata që i mbrojtët (gënjeshhtarët) në jetën e kësaj bote. Kush do të polemizojë me Allahun për ta Ditën e Gjykimit, apo kush do t’i marrë në mbrojtje?” [En Nisaë: 109]

Shih: Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime <https://www.e-cfr.org/en/Fetvaja> (5/33)

Prej arabishtes: Bashkim Aliu (për HeR)

SIKUR E VËRTETA ËSHTË PËR DIKË TJETËR DHE JO PËR NE...

Enes ibn Maliku përcjell se pejgamberi Muhamed (a. s.), me një rast, u mbajti shokëve të tij të tubuar fjalimin vijues:

“O njerëz, sikur vdekja në këtë botë i është caktuar dikujt tjetër, e jo neve; sikur e vërteta është për dikë tjetër, e jo për ne.

A thua se ata me të cilët ndahemi pak para çastit të vdekjes janë udhëtarë, të cilët së shpejti do të kthehen? Ne i lëmë në varret e tyre, kurse trashëgiminë prej tyre e shfrytëzojmë, thujse nuk do të vdesim kurrë. E harrojmë çdo këshillë. Ndi-hemi të sigurt nga çdo fatkeqësi.

Lum kush preokupohet me mangësitë e veta dhe nuk i humton mangësitë e njerëzve të tjerë!

Lum kush e ndan pasurinë e fituar me nder. Lum kush rri me njerëzit e ditur e të urtë dhe kush shoqërohet me botën e varfër e të mjerë!

Lum kush ka karakter të mirë dhe ndërjegje të pastër dhe lum ai nga e keqja e të cilit janë të sigurt njerëzit tjerë!

Lum kush e ndan tepricën e pasurisë së tij, kush përmbahet nga të folurit e tepërt, kush i përmbahet Sunnetit (rrugës së pejgamberit Muhamed a. s.), si dhe ai që u ruhet risive në fe.”



(Dorian Demetja: Marrë nga libri "Hytbe të zgjedhura të Muhamedit (a. s.)" të dr. Jusuf Ramiqit, botim i KMSH-së/në bashkëpunim)

MËRGIMI, KJO PLAGË E RËNDË!

Shikuar përmes prizmit historik, populli shqiptar - pavarësisht, me dhunë apo me vetëdëshirë, apo nga motive të tjera - gjithnjë ka përjetuar dyndje, migrime apo shpërngulje. Që në kohërat më të hershme, për ta siguruar kafshatën e gojës, shqiptarët kanë migruar në Misir apo në Egjiptin e sotëm dhe në vendet tjera të Lindjes së Mesme, që më vonë të marrin rrugën për në vendet edhe më të largëta, si: Australi, Amerikë e Kanada.

Mjerisht, shqiptarët, respektivisht popullata myslimane e trojeve të Ballkanit, në lëkurën e vet ka përjetuar eksode të dhunshme dhe të projektuara nga armiqtë e tij, siç ishin projektet serbo-jugosllave për dëbimin e shqiptarëve nga viset e tyre autoktone në vitet 1939-1944, ku masivisht, nën presione të ndryshme, shpërnguleshin në Turqi.

Ekzistenca, dëshira për një jetë më të mirë, e ka detyruar popullatën tonë që të marrë rrugët e kurbetit gjithandej. Në pesë dekadat e fundit destinacioni i kurbetçinjve ishin shtetet perëndimore, respektivisht Gjermania, Austria, Zvicra, Italia etj. Me kalimin e kohës dhe me krijimin e kushteve, kurbetçinjët filluan që t’i marrin edhe familjet e tyre në kurbet dhe, dalëngadalë, kjo dukuri erdhi dhe u shndërrua në migrim ekonomik, migrim ky që tani është kthyer në një plagë me pasoja të mëdha për shoqërinë tonë.

Gjatë viteve të fundit, fenomeni i largimit nga vendlindja drejt vendeve perëndimore, me motiv për një jetë sa më të mirë ekonomike, për çdo ditë po na i merr të rinjtë dhe njerëzit e kualifikuar dhe të arsimuar. Tanimë pasojat e kësaj dukurie janë evidente nëpër shkollat, qofshin ato fillore apo të mesme – ku spikat numri më i vogël i nxënësve; nëpër xhami – ku po ashtu numri i xhemateve ka shënuar rënie; nëpër mejtepe – me numra në rënie të nxënësve që e ndjekin mësimbesimin; kështu që, përgjithësisht, lagjet tona, vendbanimet tona, karakterizohen me shtëpi të mbyllura, me prindër të vetmuar e kështu me radhë.

Vërtet, “migrimi ekonomik” është një dukuri që kërkon një qasje akute dhe serioze - në radhë të parë, nga institucionet shtetërore, të cilat e kanë për obligim që popullatën t’i krijojnë kushte për ekzistencë dhe jetë më të mirë, duke i luftuar dukuritë negative në shoqërinë tonë, dukuri të cilat e nxisin popullatën që të largohet nga këto troje. Në këtë drejtim, kontributin e vet mund ta japë edhe sektori privat, duke punësuar sa më shumë të rinj. Po ashtu, kontribut për ta ndalur largimin masiv të popullatës sonë mund të japë dhe media, duke agjitur mbi rëndësinë e të jetuarit dhe të vepruarit në vendlindje.


Edhe Bashkësia Fetare Islame e vendit tonë është e gatshme që ta japë kontributin e saj, duke përkrahur projektet që kanë të bëjnë me ndërprerjen e shpërnguljes ekonomike në masë të popullatës së këtij nënqielli.

Në anën tjetër, si rezultat i këtij migrimi ekonomik, në shtetet perëndimore është krijuar e ashtuqjtura “mërgata shqiptare”, e cila ka nevojë për organizim të jetës fetare në shoqëritë ku jeton dhe vepron. Popullata në mërgim nuk mund të lihet në mëshirën e fatit, sepse pa ndonjë organizim të mirëfillt të jetës fetare-kombëtare, identitetit të njerëzve tanë i kërcënohet asimilimi.

Për ta mbrojtur mërgatën tonë nga asimilimi, kontribut të madh japin Qendrat Kulturore Fetare, respektivisht Xhamitë, ku në mejtepet e tyre, përpos mësimbesimit, fëmijët shqiptarë mësojnë dhe gjuhën shqipe. Po ashtu, këto qendra japin kontributin e tyre në integrimin e mërgatës në shoqëritë përkatëse. Në këtë drejtim, roli i nëpunësve fetarë është shumë i madh. Ata përmes ligjëratave nëpër xhami i mësojnë besimtarët për vlerat e tolerancës, për vlerat e të respektuarit të besimeve të tjera, për vlerat e bashkëjetesës, për vlerat e Islamit dhe të prezantimit të tij gjithandej etj.

Revista “Hëna e Re”, si gjithnjë, është e gatshme që të japë kontributin e vet si në ndalimin e migrimit ekonomik në masë, ashtu dhe në mbrojtjen e identitetit të popullatës sonë brenda dhe jashtë trojeve arbërore.

Q. Osmani



NJË DITË GËZIMI PËR GJITHË BFI-në



Më 3 tetor, 2022, startoi viti i ri akademik në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup (FSHI), thuhet në njoftimin e BFI.

Në solemnitetin e fillimit të vitit të ri akademik 2022/23 ishte i pranishëm edhe Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Ishte kjo një ditë gëzimi për gjithë BFI-në dhe strukturat e saj.

Prezent në këtë solemnitet ishin drejtori i SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup, prof. Ibrahim ef. Idrizi, Myftinjtë e Myftinive: prof. dr. Qani ef. Nesimi (Tetovë), h. Sabahudin ef. Zendeli (Gostivar), h. Qamil ef. Rushiti (Kërçovë), mr. Salim ef. Sulejmani (Strugë), h. Amit ef. Rasimi (Manastir), stafi akademik dhe shumë studentë të këtij institucioni të lartë arsimor.

Fjalën hyrëse e mbajti Dekani i Fakultetit, prof. dr. Shaban Sulejmani, i cili i përshëndeti të pranishmit, duke uruar vitin e ri akademik dhe njëherësh dha porosinë e tij dedikuar stafit akademik dhe studentëve në përgjithësi.

Në fjalën e tij, Reis'ul-Ulemaja për-

shëndeti të pranishmit dhe uroi vitin e ri akademik, duke sugjeruar se në kohën në të cilën jetojmë kërkohet përkushtim i plotë dhe precizitet në zhvillimin e procesit mësimor akademik, mbathje dhe absorbim të njohurive shkencore që i parasheh Statuti dhe përforsim të vlerave të metodologjisë së punës dhe të strategjisë në veprim.

Më pas, studentëve të rinj të FSHI iu ndanë indeksat, me dëshirat më të mira për suksese në studime.

Urime fillimi i vitit të ri akademik 2022/23 dhe - Zoti e bekoftë këtë institucion të lartë arsimor-shkencor, thuhet në njoftimin e BFI.

Të njëjtën ditë, në platformat elektronike të BFI-së është emetuar një video audiovizive, në kohëzgjatje prej 3:43 minutave, ku Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Drejtori i Përgjithshëm i Medresesë Isa Beu prof. Ibrahim ef. Idrizi dhe Dekani i FSHI prof. dr. Shaban Sulejmani, përveç tjerash, deklarojnë se nxënësit e diplomuar në SHMI "Medreseja Isa Beu" mund të pranohen në universitetet e vendit.

ADNAN SKËNDERI MAGJISTRON NË UNIVERSITETIN TRAKYA

Vazhdojnë studimet në shkencat islame: më 5 tetor, 2022, studiuesi Adnan Skënderi ka mbrojtur me sukses temën e magjistraturës në Universitetin Trakya në Turqi.

Falënderimet i takojnë vetëm Allahut (xh. sh.), që ma mundësoi të mbroj temën e magjistraturës me titull "Vehbi Sulejman Gavoçi, jeta dhe veprat në lëmin e fikhut", ka shkruar ai në faqen e vet në Facebook.

Mbrojtja e temës u bë nëpërmjet programit Microsoft Teams, para Komisionit të përbërë nga:

doc. dr. Fatih Yakar (mentor), doc. dr. Ömer Yılmaz dhe doc. dr. Abdullah Taha İmamoğlu.

Pas prezantimit të temës, është marrë pëlqimi unanim nga ana e Komisionit dhe është dhënë titulli "Magjistër në shkencat islame".

Për këtë sukses, thotë mr. Adnan Skënderi, fillimisht falënderoj Allahun (xh. sh.), më pas familjen time, e cila gjatë gjithë kësaj periudhe më ka përkrahur, po ashtu dhe miqtë e mi, të cilët më kanë ndihmuar deri në përfundim të temës. Allahu (xh. sh.) i shpërbleftë me të mira ishallah. Fjala jonë e fundit për çdo sukses qoftë fjala e Allahut (xh. sh.): "Ndërsa suksesi im varet vetëm nga Allahu. Tek Ai mbështetem dhe Atij i drejtohem." (Hud: 88). /12.10.2022

NJË STUDENTE NGA STRUGA

Ermelinda Maksuti nga fshati Kalisht, falë Zotit, prej sot fillon studimet në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup, ka njoftuar Sektori i Femrës i Myftinisë së Strugës më 3 tetor, 2022.

Ajo sot mori dhe indeksin, të cilin ia dorëzoi Myftiu i Strugës mr. Salim ef. Sulejmani.

Studentes i dëshirojmë mësim të mbarë, me shumë suksese dhe i bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që ta ndihmojë në këtë rrugëtim kaq të rëndësishëm për të dhe për nevojat e Strugës me rrethinë për teologe, e cila do të bëjë shpjegimin dhe sqarimin e duhur të fesë islame në këtë rajon, thuhet në njoftimin e Sektorit të Femrës të Myftinisë së Strugës.



POZITA E MËSUESIT SIPAS ISLAMIT

Përgjegjësia që kërkon Islami është e dyfishtë - para shoqërisë dhe para kombit, sepse ato shpresojnë se bartësit e arsimit do të ndërtojnë një brez të ri, me familje të forta stabile, me vendosmëri të fortë, me opinione të shëndosha, me edukatë solide dhe me njohuri koherente.



**Shkruan: Jusuf Zimeri
(Enkas për HeR)**

"Thuaj! A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë; vërtet, këtë e kuptojnë vetëm mendjet e ndritura." (Sure Ez-Zumer: 9)

Transmetohet nga Ebu Umame el-Ba-

hiliju se Pejgamberi (a. s.) ka thënë: "Vërtet Allahu, engjëjt e Tij, banorët e qiejve dhe të tokës, madje edhe buburrecat në vrimën e saj, edhe peshkaqeni në det, luten për mëshirë për atë që i mëson njerëzit në të mirë." (Termidhiu)

Sipas konceptit dhe mësimave islame, mësuesit identifikohen si kategoria më e

ngritur njerëzore, pas pejgamberëve. Mësuesit janë ndërtuesit e brezave, të shoqërive dhe të kombeve; ndërtuesit e ardhmërisë së shëndoshe, sepse në duart e tyre lindin, zbulohen dhe rriten e zhvillohen grupet e arsimuara të shoqërisë njerëzore.

Islami diturinë e konsideron nga vler-

rat më prioritare dhe më fisnike, sepse dituria-shkenca është bazamenti i shëndoshtë i çdo qytetërimi dhe ndërtimi që i ngre lart vlerat - jo vetëm të individit, por dhe të mbarë shoqërisë njerëzore. Dituria, përveç se është themeli i prosperimit dhe rruga pa alternativë e avancimit dhe ngritjes së mentalitetit të popujve dhe kombeve në jetën e kësaj bote, ajo është edhe drita që ndriçon rrugën për të ecur njerëzimi, është drita që ndriçon mendjen e njerëzve për të dalë nga errësira e injorancës, rruga që shpion drejt shpëtimit në jetën e botës tjetër.

LEHTËSOHET RRUGA PËR NË XHENET

Këtë shumë qartë na e përshkruan i dërguari i Allahut (s.a.v.s.) në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejreja, ku Pejgamberi (a. s.) ka thënë: *“Kush ecën në një rrugë për të kërkuar dituri, Allahu do t’ia lehtësojë rrugën për në Xhenet.”* (Muslimi) Në transmetimin nga Ebu Dardai, ndërkaq, ka thënë: *“E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: Kush e ecën një rrugë për të kërkuar diturinë, Allahu do t’ia lehtësojë atij rrugën për në Xhenet. Pastaj, edhe engjëjt i hapin krahët e tyre për kërkuesin e diturisë në shenjë kënaqësie për atë që e bëjnë; vërtet, për dijetarin kërkojnë falje çka ka në qiej e në tokë, madje edhe peshku në det. Vlera e dijetarit në krahasim me të paditurin (robin) është si vlera e hënës me yjet. Dijetarët vërtet janë trashëgimtarët e pejgambereve; e pejgamberët nuk kanë lënë trashëgim as dinarë, as dërhem, përveç diturisë si trashëgim. Kush e merr atë, ka fat të bollshëm.”* (Ebu Davudi dhe Termidhiu)

Çështja e parë dhe shumë esenciale, që detyrimisht duhet ta kuptojë çdo mësues dhe çdo kush që është i kyçur në procesin e sistemit edukativo-arsimor, është që ai ta ndjejë, ta dojë dhe ta kuptojë nderin, vlerën dhe rëndësinë e këtij profesioni. Nëse arrin ta kuptojë këtë nder, ta dojë dhe të jetojë me të, atëherë ai vepron me entuziazëm dhe moral të lartë, i motivon edhe të tjerët që të shtojnë zellin dhe dashurinë ndaj dijes. Një mësuesdhënësi që ndjen dhe e kupton thellë nderin e mësimitdhënies, pa dilemë është një mësues i suksesshëm, është një model për nxënësit e tij në çdo gjë - është model për fjalorin e tij, është model për moralin e tij, është model për veshjen dhe sjelljen e tij; pra, për shfaqjen e vlerave të virtyshme. Me fjalët e tij të bukura dhe me sjelljen e tij, ai duhet të reflektojë shembëlltërinë në shoqërinë ku jeton. Ai duhet

të dijë se veprat, sjelljet dhe vlerat e një mësuesi të suksesshëm nuk përfundojnë thjesht me vdekjen e tij, sepse ato ngelin si fener ndriçues edhe te gjeneratat që pasojnë. Këtë e ka dëshmuar historia njerëzore, dhe e kanë vërtetuar dijetarët gjeneratë pas gjenerate. Njëri nga dijetarët e mëdhenj islam, Muhamed ibni Sirini, kur e përshkruan personalitetin e mësuesit të tij, të imam Malikut, thotë: *“Ne mësonin udhëzime, moral të lartë nga mësuesi ynë, ashtu siç mësonim diturinë.”* Nxënësi tjetër, po ashtu i imam Malikut, thotë: *“Kam mësuar më shumë nga sjelljet e imam Malikut sesa nga dituria e tij.”*

Islami është fe dhe sistem, është fe e dijes dhe e shkencës, kurse ithtarët e saj detyrimisht duhet të jenë ithtarë të lapsit dhe të leximit, të asaj që shkruan lapsi; fe, që fillon me imperativin e leximit, si arma më e fuqishme për të luftuar injorancën dhe ngritjen e shoqërisë. Shpallja filloi me imperativin për lexim, kurse përfundoi me tërheqjen e vëmendjes për përgjegjësi, për veprim apo dhe për mosveprim. Prandaj, Islami e obligon mësuesdhënësin që të ndiejnë se nxënësit janë amanet në duart e tyre. Ai nuk guxon ta humbë kohën me çështje joproduktive, që nuk janë në interes të nxënësit, sepse koha e përcaktuar për nxënësit është e drejtë e tyre dhe nuk guxon askush të cenojë të drejtën e tyre. Duhet të kuptojnë dhe të jenë të vetëdijshëm se për mos ruajtjen dhe këtij amaneti, do të pyeten dhe do të bartin përgjegjësi para Zotit të Plotfuqishëm. I dërguari i Allahut (xh. sh.) këtë përgjegjësi e përshkruan duke thënë: *“Secili prej jush është rojtar dhe përgjegjës për atë që e ruan”,* prandaj edhe mësuesdhënësi është përgjegjës për nxënësit e tij.

Detyrimet për respekt gjatë zhvillimit të procesit edukativo arsimor janë të dyanshme - si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësi. Vlerësohet kështu, ngase arsimimi dhe dija nuk kanë limite ku përfundon nxënia e diturisë, sepse njeriu gjatë tërë jetës së tij, nga lindja e deri në vdekje, duhet të trajtojë veten si kërkues i diturisë. Respekti dhe nderi i nxënësvë ndaj mësuesit nuk mund të jetë më i vogël sesa i mësuesit ndaj nxënësit. Kështu e kuptuan dijetarët eminentë këtë çështje, e këtë më së miri e konkretizon praktika e dijetarit dhe juristit të madh islam, imam Ebu Hanifes, i cili gjithmonë kishte kujdes që këmbët e tij të mos i shtrijë në drejtim të Kibles (Qabesë) dhe në drejtim të shtëpisë së mësuesit të tij.

Detyrat e mësuesit dhe tërë procesin

edukativo-arsimor Islami përveç se e konsideron nder dhe vlerë, por njëkohësisht për bartësit e këtij procesi të rëndë e të ndërlikuar, por edhe të shpërblyer, kërkon edhe përgjegjësi. Kërkon përgjegjësi, sepse djemtë dhe vajzat tona, rinia jonë, janë shtylla kurizore dhe zemra e funksionimit të shoqërisë sonë.

PËRGJEGJËSI PËR KRIJUESIT ABSOLUT

Përgjegjësia që kërkon Islami është e dyfishtë - para shoqërisë dhe para kombit, sepse ato shprejnë se bartësit e arsimit do të ndërtojnë një brez të ri, me familje të forta stabile, me vendosmëri të fortë, me opinione të shëndosha, me edukatë solide dhe me njohuri koherente. Përgjegjësia tjetër, ndërkaq, është para Krijuesit absolut, i cili përcaktoi shpërblime të mëdha për ata që e aplikojnë këtë proces në jetën e kësaj bote. S’do mend se kjo kërkon përgjegjësi për ata që e nënvlerësojnë dhe e keqpërdorin procesin edukativo-arsimor për interesa të tyre mediokre.

Përgjegjësia e arsimit të shëndoshtë me vlera shkencore e morale, edhe pse në shikim të parë bie drejtpërdrejt mbi mësuesdhënësit, është edhe përgjegjësi kolektive-shoqërore. Përgjegjësia kryesore e drejtpërdrejtë reflektohet te mësuesdhënësi, sepse ai është hallka kryesore e procesit, e kjo vetvetiu e rrit vlerën e tij, por në realitet kësaj përgjegjësie nuk mund t’i ik askush nga shoqëria, madje as prindërit dhe familja, sepse familje model është ajo që bashkëpunon me mësuesin dhe me shkollën. Me theks të veçantë, përgjegjësia bie mbi njerëzit e burokracive, të byrove arsimore, ku hartohen plane dhe programe për sistemin edukativo- arsimor.

Kjo përgjegjësi rritet edhe më, kur kemi parasysh zhvillimin dhe revolucionin teknologjik, materializimin e çdo sendi, përfshi dhe dijen, moslidhjen e kurrikulave me epokën e dijes dhe me jetën faktike, që kërkon menaxhimin e aftësive të nxënësvë. Dikur në shoqërinë islame qendrat edukativo-arsimore (shkollat) dhe universitetet ishin qendra garuese mes vete, krenoheshin me kualitete e jo me kuantitete. Garonin me humltime, me dituri e me vlera dhe jo me diploma e letra. Pikërisht në këtë kohë shoqëria islame lulëzonte; derisa politika ditore vuri nën kontroll procesin edukativo-arsimor dhe prioriteti i bëri diplomat e jo diturinë. Islami kërkon nga esenca formën, sepse forma pa esencë është shtyllë e kalbur, mbi të cilën nuk mund të mbështetësh asgjë, e jo më ardhmërinë e një populli apo kombi.

GOSTIVAR: “MIRË SE ERDHE, O RESULALL-LLAH”



Në organizim të Myftinisë dhe nën patronazhin e Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 10 tetor, 2022, në Gostivar u mbajt, për të 19-tin vit me radhë, manifestimi tradicional “Mirë se erdhe, o Resulall-llah”, në përkujtim të Muhamedit (alejhis-selam), në ditëlindjen e tij, thuhet në njoftimin e BFI.

Në Palestrën Sportive Rinia jehoi zëri i bukur i këndimit të fjalëve të Allahut (xh. sh.) nga hfz. Junus Koçan, mysafir special nga Turqia.

Më pas, fjalë përshëndetëse mbajti Myftiu i Myftinisë së BFI - Gostivar, h. Sabahudin ef. Zendeli, i cili u dëshiroi mirëseardhje të gjithëve, duke kujtuar se Muhamedi (a. s.) dhe dashuria ndaj tij na bëjnë që çdo vit të tubohemi në këtë mënyrë që të përkujtojmë lindjen e tij dhe Mesazhin që ai la pas vetes për ne.

Në vazhdim të programit, si çdo vit, u paraqit Kori i Myftinisë dhe i Medresesë së Gostivarit me ilahije kushtuar Muhamedit (a. s.), arsimit dhe përmallimit të njerëzve për të, me performime të mrekullueshme nga orkestra dhe udhëheqësit e Korit, si: Nejla Veseli, Ibrahim Ameti, Amina Ademi dhe Ajnure Rufati.

Të pranishmit patën fatin të dëgjojnë edhe fjalët përshëndetëse të Zv/Kryetarit të Diyanetit të Republikës së Turqisë, dr. Burhan Ishlijen, i cili përcolli selamet e përzemërta të besimtarëve të Turqisë.

Më pas, fjalën e rastit e mbajti Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili në fillim, përmes lutjeve drejtuar të Madhi Zot për shpirtin e Muhamedit (a. s.), tha se jeta jonë duhet të ndryshojë për



nga e mira dhe vlerat që mbolli ai të jenë prezente te shoqëria jonë.

Më pas, Flamur Kasami, si mysafir special, këndoi ilahinë "Rrushi i hidhur", për t'u ngjitur në skenë aktori i mirënjohur nga Tetova Arsim Fazlia, i cili me poezinë "O Kandil Ndriçues" të Fatmir Mujës e "elektrizoi" publikun dhe të gjithë, në shenjë respekti, u emocionuan nga fjalët e mëdha që ai tha për Muhamedin (a. s.).

Po ashtu, tubimin e bëri të këndshëm edhe studenti Arben Emini, i cili u paraqit me ilahijet e reja "Es-selamu alejke" dhe "Allah, ja Rahim", kushtuar Muhamedit (a. s.) dhe adhurimeve në Islam. Në këtë event u dëgjua edhe ilahija e re "Resulullahi Sevelim", e interpretuar në gjuhën turke nga maestro mr. Eljesa Hasani.

Programi u mbyll me këndim Kurani nga dr. Flamur Kasami dhe duanë e bërë nga hoxha i madh Ali Bulut nga Ankaraja.

Në këtë manifestim pjesëmarrës ishin të gjitha strukturat e BFI të RMV, të gjithë myftinjët me shoqëruesit e tyre, udhëheqësit e sektorëve të BFI, të institucioneve arsimore, përfaqësues të jetës politike e shoqërore, përfaqësues të pushtetit lokal e qendror, mysafirë nga Kosova e Shqipëria, si dhe shumë miq e të ftuar nga vendi e jashtë.

Ky program, me moderim të Referentit fetar-arsimor pranë Myftinisë së Gostivarit Mallzim Zendeli dhe prof. Hafsa Rushiti, u realizua drejtpërdrejt në eter nga televizionet lokale, ndërsa u transmetua edhe në platformat elektronike të Bashkësisë Fetare Islame të RMV dhe të Myftinisë së BFI-Gostivar, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këto platforma është dhënë, më vete, edhe fjalimi i Kryetarit të BFI të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në kohëzgjatje prej 18:39 minutash.

MEVLUDI, NË XHAMINË E RINISË

Më 7 tetor, 2022, Myftinia e BFI-Tetovë organizoi manifestimin fetar në nderim të ditëlindjes së Pejgamberit (a. s.) - Mevludit në Xhaminë e Rinisë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

Programi u organizua nën udhëheqjen e Referentit fetar-arsimor h.fz. Abdurahim ef. Murati. Manifestimin e moderoi mr. Xhemil ef. Sadiku dhe në të morën pjesë: Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, myftinjtë e mëparshëm h. Alifekri ef. Esati, h.fz. mr. Nexhadi ef. Limani, h.fz. Imer ef. Kamberi, Imami i Xhamisë h.fz. Ibrahim ef. Alija, bashkë me kolegët dhe Këshillin e Xhamisë, ho-hallarë të rrethinës, si dhe një numër i madh i xhematit.

Para xhematit u prezantua një program fetar-kulturor nga disa ho-hallarë, studentë nga FSHI, si dhe nxënës të M-dresesë Isa Beu.

Çelja e programit u bë me lexim të Kuranit famëlartë nga ana e h.fz. Abdurahim efendiu dhe vazhdoi me mevlud,



ilahi dhe kaside nga ana e Korit.

Myftiu i Tetovës mbajti fjalë rasti, me ç'rast foli mbi vlerën e kësaj nate. Në fund të fjalimit, të gjithëve ua bëri për hair Ditëlindjen e Pejgamberit (a. s.), duke lutur Allahun fuqplotë që të na japë të mira dhe të na takojë vetëm për fjalë, vepra dhe punë të mira.

Pas këndimit të një ashereje nga ana e h.fz. Besir ef. Limani, duanë e këtij manifestimi e bëri haxhi Alifekri efendiu. Në namazin e akshamit priu h.fz. Nexhadi efendiu, ndërsa në namazin e jacisë priu vetë Myftiu prof. dr. Qani ef. Nesimi, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

SHËNOHET DITËLINDJA E PEJGAMBERIT (A. S.) NË STRUGË



Më 6 tetor, 2022, Myftinia e Strugës shënoi ditëlindjen e Pejgamberit (a. s.), thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Strugë.

Ditëlindja – Mevludi u shënuar në Xhaminë Sulejman Arap.

Programi, i udhëhequr nga studenti Eglon ef. Murtezai, filloi me lexim të Kuranit nga Festim ef. Koxhaxhiku. Fjalë përshëndetëse kishte Myftiu i Strugës, mr. Salim ef. Sulejmani, ndërsa ligjëratën e kësaj nate e mbajti Imami i fshatit Veleshtë, Abdulkadri ef. Sheji.

Në vazhdim, programi u zbulua me ilahi të kënduara nga Maksut ef. Maksutoski, ndërsa u lexuan edhe pjesë të Mevludit nga Imami Arben ef. Jusufi.


Kënaqësi e veçantë e kësaj nate ishin nxënësit e mejtepit të fshatit Mislodezhdë, të cilët kënduan ilahi për Pejgamberin (a. s.). Programi u mbyll me lexim të Kuranit nga Fatjon ef. Shemshedini.

Zoti na mundësoftë të takohemi sa më shumë në tubime të tilla, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Strugës.

VARGJE NGA MEVLUDI I HAFËZ ALI ULQINAKUT

*Mirë se erdhe xheneti sot u stolis,
Mirë se erdhe i dashtuni i Perëndisë.
Mirë se erdhe melhem i zemrave tonë,
Mirë se erdhe ej ndriçim i syve tonë.
Mirë se erdhe çareja shpirtave tonë,
Mirë se erdhe dermani i dertëve tonë.
Mirë se erdhe ej Dielli gjithë dynjasë,
Mirë se erdhe ilaç i zemrës fukarasë.
Mirë se erdhe, i ban shefat ymetit Tand,
Mirë se erdhe prej xhehenemit i largon.
Mirë se erdhe ymeti Jot tue qa me lot,
Borxh e kemi për me ramun salavat.
(...)*

Mevludi është vepër e poetit të njohur turk Sulejman Çelebi dhe është përkthyer në gjuhën shqipe nga hafëz Ali Riza Ulqinaku (1853-1913). Poema i kushtohet lindjes së pejgamberit Muhamed (a. s.) dhe është përkthim - adaptim, përshatje, në gjuhën shqipe, kryer në moshën 18-vjeçare, në vitin 1873. Vepra, në katër kapituj, me 634 vargje, është botuar në vitin 1885. (HeR/desk)



PËRJETIME QË DUA T'I PREK

Nuk të kam parë, por e di si dukesh! I kam parë sytë tu mu atëherë kur loti të shkante nëpër faqe dhe dielli humbte ndriçimin.

Nga Hysein Rizai

Sa mall kam për këtë datë: 12 Rebiul Evel. Është dita që më mbush me aromën tënde, o Resulallah!

Sa rëndë është të shfaqësh një të vërtetë, të cilën po e përjeton!

E di, asnjëherë nuk do të kem mundësi ta tregoj dashurinë time ndaj teje, prandaj gjithnjë lutem që mendimi të shfaqet në imazh, për ta pikturuar këtë dashuri.

Gjithnjë pres që një ditë të trokas në hijen e shpirtit tënd. Po, do të pres që të më thuash 'eja dhe futu, pa trokitur, pa frikë'.

Por, kur të hyj brenda, do të qëndroj pranë shpirtit tënd, në vështrimin e syve tu... E di që do të më verbohen sytë dhe do të më mbushen me lot dashurie, ndërsa qepallat e syve të mi do të lagen

aq shumë, sa që nga dashuria do ta humb shikimin...

Po, e humb, sepse tani jam brenda teje; i humbur dhe i shkrirë në dashurinë tënde.

Gjithnjë kur më merr malli dhe kur buzët më thahen, e hap dritaren dhe i lutem Zotit, duke i buzëqeshur hënës, i zhytur në mendime, duke të të kujtuar.

Nuk të kam parë, por e di si dukesh!

I kam parë sytë tu mu atëherë kur loti të shkante nëpër faqe dhe dielli humbte ndriçimin.

Jetoj me ndjenjën se do të ma jepni atë xhyben e bukur që e donin të gjithë sahabët. Të betohem se çdo mëngjes zgjohem për të parë atë renë që të ndiqte nga pas, duke bërë hije, vetëm e vetëm që të mbushem me aromën tënde!

Sa çudi: gjithnjë kur të kujtoj ty, shikoj lart në qiell; e di që je pranë Zotit. Qielli merr pamje tjetër, yjet ndriçojnë nga nuri yt, engjëjt në kor dërgojnë salavate mbi ty. Po, gjithçka buzëqesh.

E, unë në ato momente ndjej një pikë ujë mbi plagët që kam dhe që më djegin. Këto plagë janë, sepse dua të mbështetem aty ku ke prekur ti - te trungu i hurmës,. Aty, prej kur fillove të mos mbështetesh, dëgjohej veç rënkimi i saj.



Them me vete: unë ndoshta nuk e kam fatin e trungut të hurmës që të të prek, por unë gjithnjë të përjetoj ty.


Ja Resulallah, e di që asnjëherë nuk është vonë të trokas në portën e dashurisë tënde; përsëri çohem dhe e hap dritaren që të bie dritë mbi mua, që të mbushem me ajër, me përkujtimet tua...

O Zot, kam vetëm një dëshirë: më mundëso që gjithnjë të përjetoj buzëqeshjen e Pejgamberit!



Në përkujtim të lindjes së njeriut më të mirë, Muhamedit (a. s.). Allahu e shpërbleftë imamin Ejup Jakupi për ligjëratën dhe xhematin e xhamisë për prezencën - ka shkruar ho-hë Mafiz Rustemi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 9 tetor, 2022 (American Albanian Islamic Center of Wisconsin, Kenosha).

BIOGRAFIA E PEJGAMBERIT (A. S.)



Nga Amr Halid

Shatë informata që nuk i keni ditur për lindjen e Pejgamberit (a. s.):

1. Pejgamberi (a. s.) lindi 50 ditë pas ngjarjes së elefantit, në vitin e elefantit. Do të thotë,

pas përpjekjes së Ebrehasë për ta shkatërruar Qabënë.

Ai ishte foshnja e parë që lindi pas kësaj ndodhie. Koha e lindjes së tij ishte e çuditshme, në agun e mëngjesit.

Ai lindi 500 vjet pas Isait (a. s.), kur gjendja arriti kulmin e errësirës. Sikur kjo do të thotë:

Sado që të vështirësohet gjendja, mos e humb shpresën për një agim të ri!

2. Pejgamberi (a. s.) lindi në shtëpinë e nënës së tij, te kodra Merve, në pjesën më të lartë, 200 m afër Qabesë.

Zonja Emine, nëna e Pejgamberit (a. s.) thotë: *"Kur e kam bartur atë, kam parë një dritë që doli nga barku im, deri në Busra."*

Është për t'u habitur se çlirimi i parë islam ka qenë Busra, vend në Sham (do të thotë: rajoni i gjerë i Sirisë).

3. Katër gra kanë qenë prezente në lindjen e Pejgamberit (a. s.), për t'i ndihmuar nënës së tij:

- Ummu Ejmen, nëna e Usame bin Zejdit;

- Esh Shifaë, nëna e Abdurrahman bin Aufit;

- Fatime, nëna e Othman bin Ebi el-Asit;

- Thuvejbe, shërbëtorja e Ebu Lehebit, xhaxhait të Pejgamberit (a. s.).

4. Është për t'u habitur se Allahu këto gra i furnizoi me furnizim të gjerë:

- Ummu Ejmen - e lindi Usame bin Zejdin, i cili u bë komandant i ushtrisë myslimane.

- Esh Shifaë - e lindi Abdurrahman bin Augin, njëri prej dhjetë të përgëzuarve me Xhenet dhe një prej tregtarëve të mëdhenj.

- Fatimja - e lindi Othman bin Ebi el-As, i cili u bë dijetar i madh.

- Thuvejbe - e fitoi lirinë nga Ebu Lehebi, xhaxhai i Pejgamberit (a. s.), pasi e përgëzoi atë me lindjen e Pejgamberit (a. s.).

Kjo sikur të lë të kuptosh: *Vendose veten në vendet e mira, që Allahu të të bekojë ty me të mira.*

5. Pejgamberi (a. s.) lindi në ditën e hënë. Dhe, kur e pyetën: Përse e agjëron ditën e hënë? Ai tha: Ajo është dita në të cilën kam lindur. Kjo do të thotë se Pejgamberi (a. s.) e ka festuar ditëlindjen e vet në mënyrën e tij të veçantë.

6. Kur lindi Pejgamberi (a. s.), ia dërguan gjyshit të tij, Abdul Mutalibit. Ai e barti atë dhe bashkë me të e bëri tavaf

Qabënë. Gjëja e parë që i ndodhi Pejgamberit (a. s.) ishte tavafi rreth Qabesë! Pastaj e emëroi me emrin Muhamed (Muhammed)! Kur e pyetën: *Përse e emërove me këtë emër, derisa ky emër nuk është i etërve tu? Ai tha: Që të jetë i lavdëruar në Tokë - nga banorët e Tokës dhe të jetë i lavdëruar në Qiell, nga banorët e Qiellit!*

Kjo do të thotë: Për të ardhmen e fëmijëve tu duhet të mendosh që nga përzgjedhja e emrit!

7. Gjdhënësja e parë e Pejgamberit (a. s.) ishte Thuvejbe; ajo ishte robëreshë dhe kishte një djalë, që quhej Mesruh. Ai ishte vëlla gjiri i Pejgamberit (a. s.).

Pejgamberi (a. s.) kishte edhe një vëlla tjetër gjiri. Ai është zotëria ynë, Hamza ibn Abdul Mutalib.

Kjo do të thotë se vëllezërit e Pejgamberit (a. s.) janë zotërinj dhe robër dhe se ai është për të gjithë njerëzit, për t'i bashkuar ata!

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!

Amr Halid, ose: Amr Mohamed Helmi Khaled, është i lindur më 5 shtator 1967 në Aleksandri (Egjipt). Është aktivist mysliman dhe predikues televiziv egjiptian. Përthimi në shqip: nga Muhamed Sadiku, Imam në Studeniçan, Shkup.

LËSHOHET NË PËRDORIM XHAMIA E RE NË DRENOVEC



Më 15 tetor, 2022, me manifestim fetar, u lëshua në përdorim xhamia e re në lagjen Drenovec të Tetovës, thuhet në njoftimin e BFI.

Në manifestim morën pjesë: Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, Kryetari i Komunës së Tetovës z. Bilall Kasami, Myftiu i Gostivarit Sabahudin ef. Zendeli, Myftiu i Kumanovës Abedin ef. Imeri, Myftiu i Kërçovës Qamil ef. Rushiti, Myftiu i Manastirit Amit ef. Rasimi, Myftiu i Shtipit mr. Nasir ef. Rexhepi, përfaqësues nga Myftinia e Strugës, Dekani i FSHI prof. dr. Shaban ef. Sulejmani, Prodekani i FSHI dr. Muaz ef. Agushi, Drejtori i Mërgatës në BFI dr. Selver ef. Xhemaili, Drejtori për Arsim Fetar Jusuf ef. Zimeri, Drejtori i Agjencisë së Standardit Hallall Muhamer ef. Veseli, Drejtori i Sektorit për Marrëdhënie me OSBE mr. Mustafa ef. Dauti, Drejtori i shoqatës "Ilmije" Rexhep ef. Ziberi, Drejtori i Sektorit për Shkencë dhe Kulturë Musanif ef. Rufati, profesorë nga FSHI dhe Medreseja Isa Beu - Shkup, Myftinjtë e mëparshëm: Alifekri ef. Esati dhe hfz. Imer ef. Kamberi, operativa e Myftinisë, Këshilli i iniciativ për ndërtimin e Xhamisë, hoxhallarë, mysafirë, si dhe xhamatë nga qyteti dhe rrethina.

Manifestimi, të cilin e moderoi mr. Xhemil ef. Sadiku, filloi me leximin e disa pjesëve nga Kurani famëlartë, kënduar nga hfz. Bekim Havziu. Të dhënat rreth ecurisë së ndërtimit të Xhamisë i prezantoi anëtar i Këshillit i iniciativ, dr. Selver ef.

Xhemaili.

Të pranishmit i përshëndeti Myftiu i Tetovës, prof. dr. Qani ef. Nesimi, i cili përgëzoi xhematin për këtë xhami të re, duke lutur Allahun fuqiptotë që të gjithë ata që kanë kontribuar, në çfarëdo lloj mënyre, në ndërtimin e kësaj xhamie, t'i shpërblejë me shpërblimet e Tij të pafundta. Në fjalimin e tij Myftiu gjithashtu potencoi se ndërtimi i xhamive është një ndër punët më të pëlqyera dhe më të dashura tek Allahu (xh. sh.).

Të pranishmit i përshëndeti edhe Kryetari i Komunës së Tetovës, z. Bilall Kasami.

Ndërkaq, fjalën e rastit e mbajti Kryetari i BFI-së, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Në fjalimin e tij ai u përqëndrua në rolin që ka luajtur xhamia në të kaluarën dhe në rolin që do të luajë në të

ardhmen. Fjalimin e vet e përfundoi duke lutur Allahun që të gjithë ata që kontribuan në ndërtimin e kësaj xhamie t'i shpërblejë me shpërblime që Ai di.

Para se të bëhet duaja e hapjes së Xhamisë u lexuan edhe disa pjesë nga Kurani famëlartë, kënduar nga Referenti i Myftinisë së Kumanovës Sadulla ef. Abdullahi, ndërkaq duanë e bëri Alifekri ef. Esati. Pas duasë u ndanë mirënjohje për donatorët që kanë kontribuar në ndërtimin e kësaj xhamie. Në faljen e namazit të drekës priu Kryetari i BFI-së, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, thuhet në njoftimin e BFI.

Gjatë ditës, në kohë reale, në platformat elektronike të BFI-së është transmetuar drejtpërdrejt manifestimi i hapjes së xhamisë së re në lagjen Drenovec të Tetovës.

ARKITEKTURË E VEÇANTË

Qielli u duk më i kaltër kur u hap xhamia e re në lagjen Drenovec të Tetovës. Nga gëzimi, edhe majat e malit Sharr për këtë eveniment venduan plisin e bardhë mbi kokë.

Kordelja e kuqe u pre dhe prej sot, për jetë e mot, Xhamia i hapi dyert e drunjtja, paraqiti arkitekturën e veçantë, gjithashtu me punime të drurit të gdhendur, punime të cilat kënaqin çdo besimtar.

Urime, shumë përgëzime gjithë xhematit, Imamit... Zoti i shpërbleftë të gjithë iniciuesit, organizatorët, donatorët dhe duaxhinjtë... (Haxhi Qemal Rushiti, Orashë, Tetovë)



RRUGA KREATIVE E VAKËFIT

Nga Taxhudin Hamidi

Banorët e lagjes Drenovec të Tetovës më 15 tetor, 2022, organizuan me të gjitha nderimet fetare dhe kombëtare hapjen solemne të xhamisë së re. Është kjo xhamia e dytë në këtë lagje.

Xhamia është ndërtuar në parcelën kadastrale P.K. 11400, e dhuruar më 29.12.2021 nga vëllezërit Alija. Objekti i xhamisë u ndërtua në rrugën kreative të Vakëfit për një interval goxha të shkurtër, vetëm për dhjetë muaj, apo më pak se një vit të plotë.

Për rëndësinë dhe peshën që ka kjo xhami në lagjen e Drenovecit tregon vetë kapaciteti i ndërtimit dhe kompletimi i të gjitha aseteve dhe anekseve rreth saj. Xhamia nuk është një protestë individuale. Përkundrazi, ajo është një zë që bashkon apelin e qiellit me nevojat e tokës për ndërveprim.

Xhamia në mënyrë direkte lufton bregun e thellë të pabarazisë mes njerëzve. Ky është legjitimiteti i funksionit të xhamive në çdo vend dhe në vendin tonë. Pa dyshim se për këtë duhen punë, dije, vullnet, angazhim dhe shumë vetëmohim. Xhamia ka për qëllim të tubojë xhematin, popullin, rreth fjalës së drejtë, të sinqertë; për bashkëpunim për hir të Zotit dhe për të mirën e njerëzimit.

Falja e namazit të besimtarët myslimanë gjithnjë kultivon zhvillimin e ndjenjave vëllazërore. Nëse ky obligim kryhet në xhami, kjo vëllazëri rritet dhe ndërtohet në një unitet dhe bashkësi që nuk mund të thyhen nga asnjë forcë dhe nuk mund të destabilizohen.

Muhamedi (s.a.v.s.) në një hadith na rrëfen: “Kush i ruan (pesë) kohët e faljes së namazit, falja e namazit do t’i bëhet



dritë, dëshmi, garanci dhe shpëtim në Ditën e Kiametit.” Namazi është një ndër veprat më të rëndësishme në jetën e një besimtari islam. Sintagma e njohur ndër ne është: **namaz, me xhematë, në xhami**. Ne duhet të punojmë për faljen e namazit. Se, namazi afron çdo të mirë dhe largon çdo të keqe nga mesi ynë.

Xhamia nuk është një objekt statik dhe i padobishëm në vendin ku ndërtohet. Nuk është një investim që shkon huq dhe i paperspektivë etj. Xhamia determinon shumë aspekte urbane dhe shoqë-

rore dhe vazhdimisht alarmon dhe apelon për një gjallërim dhe popullim të vendbanimit.

Tanimë xhamia aktuale - xhamia e vjetër, me strukturat e saj të konsoliduara dhe xhamia e re, kjo në këtë vend, do të përqipen të flasin për gjërat më të rëndësishme dhe më të shtrenjta të popullit shqiptar mysliman dhe të besimtarëve në përgjithësi në kontinuitet.

Drenovec, i gëzofshit xhamitë!

(Autori është Referent i Vakëfit në Myftininë e Tetovës)

NË MESIN E BASHKATDHETARËVE NË AUSTRI

Me rastin e hapjes së Qendrës së re Islame Shqiptare në Vjenë të Austrisë, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 7 tetor, 2022, vizitoi Bashkësinë Islame Shqiptare në kryeqytetin austriak, thuhet në njoftimin e BFI.

“Ishte kënaqësi e veçantë: me pritje madhështore, me pjesëmarrje masive dhe me organizim të nivelit të lartë”, deklaroi ai më pas.

Po ashtu, në ligjëratën e xhumasë Reis’ul-Ulemaja përcolli fjalë miradie dhe falënderoi bashkatdhetarët tanë për kontributin e dhënë në organizimin e jetës fetare islame në Austri, për rolin e xhamisë në ngritjen e vetëdijes për veprimtari të shëndoshë në shërbim të vlerave madhore.

Më pas, hytben e xhumasë e paraqiti Shefi i Kabinetit, dr. Abdulkerim Iseni.

Delegacioni i BFI shpreh falënderime të sinqerta për Kryetarin e BISH, z. Senat Asani, Imamin h. Afrim ef. Xhelili, Adil Hasanin, Arijan Sulimanin e të tjerët. Po ashtu, ai uroi për sukseset dhe dëshiroi edhe suksese të tjera. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë kuadër, Kryetari i BFI, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, vizitoi edhe qendrën islame shqiptare “Hilal” në Hollabrunn (Hollabrunn), ku iu



organizua një pritje madhështore e vëllazërore.

Aty Reis’ul-Ulemaja uroi për blerjen e Xhamisë - tani pronë e besimtarëve dhe vend strategjik dhe falënderoi për pritjen hoxhë Adnan ef. Skënderin, Kryetarin Resul Ademi dhe besimtarët. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

Në kuadër të vizitës në Austri, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu të shtunën në mbrëmje vizitoi QKSH “Ikre”, ku iu organizua pritje madhështore e vëllazërore nga mërgimtarët tanë që jetojnë dhe veprojnë në Austri.

Në tubimin e organizuar në nder të Kreut të BFI, prezenca ishte masive dhe e një niveli të lartë. Pas fjalimit të Reis’ul-Ulemasë, për ecuritë në BFI, u zhvil-

lua një bashkëbisedim, gjatë të cilit të pranishmit kishin mundësi që të paraqitnin pyetje të lira drejtuar Kryetarit të BFI.

Për këtë tubim, të organizuar në këtë nivel të lartë dhe për pritjen e ngrohtë vëllazërore, Reis’ul-Ulemaja falënderoi Imamin h. Usam ef. Halimi, i cili tregoi profesionalizëm të lartë në detyrën e tij, thuhet në njoftimin e BFI.

Në kuadër të vizitës në Austri, Kryetari i BFI të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me delegacionin, më 9 tetor, 2022, vizitoi Xhaminë e Re në Ternitz (Ternic), ku u prit në mënyrë vëllazërore nga bashkatdhetarët tanë, me të cilët pati një takim të ngrohtë në njoftimin e BFI.



Më 8 tetor, 2022, në Renens të Lozanës (Lausanne), Zvicër, është zhvilluar tribuna “Rëndësia e biografisë pejgamberike për brezat e rinj myslimanë në Perëndim”. Tribuna është organizuar nga Xhamia Shqiptare në këtë qytet. Në tribunë kanë marrë pjesë Kryetari i Bashkësisë Islame të Bujanocit, Ragmi Destani, hoxhë Irfan Musliu, Bashkim Aliu dhe Muhamer Latifi. (B. A.)



PENSIONOHET HOXHË SELAJDIN EF. MURSELI

Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, në faqen e vet në Facebook më 18 tetor, 2022, ka shkruar:

“Sot, me kënaqësi prita në takim hoxhën Selajdin ef. Murseli, i cili 42 vjet pandërprerë, që nga nëntori i vitit 1980, kreu detyrat e shenja të imamit, të hatibit dhe të mualimit në Xhaminë e Vjetër në Luboten, për t’i dorëzuar vendimin e daljes në pension.

I bëjmë lutje Allahut fuqiptotë që t’i japë shëndet, që të vazhdojë të jetë në shërbim të besimtarëve.

Myftinia e Shkupit do të vazhdojë të përkrahë hoxhallarët e vjetër, që të plotësojnë kushtet, që të fitojnë të drejtën e daljes në pension.”

HAPET XHAMIA BASHKIMI NË LINZ



Më 9 tetor, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në manifestimin e hapjes solemne të Xhamisë Bashkimi në Linz (Linc), Austri, thuhet në njoftimin e BFI.

Manifestimi u mbajt në një ambient madhështor dhe në të morën pjesë shumë personalitete të njohura fetare, diplomatike dhe të pushtetit lokal. Mikpritja ishte vëllazërore, udhëhequr nga Kryetari i Xhamisë dhe i ALKIG-ut, z. Vahidin Beluli dhe të imamit z. Menderez Alili.

Te besimtarët tanë ndihej një kënaqësi e madhe dhe kjo shihej në fytyrat e tyre.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja i uoi

organizatorët dhe të pranishmit në emër të BFI të RMV, ndërsa Kryetarit të Xhamisë i ndau mirënjohje për kontributin e dhënë, thuhet në njoftimin e BFI.

Pas përfundimit të manifestimit të hapjes solemne të Xhamisë në Linc, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mbajti një takim shumë të rëndësishëm me Imamët dhe Kryetarët e Qendrave islame në Austri, ku morën pjesë edhe Kryetarët e Unioneve të BI të Zvicrës h. hfz. Mehas ef. Alija, i Gjermanisë h. Mensur Halili, i Italisë dr. Reshat Ibishi dhe shumë të tjerë. Nga BFI ishte dhe Drejtori i Sektorit për Çështje të Mërgatës dr. Selver ef. Xhemaili, thuhet në njoftimin e BFI.

timin e BFI.

Kryetari i BFI fillimisht falënderoi organizatorin, z. Vahidin Beluli, për këtë takim të organizuar në nivel të lartë. Më pas u bisedua gjerë e gjatë për angazhimet e BFI të RMV në organizimin e jetës fetare islame në vendlindje dhe kujdesin e saj për bashkatdhetarët tanë në Evropë.

Në takim ishte dhe përfaqësuesi i Bashkësisë Islame të Kosovës, prof. Ekrem Simnica.

Gjatë takimit u bisedua gjerësisht për tema të ndryshme, me ç'rast Kryetarët e Unioneve dhanë propozime të rëndësishme dhe konstruktive, thuhet në njoftimin e BFI.

TAKIM ME AMBASADORIN ROSOKLIA

Më 10 tetor, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe delegacioni që ai udhëhoqi në Austri, realizuan një takim me Ambasadorin e RMV në Vjenë, z. Osvit Rosoklia dhe me Sekretarin e Parë z. Seat Fejzuli, thuhet në njoftimin e BFI.

U bisedua për rrjedhat shoqërore, si edhe për angazhimin e Ambasadës sonë në mirëvajtjen e punës së bashkatdhetarëve tanë, si dhe në zgjidhjen e shumë çështjeve që kanë të bëjnë me ta.

Ambasadori z. Rosoklia çmoi lart punën e Bashkësisë Fetare, të Qendrave islame, si dhe maturinë e tyre në marrëdhëniet ndërnjerëzore - si vlerë e madhe në kultivimin e bashkëjetesës në shoqërinë austriake, si dhe zhvillimin e marrëdhënieve të Ambasadës me bashkëqytetarët tanë me punë në Austri,



me qëllim që të jenë sa më afër tyre në zgjidhjen e kërkesave eventuale.

Reis'ul-Ulemaja falënderoi nikoqirët

për pritjen dhe respektin që ata i bënë delegacionit të BFI të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

HAPJE SOLEMNE E XHAMISË EBU HANIFE NË TROISDORF



Një tetori, 2022, ishte një ditë e veçantë për shqiptarët myslimanë të Troisdorfit me rrethinë, sepse ëndrra e tyre u bë realitet: u përrua Qendra e re Islame Shqiptare, respektivisht Xhamia Ebu Hanife, thuhet në njoftimin e Xhamisë Ebu Hanife në Troisdorf, Gjermani.

Të pranishëm në këtë program ishin qindra besimtarë e besimtare nga e gjithë Gjermania. Njashtu, kishte pjesëmarrës edhe nga vendet tjera si: nga Zvicra, Belgjika, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Përveç mysafirëve të ftuar nga vendlindja, pjesëmarrës ishin pothuajse xhamatë, imamë dhe besimtarë nga të gjitha xhamitë shqiptare në Gjermani.

Në këtë eveniment morën pjesë po ashtu edhe Kryetari i Komunës së Troisdorfit, përfaqësuesit e kishave katolike, evangjeliste dhe përfaqësues të insitucioneve të tjera lokale, kori diplomatik nga vendlindja, përfaqësues të xhamive të Troisdorfit etj.

Edhe pse kohë pas kohe moti ishte me shi, kjo nuk pengoi që qindra pjesëmarrës të ishin prezent.

Programi përbëhej nga fjalë rasti, lexim Kurani, ilahi, monolog, shpërndarje mirënjohjesh dhe drekë për të gjithë pjesëmarrësit.

Në këtë program morën pjesë me fjalë rasti-përkrahëse: h. Mahir Mustafa, Kryetar i Xhamisë; hoxhë Bedri Sylja, Imam i Xhamisë; z. Alexander Biber, Kryetar i Troisdorfit; h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, Kryetar i BFI të RMV; Ekrem ef. Simnica, Drejtor i Mërgatës në BIK; Muhamed ef. Sytari, Myfti i Shkodrës; Rexhep ef. Sylejmani, Nënkryetar i QISHTGJ; prof. dr. iur. Çefli Ademi, Profesor në Universitetin e Mynsterit; hfz. dr. Benjamin Idriz, Imam në Pensberg; dr. Xhemail Çupi, Ministër i Mërgatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut; z. Burhan Çajani, përfaqësues i Ambasadës së Maqedonisë së Veriut në Bon (Bonn).

Kuran: Xhelal ef. Kaloshi, Imam në Ingolstadt. Ilahi: Arben ef. Emini, student në Emiratet e Bashkuara Arabe; moderim: Ensar ef. Sinani, Imam në Hamburg.

Po ashtu, morën pjesë edhe personalitete të tjera nga vendlindja, të cilët ishin ftuar: dr. Selver Xhemaili, Fadil ef. Hasani, Korab ef. Hajraj, Sabahudin ef. Zenedeli, dr. Shaban Sulejmani, Fejsal ef. Kadriu, dr. Kujtim Mirzo, Sherif ef. Dehari dhe personalitete të tjera.

Në fund të programit u bë prerja e shiritit dhe u fal namazi i drekës, thuhet në njoftimin e Xhamisë Ebu Hanife në Troisdorf, publikuar në faqen Moschee "Ebu Hanife" Troisdorf.

Më 29 shtator, 2022, Bashkësia Fetare Islame e RMV publikoi këtë njoftim:

Më 30.09.2022 Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, udhëton me ftesë të Kryesisë së Qendrës Islame "Ebu Hanife" në Troisdorf të Gjermanisë, me rastin e hapjes solemne të xhamisë së re më 1.10.2022, i shoqëruar nga dr. Selver Xhemaili, Drejtor i Mërgatës dhe bashkëpunorët tjerë: h. Fejsal ef. Kadriu, Kryetar i Kuvendit të BFI; prof. dr. Shaban Sulejmani, Dekan i FSHI; dhe h. Fadil Ramadani, Kryetar i OH "Hilal" dhe shumë të tjerë.

Në këtë solemnitet Reis'ul-Ulemaja do të ketë paraqitjen e tij para bashkatdhetarëve tanë, që janë nga të gjitha trojet tona si: nga Maqedonia e Veriut, nga Kosova, nga Shqipëria e më gjerë.

Qendra në fjalë është ndërtuar me vetë mundin e bashkatdhetarëve tanë me punë në Gjermani.

Brenda mundësive, Reis'ul-Ulemaja me bashkëpunorët do të vizitojë edhe xhamatë të tjera, thuhet në këtë njoftim të BFI-së.

Prezencë masive, hapje solemne e Xhamisë në Troisdorf të Gjermanisë, ka shkruar BFI më 1 tetor dhe ka dhënë më shumë fotografi nga hapja solemne.

Reis'ul-Ulemaja u takua me Imamin e

Brukselit, thuhet në një njoftim tjetër të BFI-së.

Me rastin e hapjes solemne të xhamisë së re në Troisdorf të Gjermanisë, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, u takua me shumë personalitete, ndër të cilët edhe me Imamin e Xhamisë së Brukselit, h. Nuhi ef. Shaqiri, i cili mbi tri dekada vepron në organizimin e jetës fetare dhe të besimtarëve nga Ballkani e më gjerë në këtë vend.

Në bisedë të ndërsjellë, Imami i respektuar rrëfeu për sfidat me të cilat është ballafaquar në angazhimin, punën dhe veprimtarinë e tij. Belgjika më së miri i ka zgjidhur çështjet e besimeve, pra edhe të Islamit, dhe tani është fe zyrtare dhe nga shteti ka benificione të ndryshme.

Hoxhë Nuhi ef. Shaqiri njihet si veprimtar i denjë dhe i mirënjohur, si strateg i spikatur dhe mu për këtë rezultatet e tij janë të njohura në Bruksel dhe në tërë Belgjikën.

Mbetet një model se si duhet vepruar në ambientin evropian në prezantimin e Islamit në përgjithësi.

H. Nuhi ef. Shaqiri qëndroi në Troisdorf me hoxhë Tahsin Ramadanin, po ashtu Imam i njohur në Belgjikë. Jemi mirënjohës dhe Zoti i bekoftë! – thuhet në njoftimin e BFI.

Pas takimit, Xhamia e Besimit në Bruksel ka botuar këtë njoftim: Në emër të Kryesisë së Xhamisë, Xhamia e Besimit në Bruksel dhe në emër të hoxhës sonë të dashur mullah Nuhi ef. Shaqiri falënderojmë nga zemra Kryetarin e BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu për vlerësimin për veprimtarinë e hoxhës tonë mullah Nuhi ef. Shaqiri në organizimin e jetës fetare në Bruksel. Ishte kënaqësi e veçantë të takohemi me Reisin dhe gjithë hoxhallarët në hapjen solemne të xhamisë së re në Troisdorf. Selam e urime suksesi për gjithë popullin tonë kudo që gjendet, thuhet në njoftimin e Xhamisë së Besimit në Bruksel.

BASHKIMI I GJERMANISË, NJË FAQE E RE PËR NJERËZIMIN

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në ceremoninë e Ditës së Bashkimit të Gjermanisë në ambientet e Ambasadës Gjermane në Shkup, me ç'rast Ambasadores, Shkëlqesisë së Saj znj. Anke Holstein (Anke Holshtajn) dhe tërë popullit gjerman u përcollti urimet më të mira në emrin personal dhe të Bashkësisë Fetare Islame, thuhet në njoftimin e BFI.

Reis'ul-Ulemaja uroi 3 Tetorin, ditën historike të bashkimit të Gjermanisë pas rrëzimit të Murit të Berlinit, me çka u hap një faqe e re për njerëzimin dhe filloi rënia e sistemit komunist dhe me këtë edhe e Bashkimit Sovjetik, bartësit kryesor të monizmit dhe të ateizmit në botë.

Fjalimi i Ambasadores, znj. Anke Holstajn, ishte mbresëlënëse. Ajo këtë ditë e cilësoi si ngjarje historike, si ditë të lirisë së



kombeve dhe të njerëzimit.

Kryetari i BFI të RMV iu përgjigj ftesës me respektin më të madh ndaj kësaj dite, ndaj kombit gjerman, të miqësisë dhe marrëdhënieve të mira me Ambasadën gjermane në RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

“Urime dita e bashkimit të Gjermanisë”, ka shkruar në faqen e vet në Facebook të njëjtën ditë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Rënia e Murit të Berlinit, pastaj edhe e Bashkimit Sovjetik, kanë qenë momentet kyç për shpërthimin e lirisë fetare këtu dhe në botë, ka shkruar ai në postimin që ka nxjerrë në rrjetet sociale.

BFI NË FESTËN E SLLOVAKISË



Drejtori i Punëve të Jashtme i BFI të RMV, mr. Mustafa Dauti, më 20 tetor, 2022, mori pjesë në festimet Ambasadës së Sllovakisë në Shkup, thuhet në njoftimin e BFI.

Kjo datë shënon Ditën e Kushtetutës dhe Ditën e Forcave të Armatosura të Republikës së Sllovakisë.

Në këtë ceremoni Mustafa Dauti uroi dhe falënderoi për ftesën Ambasadorin e Republikës së Sllovakisë, z. Henrik Markus, dhe njëkohësisht shfrytëzoi rastin që të urojë dhe të përcjellë përshëndetjet e sinqerta edhe në emrin e Reis'ul-Ulema Shaqir ef. Fetahu për këtë ditë të madhe të popullit sllovak, thuhet në njoftimin e BFI.

KUVEND: DERISA FLET IRENE KELIN...

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 13 tetor, 2022, qëndroi në Kuvendin e RMV, me rastin e vizitës së Kryetares së Këshillit të Federatës së Zvicrës, znj. Irene Kelin, thuhet në njoftimin e BFI.

Me ftesë zyrtare nga Kryetari i Kuvendit, z. Talat Xhaferi, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu mori pjesë në ceremoninë solemne dhe përcjelljen e ekspozesë së znj. Irene Kelin në Kuvend, e cila pati rastin që t'u drejtohet deputetëve dhe të ftuarve të tjerë, me ç'rast informoi për zhvillimet e reja të



kohës, për sfidat me të cilat ballafaqohet bota dhe për përpjekjet për tejkalimin e tyre. Ajo njëherësh foli edhe për

përparimin e RMV në rrugën e bisedimeve për hyrje në BE, thuhet në njoftimin e BFI.

XHAMIA NË SCHAFFHAUSEN I KONTRIBUON PAQES



Në takimin e radhës lexova pjesë të Kuranit famëlartë, edhe atë nga kaptina “El-Huxhurat”, ajetet 9, 10, 13:

“Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju pajtoni ata, e në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftojeni atë grup që vërsulet me pa të drejtë, derisa t'i bindet udhëzimit të Allahut; e nëse kthehet, atëherë me drejtësi bëni pajtimin ndërmjet tyre; mbani drejtësinë; se vërtet Allahu i do të drejtët.” (Huxhurat: 9)

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.” (Huxhurat: 10)

“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëme popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim, se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të keqijata), e Allahu është shumë i Dijshëm dhe hollësisht i Njohur për çdo gjë.” (Huxhurat: 13)

Nimetullah Veseli, me origjinë nga rrethinat e Gostivarit, prej vitesh është hoxhë në Zvicër dhe pjesëmarrës aktiv në veprimtaritë e përbashkëta fetare, të të gjitha feve, në shtetin helvetik e më gjerë. (16.10.2022)

TRIBUNË DHE PROMOVIM LIBRI NË KREUZLINGEN

Më 2 tetor, 2022, në Xhaminë Hëna e Re në Kreuzlingen, Kanton Thurgau, Zvicër, u mbajt një tribunë rreth dhunës në familje, si dhe u bë promovimi i librit “Dhuna në familje - një qasje nga këndvështrimi islam” i dr. Bashkim Aliut.

Në këtë tribunë me kumtesë u paraqit organizatori, Imami i Xhamisë Hëna e Re, Rejhan ef. Neziri, ndërsa ka folur dhe autori i librit – një ndër studiuesit më të spikatur në mesin e mërgatës shqiptare në Evropë e më gjerë.

Interesimi për librin është tejet i madh mu për shkak të aktualitetit (të dhunës në familje dhe të debatit rreth



saj), si dhe shkak të komponentës islame që është përfshirë në të.

Në Xhaminë e Kreuzlingenit kanë qenë të pranishëm edhe Bedri Kuçi dhe

Bashkim Halimi nga Xhamia Shqiptare në Seebach-Zürich, pastaj të ftuar të tjerë dhe një numër i madh xhematlinjsh. (HeR/desk)



Më 14 tetor, 2022, për herë të parë, publikisht është thirrur ezani në Xhaminë e Këlnit (Köln), Gjermani. Me këtë fillon të tregohet zemërgjerësia e institucioneve gjermane për një të drejtë legjitime të pjesëtarëve të Islamit si qytetarë të barabartë në shoqërinë ku veprojnë dhe jetojnë, thuhet në njoftimin e BFI, ilustruar me këtë fotografi.

NË VIZITË MANASTIRIT BENEDIKTIAN NË EINSIEDELN

Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër (KMSHZ/DAIGS) më 3 tetor, 2022, i bëri një vizitë Manastirit Benediktian në Einsiedeln, Kanton Schwyz. Në manastirin e veçantë dhe historik ishte një grup imamësh nga Xhamitë Shqiptare, thuhet në njoftimin e KMSHZ.

Zt. Cyrill ishte murgu që priti delegacionin dhe i cili bëri, gjithashtu, prezantimin e hapësirave të ndryshme të Manastirit, duke shpjeguar besimet, mësimet kryesore dhe praktikat e tyre.

Për mysafirët u shtrua edhe një drekë, sipas standardeve islame, kurse për faljen e namazit të drekës ishte përgatitur salla, shtruar me një tepih të stilit oriental, me drejtimin kah Kibla.

Po ashtu, imamët patën mundësinë të ndjekin live lutjet e mesditës nga ana e murgjve të Manastirit. Si pjesë e programit ishte edhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojave të shërbyesve fetarë, sidomos tema u fokusua te mënyra e lutjeve në Islam dhe te të krishterët e urdhrorit benediktian.

Kryetari i KMSHZ, hfz. Mehas Alija, falënderoi nikoqirët për mikpritjen e përzemërt dhe i ftoi edhe ata që në vitin e ardhshëm të vizitojnë njëherë prej Xhamive Shqiptare në Zvicër.

Ndër të tjera, ai potencoi se "qëllimi vizitës është njohja e ndërsjellë; sepse, me njohjen e njëri-tjetrit, ne i shmangim paragjykimet dhe ndihmohemi mes vete".

"Sot tradita judeo-krishtere-islame në Evropë përfaqëson një vlerë të veçantë dhe

të gjithë, ndaj duhet ta ruajmë dhe ta kultivojmë në frymën e paqes dhe të harmonisë", u shpreh Kryetari i KMSHZ-së në fjalën e tij përshëndetëse.

Imami mr. Rejhan Neziri, ndërkaq, foli për ibadetet dhe lutjet në Islam, duke shpjeguar natyrën dhe simbolikat e tyre.

Ky organizim u ndërmjetësua nga imami në Thun, Azir ef. Aziri, dhe aktivisti për dialog ndërfaqësor dhe ndërkulturor, Hans Weber, po ashtu nga qyteti i Thunit.

Nga pjesëmarrësit u vlerësua se ishte një përvojë e re, si për imamët, ashtu dhe për murgjit e Manastirit, thuhet në njoftimin e KMSHZ.

Në faqen e vet në Facebook, Rejhan ef. Neziri vizitën e ka quajtur "një përvojë e re për imamët dhe për murgjit e Manastirit". Abdurrahman Iseni, një nga pjesëmarrësit, ka deklaruar: "Ishte një ditë e jashtëzakonshme, një surprizë, prej së cilës ne të gjithë mbetëm të mahnitur. Falënderojmë vëllain tonë të dashur Hans (Weber) për këtë organizim të jashtëzakonshëm, falënderojmë dhe imamët e nderuar. Në të ardhmen, vizitat e tilla të ndërsjella do të vazhdojnë dhe, në këtë mënyrë, do të ndihmojmë që të rriten miqësia dhe respekti i ndërsjellë."

Synimet e vizitës dhe të dialogut ndërfaqësor:

• Ndërgjegjësimi rreth koncepteve dhe praktikave fetare, si dhe rëndësia e tyre qendrore në formimin dhe zhvillimin e njohurive; ndërgjegjësimi për premisat dhe



qëllimet e tyre, duke u përballur kështu me to, si një domosdoshmëri për të komunikuar me botën e ideve dhe të doktrinave, për të identifikuar teoritë dhe qasjet që përbëjnë sistemet intelektuale dhe teologjia spekulative.

• Heqja e paqartësisë rreth shumë termave dhe koncepteve që përdoren shpesh në mënyra të gabuara ose të keqinterpretuara. Meqenëse shumë nga problemet konjitive vijnë nga shqetësimi i të kuptuarit në përcaktimin e koncepteve dhe identifikimin e qëllimeve të tyre të vërteta.

• Shpjegimi i realitetit se çfarë nënkuptojnë ritualet dhe adhurimet fetare, siç janë lutjet, namazi, agjërimi; në anën tjetër, sqarimi i praktikave fetare të besimit krishter, lutjet, forma dhe synimet, mesha etj, përdorimi dhe sqarimi i koncepteve në fushat e dialogut qytetëruar mes Islamit dhe Krishterimit, nevoja e dialogut ndërfaqësor dhe efektet pozitive në sajë të trendeve të globalizimit ekonomik, politik, kulturor dhe sistemit të vlerave, ndaj të cilit janë të ekspozuara shoqëritë, veçanërisht në epokën bashkëkohore. (Nehat V. Ismaili)

HANS WEBER, NJË DASHAMIR I ISLAMIT NË ZVICËR

Më 11 tetor, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti në Rijaset një mik të shqiptarëve dhe të myslimanëve në Thun të Zvicrës, i cili po krijon një bashkëpunim të sinqertë me shqiptarët me Qendrën Islame Shqiptare në Thun, ku imam është h. Azir ef. Aziri nga fshati Debresh, bashkëpunim ky i cili e ka afruar dhe e ka njohur me vlerat e Islamit, me parimet e tij racionale dhe me traditat e bukura të myslimanëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi, thuhet në njoftimin e BFI.

Qëllimi i ardhjes së tij është të njihet me vendin tonë, me shqiptarët dhe në veçanti të vizitohet edhe BFI të RMV. Me mysafirin nga Zvicra u bisedua gjerë e gjatë për mbresat e tij të thella nga Islami, për nevojën e afrimit me njerëzit, zhveshjen nga paragjykimet e gabuara dhe tendencioze ndaj Islamit dhe pjesëtarëve të tij, mbi të vërtetën e Islamit si fe të Zotit, të paqes, të kulturës, të dijes, të moralit etj.

Mysafiri i respektuar mbeti i mahnitur me traditat tona burimore, të familjes, të afërsisë me njerëzit dhe të respektit të tyre ndaj të tjerëve.

Hoxhë Azir Aziri nga Debreshi na njoftoi me sinqeritetin e tij në ndihmën ndaj myslimanëve, shqiptarëve në Zvicër dhe gjithmonë në situata të ndryshme ka qenë në shërbim të tyre. Ai prezantoi



edhe në manifestimin në Gostivari "Mirëse erdhe, o Resulullah", ku arriti në momentet e fundit dhe i la përshtypje të veçantë.

Zotëri Hans Weber, ndërkaq, është një personalitet i besimit të krishterë, me një kapacitet të lartë shkencor e fetar, ekspert i dialogut ndërfaqësor në Zvicër e më gjerë.

Falënderime z. Azir ef. Aziri për takimin e inicuar, ndërsa mysafirët - qëndrim të këndshëm në vendin tonë, thuhet në njoftimin e BFI.

Me njoftim ka dalë edhe Xhamia Ikre në Thun dhe në të thuhet:

Bismilahi-Rrahmani-Rrahim.

Më 11.10.2022 Imami i Xhamisë Ikre Thun, Azir Aziri, dhe zvicëran Hans Weber, i cili na ndihmon si shqiptarë dhe

si myslimanë në Zvicër me projekte konkrete për prezantimin e Islamit në institucionet dhe shoqërinë zvicëranë, u takuan me Resul'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe bashkëpunëtorët e tij në selinë e BFI të RMV.

Ishin të fascinuar nga mikpritja dhe bisedat me haxhi Reis Shaqir ef. Fetahun, ku morëm dhe përkrahjen e tij dhe të institucionit që udhëheq për projektet tona të ardhshme në sferën e shkëmbimit ndërkulturor dhe ndërfaqësor.

Edhe një herë shfrytëzojmë rastin t'i falënderojmë publikisht për mikpritjen, për bisedat dhe përkrahjen e tyre në projektet tona, duke e lutur Allahun (xh. sh.) që të na japë sukses dhe bereqet, thuhet në njoftimin e Xhamisë Ikre në Thun, Zvicër.

BOSHNJAKËT, PJESË E PANDASHME E BFI-së

Më 12 tetor, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti Kryetarin e Forumit Nacional Boshnjak z. Xhevat Hot, thuhet në njoftimin e BFI.

Ishte një takim shumë i dobishëm, gjatë të cilit u bisedua për organizatën që ai udhëheq, për rolin e saj në ngritjen e vetëdijes së popullit boshnjak në RMV, për organizimin e jetës fetare të boshnjakëve këtu, për vlerat nacionale e kulturore, si dhe për shumë tema të tjera.

Nga ana e tij, z. Xhevat Hot shprehu falënderimin e tij për pritjen që iu bë nga Kryetari i BFI të RMV dhe shprehu gati-shmërinë për bashkëpunim mes dy institucioneve. Ai bisedoi edhe për xhaminë



në qytetin e Shkupit ku ligjërohet në gjuhën boshnjake, me çka plotësohen dëshirat e boshnjakëve në këtë qytet në ngritjen e vetëdijes së tyre fetare e kombëtare.

BFI, si gjithmonë, dha përkrahjen maksimale, duke i konsideruar myslimanët boshnjakë pjesë përbërëse të BFI të RMV, me të gjitha të drejtat që iu takojnë të gjithëve, thuhet në njoftimin e BFI.

OH "HILAL" MBËSHTET "SHTËPINË E PËRBASHKËT"

Më 13 tetor, 2022, Kryetari i Organizatës Humanitare Hilal, që funksionon në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, h. Fadil ef. Ramadani, u takua me kryetaren dhe me aktivistët e Shtëpisë së Përbashkët për nëna dhe fëmijë nga Ukraina - Shkup, me të cilët pati një bisedë informative për gjendjen e të zhvendosurve të luftës nga Ukraina që qëndrojnë në vendin tonë, thuhet në njoftimin e BFI.

Delegacioni i SHTËPISË SË PËRBASHKËT për nëna dhe fëmijë nga Ukraina - Shkup përbëhej nga: Kryetarja znj. Viktoria Gegova, z. Aleksandar Bondarenko dhe znj. Rolanda Prevalla Kadriu - aktivistë. Kryetarin e OH "Hilal" e shoqëronte prof. Nizam Reshit, Përgjegjës për marrëdhënie me Turqinë.



Pas bisedave dhe konsultimeve të mëtejshme, u ra dakord që organizata humanitare "Hilal", në mbështetje të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, të bëjë përpjekje që me sa ka mundësi të ofrojë

ndihma humanitare në veshmbathje dhe ushqime për familjet e zhvendosura nga Ukraina gjatë periudhës së dimrit që po afron e që janë nën përkujdesjen e vazhdueshme të "Shtëpisë së Përbashkët", thuhet në njoftimin e BFI.

PJESËMARRJE NË KONFERENCËN E KAJROS

Më 18 tetor, 2022, përfundoi Konferenca ndërkombëtare në Kajro (Egjipt), e organizuar nga Myftinia e Egjiptit, në krye me Myftiun - Shkëlqesinë e Tij dr. Esh Sheuku al-Lam dhe nën përkujdesjen e Presidentit të Republikës së Egjiptit, z. Abdul Fetah Es-Sisi, thuhet në njoftimin e BFI.

Konferencën në emër të Kryetarit të Qeverisë, dr. Muhamed Medbuli, e përshëndeti Ministri i Vakëfeve në Qeverinë e Egjiptit, dr. Muhammed Muhtar Xhum'ah.

Në këtë konferencë morën pjesë afër 100 delegacione nga të gjitha vendet e botës, edhe atë: personalitete të sferës akademike, kulturore, ekonomike, politike, si dhe prijës të jetës fetare islame të shumë vendeve.

PËR ZGJIDHJET QË I SHEH ISLAMI

Në Konferencë u parashtruan çështje që kanë të bëjnë me sfera të ndryshme të jetës njerëzore dhe si i sheh Islami ato dhe zgjidhjet që mund t'i japë në frymën e Kuranit dhe të Hadithit.

Delegacionin e BFI të RMV e udhëhoqi vetë Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili pati ftesë të posaçme nga vetë Myftiu i Egjiptit, dhe në të ishin bashkëpunëtorët e tij h. Ismet ef. Ademi dhe dr. Abdulkerim Iseni.

Është e rëndësishme të përmenden edhe takimet e ndryshme që u realizuan dhe shpjegimi i organizimit të jetës fetare islame në BFI të RMV dhe më gjerë, si dhe njoftimi me përvoja të ndryshme nga vende të ndryshme të botës.

Takimet me Myftiun dhe dijetarin e

madh dr. Ali el-Xhum'ah, me Rektoren e Universitetit të Ez'herit, me Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Bashkësive Islame Botërore, dr. Muhamed Beshar dhe me shumë personalitete të tjera, ofruan hapësirë për dëgjim dhe këmbim të dijes dhe të përvojave të tyre në jetën shkencore.

Konferenca dyditore u mbajt në hotelin e njohur "Almasa" në Kajro dhe kaloi në një ambient shkencor dhe debatues. Konferenca u shqua me organizim të nivelit të lartë, me pritje të sinqerta dhe me program të përpiktë nga ana e organizatorëve.

Si përfundim i Konferencës dolën konkluzionet e saj, të cilat në fjalën e fundit i konfirmoi Myftiu egjiptian prof. dr. Esh Sheuki al-Lam, thuhet në njoftimin e BFI.

Konferenca e Kajros filloi më 17 tetor, thuhet në njoftimin e parë të BFI.

Në hapjen solemne të saj ishin mbi njëqind delegacione nga e gjithë bota. Me pjesëmarrje në këtë konferencë është Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga h. Ismet ef. Ademi, Drejtor për Marrëdhënie me Botën Arabe, dhe dr. Abdulkerim Iseni, Shef i Kabinetit të Reis'ul-Ulemasë.

Konferencën e shpalli të hapur Myftiu i Egjiptit, dr. Sheuki Ibrahim al-Lam, i cili në fjalën e tij i përshëndeti të pranishmit, duke i falënderuar për prezencën e tyre. Njëherësh, i shpjegoi qëllimet e Konferencës, e cila do të shërbejë për dhënien e qëndrimeve - fetvave në lidhje me sfidat dhe kërkesat e kohës bashkëkohore.



Fjalën e morën disa nga personalitetet e njohura, në veçanti: Ministri i Vakëfit dr. Muhamed Muhtar Xhum'a, i cili la mbresa të thella në ligjëratën e tij.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja falënderoi nikoqirin për pritjen e mirë, miqësore, thuhet në njoftimin e BFI.

TAKIM ME SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË 'EZ'HERIT'

Gjatë pjesëmarrjes në Konferencën e Kajros, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në kohën e lirë mes paneleve, i shoqëruar nga anëtarët e delegacionit h. Ismet Ademi dhe dr. Abdulkerim Iseni, arriti të organizojë një takim të rëndësishëm me Sekretarin e Përgjithshëm të Universitetit të Ez'herit (Kajro), prof. dr. Nedhir Ajjadin, thuhet në njoftimin e BFI.

Ishte nevojë e domosdoshme që pas vonimit të arritjes së dokumentacionit që kërkohet për nostrifikimin e Medresës Isa Beu, të dërguara para disa muajsh, të shfrytëzohet rasti që t'i dorëzohen drejtpërsëdrejti të gjitha dokumentet e kompletuara konform kërkesës së Universitetit të Ez'herit.

Sekretari i Përgjithshëm prof. dr. Nedhir Ajjadi premtoi se do t'i ndërmarrë të gjitha masat e duhura që kjo çështje të

zgjidhet.

Më tej u bisedua për bashkëpunim edhe në sfera të tjera, me profesorë të 'Ez'herit', si ligjërues dhe profesorë-vizitues etj.

Po ashtu, delegacioni i BFI në Konferencë pati mundësi që ta takojë Rektoren e Universitetit të Ez'herit, Shkëlqesinë e Tij prof. dr. Selame Daud, me ç'rast patën një pritje të mirë dhe vëllazërore, duke kërkuar informim sa më të shpejtë, thuhet në njoftimin e BFI.

PRANOHEN STUDENTËT TANË NË 'EZ'HER'

Pas takimit më 17 tetor të Kryetarit të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me Sekretarin e Përgjithshëm të 'Ez'herit' dr. Nedhir Muhamed Ajjad, menjëherë më 18.10.2022 morëm lajmin se Shejhul-Ez'heri e ka pranuar kërkesën e Reis'ul-Ulemasë dhe të delegacionit të BFI të RMV, kështu që të gjithë kandidatët për regjistrim në këtë vit, pa përjashtim, i kanë dyert e hapura në Universitetin prestigjioz të 'Ez'herit'. Në emër të BFI të RMV, i shprehim mirënjohjet tona Shejhul-Ez'herit, prof. dr. Ahmed Et-Tajjib, për vendimin e tij dhe i bëjmë lutje Allahut fuqplotë që t'i japë shëndet dhe jetë të gjatë, thuhet në njoftimin e BFI (18.10.2022).

NJË TAKIM ME STUDENTËT TANË

Një takim me studentët tanë – si një kurorëzim i bukur i aktiviteteve të delegacionit të BFI të RMV, i udhëhequr nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, gjatë qëndrimit në Kajro, thuhet në njoftimin e BFI të datës 19 tetor, 2022.

Me këtë akt, Kryetari i BFI tregoi kujdesin si institucion fetar islam ndaj studentëve, institucion që është dhe baza dhe foleja e tyre, sepse studentët tanë janë pasuria dhe vlera më e shenjtë e BFI të RMV, duke qenë se ata paraqesin ardhmërinë e Islamit në vendin tonë.

Takimi me studentët la përshtypje të veçantë, sepse ata me seriozitetin e tyre dëshmuar se janë të paluahshëm në studimet e tyre në 'Ez'herin' e famshëm.

Me këtë rast, dhe në këtë takim mjaft të këndshëm, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu i falënderoi studentët për kujdesin që patën dhe u premtoi ndihmën e domosdoshme të BFI, si e vetmja shtëpi e tyre, të cilën, si të tillë, edhe duhet ta kuptojmë dhe ta trajtojmë.

Ardhmëria e tyre do të jetë e begatshme dhe përplot me obligime në bartjen e shenjtë të amanetit për një jetë me besim, me moral, me dinjitet dhe në shërbim të vatanit dhe të mirëqenies së përgjithshme. E tyre është të shfrytëzojnë fatin dhe nderin që janë studentë të El-Ez'herit të famshëm dhe atë maksimalisht ta shfrytëzojnë në formimin intelektual fetar-shkencor të tyre. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.



Me studentët tanë në Kajro (Egjipt).



BOTIME TË REJA PËR SHQIPTARËT NË PANAIRIN E RIJADIT

Më 9 tetor, 2022, Lulzim Mjeku (Lul Mjeku), Ambasadori i Republikës së Kosovës në Rijad (Riyadh), Arabia Saudite, në faqen e vet në Facebook ka shkruar:

Botime të reja për shqiptarët dhe Kosovën në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Rijad.

Në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Rijad, i cili u mbyll dje, pata rastin të vizitoj stendën e botuesit "Al-Alaan" nga Jordania dhe të kem në dorë botimet për shqiptarët dhe për Kosovën në gjuhën arabe, nën përkujdesjen e akademik Muhamed Mufaku Alarnaoot.

Pas botimit vitin e kaluar të librit me udhëpërshkrime, "Sijahatname, përzgjedhje për shtetet e Ballkanit" të Evliyâ Çelebi-së, ku paraqiten të gjitha trojet shqiptare, po nën përkujdesjen e studimit të prof. Muhamed Mufakut sivjet pata rastin të shoh botimet më të reja si: "Hasan Kaeshi: Islami, kultura dhe politika në Ballkan" - studime të zgjedhura me rastin e 100-vjetorit të lindjes së tij, përkthyer e përgatitur nga dr. Muhamed Alarnaoot dhe "Shemsudin Sami Frashëri, gërshtim mes osmanizmit, nacionalizmit dhe Islamit" - përgatitje dhe prezantim nga dr. Muhamed Alarnaoot dhe "Shpërngulja e shqiptarëve në Damask në shekullin XX dhe kontributi i tyre në jetën kulturore" nga dr. Muhamed Alarnaoot.

Komplimente për punën shumë të vyeshme të prof. Mufakut për praninë e kulturës shqiptare në Panairin më të madh të librit në botën arabe, përfundon z. Lul Mjeku.



Nga takimi me Sekretarin e Përgjithshëm të Universitetit të Ez'herit, prof. dr. Nedhir Ajjadin.

NEXHVA, HAFËZJA E KATËRT E FAMILJES IMERI NGA LIKOVA

Më 20 tetor, 2022, Myftinia e Kumanovës promovoi hafëzen e re Nexhva Imeri nga fshati Likovë, thuhet në njoftimin e BFI.

Nexhva Imeri është hafëzja e katërt e familjes Imeri. Para saj hivzin e kanë kryer vëllai Seidi dhe motra Sara. Në këtë familje hafëze është edhe bashkëshortja e hfz. Seidit, Xheljane Imeri Zendeli. Mbresë e veçantë është fakti se vëllai i hafëzes së re, hafëz Seidi, ka qenë edhe muhafiz i saj, tek i cili e ka kryer hivzin hafëze Nexhva.

Ishin të pranishëm Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me delegacionin e drejtorëve të sektorëve të Rijasetit. Po ashtu, ishin Myftiu i Kumanovës, h. Abedin ef. Imeri me bashkëpunëtorët, myftinjët e Myftinive të tjera të BFI, si: Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, Myftiu i Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi, Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli, Myftiu i Kërçovës mr. Qamil ef. Rushiti, Myftiu i Manastirit h. Amit ef. Rasimi, Dekani i FSHI prof. dr. Shaban Sulejmani, profesorë nga FSHI dhe nga Medreseja Isa Beu, Kryetari i Kuvendit të BFI Fejsal ef. Kadriu, imamë dhe shumë mysafirë. Nder i veçantë ishte pjesëmarrja e Kryetarit të Komunës së Likovës, z. Erkan Arifi dhe e Kryetarit të Bashkësisë Islame



– Preshevë, mr. Nexhmedin ef. Ademi. Po ashtu, kishte shumë besimtarë e mysafirë si nga vendi, ashtu dhe nga jashtë.

Solemnitetin e udhëhoqi Referenti i Myftinisë së Kumanovës, h. Sadullah Abdullahu, ndërsa tubimin e uroi nikoqiri dhe organizatori i kësaj ceremonie, h. Abedin ef. Imeri, Myftiu i Myftinisë së BFI-Kumanovë, i cili të pranishmëve u dëshiroi mirëseardhje dhe uroi hafëzen e re për hivzin e kryer.

Falënderim të veçantë përcolli në fjalimin e tij hafëz Seid Imeri, në emër të familjes dhe të gjyshit të tij, h. Rexhep Imeri.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, pati fjalën kryesore, me ç'rast fil-

limisht uroi familjen Imeri për katër hafëzat që tanimë i ka në gjirin e vet dhe në veçanti uroi hafëzen e re Nexhva Imeri për suksesin e saj, për përkushtimin ndaj Kuranit famëlartë. Reis'ul-Ulemaja gjithashtu përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe dëshiroi që raste të tilla të jenë sa më të shpeshta dhe, njëherësh, falënderoi edhe muhafizin dhe imamët e fshatit Likovë.

Në fund të ceremonisë, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me Myftiun e Kumanovës h. Abedin ef. Imeri, i ndanë Certifikatën e Hifzit hafëzes së re Nexhva Imeri.

Duanë e bëri Imami i mirënjohur Eljesa ef. Mahmudi, thuhet në njoftimin e BFI.

KULTIVIMI I HIFZIT NË KOMUNËN E LIKOVËS

Nga Seid Fejzuli

Kultivimi i hifzit në Likovë filloi pas Luftës së Dytë Botërore, kur kadri fetar filloi të përgatitet nëpër hoxhallarë. Nder të parët ishin hoxhë Xhafer Azizi dhe Iljaz Isufi nga fshati Mateç, të cilët nxënësit i mësonin në mejtepin e fshatit Likovë; pastaj Ibrahim ef. Latifi nga fshati Opajë etj.

Kultivimi i hifzit nuk kishte të ndalur: numri i hafëzëve në këtë rajon filloi të shtohet nga të dyja gjinitë. Nder ata që dhanë kontribut më të madh në kultivimin e hifzit ishin: 1. Hafëz Adem Ebibi i fshatit Hotël; 2. Hafëz Besim Abazi, po ashtu nga fshati Hotël; 3. Hafëz Refik Ajeti nga fshati Likovë.

Të përgatitës hoxhallarë, nuk ishte punë e lehtë në ato kohëra të vështira, për shkak se mësuesit e tyre vazhdimisht ishin në shënjestër të pushtetit.

Por, edhe pas shumë trysnive, ata asnjëherë nuk u dorëzuan: me vullnetin e tyre vazhduan me këtë mision.

Një rrëfim i hoxhës së fshatit Opajë (Ibrahim ef. Latifi) ka treguar për vështirësitë që janë përjetuar gjatë mësimbesimit islam pas periudhës së LDB-së: “Ishte vështirë që ta zhvillojmë mësimbesimin islam, sepse ishte e ndaluar. Unë kisha dy hafëze që i përgatisja; nuk guxoja t’i mësoja në xhami apo në shtëpi. Për t’ia ndërruar dergin, dilnim në periferi të fshatit dhe bënim rojë, duke ruajtur rrugën që mos të na zënë gjatë mësimt. Hafëzi rrinte poshtë, në tokë, lexonte Kuran, ndërsa unë e përcillja nga lart, ku bëja rojë. Kështu ka qenë më herët.”

Komuna e Likovës në rrethin më të gjerë vazhdon të njihet për kultivimin e hifzit. Nder fshatrat janë vetë Likova, Hotla, pastaj Mateçi, Orizarja, Sllupçani, Opaja. Nder kontribuesit e kultivimit të hifzit në dy dekadat e fundit në tërë territorin e



lartpërmendur janë: 1. Hafëz Bajram ef. Ajeti, imam i fshatit Likovë; 2. Hafëz Abdulkadër ef. Abazi, imam i Xhamisë së Poshtme në fshatin Hotël.

Tradita e kultivimit të hifzit vazhdon edhe te kadri i ri. Gjatë këtyre ditëve jemi dëshmitarë në Xhaminë e Epërme të fshatit Likovë, ku kandidatja në mënyrë publike, në përbërje të Komisionit të Myftinisë së BFI-Kumanovë dhe muhafizit më të ri të këtij rajoni, hafëz Seid Imeri, është duke dhënë provimin e nxënies përmendsh të Kuranit.

Allahu (xh. sh.) i begatoftë vendet tona me rojtarë dhe mbrojtës të Kuranit! Amin.

Shënim: Gjatë përpilimit të këtij teksti është shfrytëzuar dhe libri “Dëshmi kohe-Historiku i Myftinisë së Kumanovës” nga Enver Zeqiri, Kumanovë, 2012. (Fcb/në bashkëpunim)

PROMOVOHET HAFËZE EBRU AJDARI

Më 14 tetor, 2022, është promovuar hafëze Ebru Ajdari në Shkup, thuhet në njoftimin e BFI.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast kanë marrë pjesë Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga Myftiu i Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili, nga Kryetari i Kuvendit h. Fejsall ef. Kadriu, nga stafi i Kabinetit të Reis'ul-Ulemasë, stafi i Myftinisë së Shkupit, profesorë të Medresesë Isa Beu, hafëzllarë, hoxhallarë dhe xhematlinj. Ata ndanë gëzimin e familjes Ajdari pas kryerjes së Hifzit nga hafëzja e re Ebru Ajdari.

I bëjmë lutje Allahut fuqiptotë që hafëze Ebrun, muhafizen Munevere Murtezi, prindërit dhe familjen e gjerë t'i begatojë me mirësi të shumta në këtë botë dhe në botën tjetër, thuhet në njoftimin e BFI.



SHQIPTARËT DHE KONTAKTI I PARË ME STAMBOLLIN

Si zakonisht, ditëve të diela, pas sportit, vazhdova me leximin e një pjese të librit të famshëm të Evliya Çelebia „Sejahatname“ (Libri i Udhëtimeve). Aty diku kah faqja 115 flitet për Stambollin në duart e sulltan Mehmet Fatihut.


Ajo që më ra në sy ishte fakti që në vitin 1453/54, menjëherë pasi merret kalaja e Stambollit, për të banuar dhe për të jetuar brenda tij janë ftuar popujt e Perandorisë Osmane nga të gjitha anët ku ajo ka sunduar.

Kështu, në këtë qytet shumë të dëshiruar për gjithkënd, pos shumë popujve vjen edhe „populli i Shkupit“: „Fillimisht sollën popullin e Shkupit të Rumelisë dhe e vendosën në lagjen e shkupjanëve“ - shkruan në një vend, ndërsa më poshtë përmendet dhe emri „shqiptarët“. Edhe lagja e merr po këtë emër dhe ajo njihet edhe sot ashtu.

Ky duhet të jetë dhe kontakti i parë i shqiptarëve me Stambollin (Konstandinopoljen).

Nëse do e lexoni këtë vepër të udhëpërshkruesit osman, do të vëreni dy gjëra interesante: E para, është objektiviteti sa i përket paraqitjes së gjërave që ai shikon. Në shumë raste shkruan dhe mbi padrejtësitë që janë bërë brenda shtetit të madh osman. E dyta, shihet qartë ndikimi i mësimëve të dervishëve të asaj kohe. Ndikimi i tyre tek udhëheqësit dhe populli ka qenë shumë i madh dhe njerëzit besonin se dervishët janë më shumë se vetëm dijetarë. Në të shumtën e rasteve dervishët paraqiten si njerëz me fuqi të veçanta dhe njerëz që i parashikojnë ndodhitë, para se ato të ndodhin. Në këtë drejtim gjërat duken joreale dhe të hiperbolizuara.

Megjithkëtë, Libri i Udhëtimeve është një vepër me shumë detaje ineter-



sante dhe të dhëna nga vende të ndryshme të Perandorisë Osmane. Ju sugjeroj ta lexoni.

Përgatiti: Irfan Agushi

MBLEDHJE E RREGULLT E MYFTINISË SË KËRÇOVËS

Më 6 tetor, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ishte i ftuar në Mbledhjen e rregullt të Këshillit të Myftinisë së Kërçovës, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i BFI-së u mirëprit nga Myftiu Qamil ef. Rushiti, bashkë me administratën e Myftinisë dhe anëtarët e Këshillit të Myftinisë.

Në Mbledhjen e rregullt, që u mbajt, u raportuan aktivitetet e realizuara nga muaji i begatë i Ramazanit, Kurhani, Haxhi i sivjetëm, informimi rreth ecuresë së punëve të objektivit të Myftinisë dhe zgjerimi i zyrave të saj, planifikimi i ndërtimit të një xhamie të re në qytetin e Kërçovës, planifikimi i ndërtimit të një objekti të ri që do të jetë me karakter social – morg dhe organizim të ceremonive mortore.



Myftiu i nderuar, Qamil ef. Rushiti, bashkë me administratën e Myftinisë raportuan rreth aktiviteteve dhe planeve të tyre për të ardhmen.

Në fund, në fjalën e tij përshëndetëse Reis'ul-Ulemaja uroi Myftiun Qamil ef.

Rushiti dhe të gjithë myslimanët kërçovarë për organizimin e mirëfilltë të jetës fetare, duke dëshiruar prosperitet dhe mirëqenie për Myftininë dhe popullin kërçovar në përgjithësi, thuhet në njoftimin e Shërbimit për Informim të BFI.

"ILMIHALI", NË TRI GJUHË

Myftinia e Shkupit ka botuar këto ditë veprën "Ilmihal për mejtepe", të përkthyer në tri gjuhë: maqedonisht, boshnjakisht dhe turqisht (pas botimit shqip), thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Me këtë vepër bëjmë përpjekje modeste që veprat dhe materialet mësimore t'i përkthejmë dhe t'i përshtatim në të gjitha gjuhët e nxënësve dhe mualimëve që realizojnë procesin e mësimbesimit në mejtepe.

Tanimë në dorën e tyre është edhe Ilmihali për mejtepe në gjuhën: maqedonase, boshnjake dhe turke.

I bëjmë lutje Allahut fuqiplotë, të gjithë ata që ndihmuan e kontribuan që ky botim të përkthehet, t'i shpërblejë me mirësitë e Tij të pakufishme, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.



"Sot na nderuan me vizitë mysafirë nga Republika e Turqisë: hoxha i respektuar z. Ali Bullut, drejtor i përgjithshëm i kolegeve 'Pınar' (Pënar) në Ankara; z. Kemal Servi, pronar i fabrikës 'Feta Laboratuvar' në Ankara; si dhe prof. dr. Ibrahim Erdoan (İbrahim Erdoğan), këshilltar në Ministrinë e Arsimit dhe profesor universitar, të cilët i shoqëronte Myftiu i Myftinisë së Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli. Zoti i nderoftë dhe i shpërbleftë me të mirat e Tij të pakufishme për vizitën", ka shkruar Myftiu i Myftinisë së Ohrit, Samet ef. Ajdari, në faqen e vet në Facebook më 8 tetor, 2022.

BULUT DHE SERVI VIZITOJNË RIJASETIN

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 11 tetor, 2022, priti në Rijaset dy miqtë e BFI të RMV: h. Ali Bulut (Bullut), drejtor i përgjithshëm i kolegeve "Pınar" (Pënar) në Ankara dhe z. Kemal Servi, pronar i fabrikës "Feta Laboratuvar" në Ankara, Turqi, thuhet në njoftimin e BFI.

Gjatë qëndrimit të tyre në vendin tonë me rastin e "Javës së Mevludit", Reis'ul-Ulemaja shfrytëzoi rastin që ta respektojë dëshirën e tyre për një takim miqësor, ku kaluan çaste të rëndësishme, duke biseduar për shumë çështje në dobi të kultivimit të vlerave fetare e kulturore, si dhe të zhvillimit të procesit arsimor në RMV dhe në Republikën e Turqisë.

Hoxhë Ali Bulluti është një udhëheqës i madh që drejton kolegjin "Pënar", i



njohur për nga numri i madh i nxënësve dhe nxënësve dhe është shembull për këtë sferë. Zotëri Qemal Servi, ndërkaq, është një afarist i mirënjohur në Turqi dhe në shumë vende të botës. Që të dy janë donatorë të mëdhenj në shumë vende të botës islame.

Me këtë rast të takimit, Reis'ul-Ule-

maja u shprehu falënderimet e BFI për kontributin e madh në ndërtimin e ndërtesës së re të Medresesë në Gostivar - Paralelja e Shtrirë e Vajzave.

Mbeten të paharruara momentet për bashkëpunimin në kohën dhe në situatën e duhur. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e BFI.

BFI ME NGUSHËLLIME PAS SHPËRTHIMIT NË BARTËN



Lutjet tona për minatorët në qytetin Bartën të Turqisë, thuhet në njoftimin e BFI të RMV të datës 15 tetor, 2022.

I lutem Zotit të madhërishtëm që t'u japë mëshirë minatorëve që humbën jetën në aksidentin minerar që ndodhi në qytetin Bartın (Bartën) të Turqisë, shërim të shpejtë për të plagosurit dhe durim për të mbijetuarit.

Dëshiroj të shpreh ngushëllimet e mia në emrin tim dhe të Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, duke shpresuar që këto aksidente tragjike të mos ndodhin më kurrë, thuhet në mesa-

zhin e ngushëllimit të Kryetarit të BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. Agjencia Anadolu (AA) kishte raportuar më 14 tetor se një shpërthim ki-

shte ndodhur në një minierë qymyri në provincën veriore Bartın të Turqisë. Pastaj u njoftua se jetën e kishin humbur mbi 40 minatorë.

KEQARDHJE

Başın sağ olsun Türkiye. Türkiye'nin Bartın kasabasında meydana gelen maden kazasında vefat eden maddencilere Allah'tan rahmet, yaralılara acil şifalar, kalanlara da sabır ihnası etmesini Yüce Allah'tan niyaz ederim. Bu elim kazaların bir daha tekerrür etmemesi temennişiyle şahsım ve Kuzey Makedonya İslam Birliği adına başsağlığı diliyorum. Başın sağ olsun Türkiye.

Reis ul ulema H. Hfz. Şakir ef. Fetai (15.10.2022)

VIZITË E RËNDËSISHME E AMBASADORIT KUÇI

Në vazhden e aktiviteteve të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 12 tetor, 2022, së bashku me Myftiun e Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili në selinë e Rijasetit me kënaqësi pritëm Ambasadorin e ri të RMV në Oslo (Norvegji), dr. Driton Kuçi, thuhet në njoftimin e BFI.

Së pari, mysafirët iu urua detyra e re, duke i dëshiruar shëndet dhe suksese të reja në karrierën e tij. Dr. Driton Kuçi me punën e tij të palodhshme në sfera të ndryshme, vërtet arriti të ngrihet si një personalitet autoritativ me tipare shkencore, morale dhe diplomatike, duke qenë plotësisht në shërbim të ngritjes së vlerave shoqërore, në veçanti të shqiptarëve të RMV, me çka la gjurmë të pashlyeshme në jetën shoqërore-politike në vend dhe më gjerë.



Ambasadori i ri gjithmonë ka qenë në shërbim edhe të vlerave fetare islame, në çdo detyrë që ka kryer: nga posti i Ministrit e deri te postet tjera që i ka ushtruar në sferën politike dhe më gjerë. Duke marrë parasysh se bashkatdhetarët tanë janë aktiv edhe në sferën

fetare në Norvegji, jemi të vendosur për një bashkëpunim të mirëfilltë, me qëllim të organizimit sa më të mirë të bashkatdhetarëve tanë me punë në Norvegji. Zoti i dhashtë shëndet, jetë të gjatë dhe suksese të reja, thuhet në njoftimin e BFI.

TAKIM ME AMBASADORIN E ITALISË NË SHKUP

Më 12 tetor, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, pati një takim shumë të rëndësishëm me Ambasadorin italian në RMV, z. Andrea Silvestri, thuhet në njoftimin e BFI.

I shoqëruar nga Drejtori për marrëdhënie me BE, z. Mustafa Dauti, në takim u bisedua për bashkëpunimin e ngushtë, si dhe për organizimin e bashkatdhetarëve tanë me punë në Itali.

Ambasadori falënderoi për vizitën dhe tregoi përshtypjet e mira që ka për bashkatdhetarët tanë, me çka paraqesin element konstruktiv në shoqërinë italiane.

Gjithashtu, u bisedua edhe për përpjekjet për organizimin e jetës fetare dhe punën e madhe që bëjnë bashkatdhetarët tanë në këtë sferë, për të qenë respektabël në të gjitha sferat e aktivitetit



të tyre në krye me Bashkësinë Fetare Islame të Italisë, të udhëhequr nga Krye-

tari i saj dr. Reshat ef. Ibishi, thuhet në njoftimin e BFI.

"XHAMITË DHE TEQETË NË SHKUP"

Doli nga shtypi libri "Xhamitë dhe teqetë në Shkup" i bashkautorëve Skënder Hasani dhe Nora Maliqi-Zylali, thuhet në njoftimin e Drejtorit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve (ITSHKSH) në Shkup.

Është ky një projekt me studime, dokumente dhe fotografi, mbi të cilin ka

kohë që kemi punuar bashkë me kolegen Nora Maliqi - Zylali. Përkushtimi mbi këtë libër ka qenë një përpjekje jona e vazhdueshme për afirmimin e një të vërtete të rëndësishme për Shkupin tonë shqiptar.

E falënderoj edhe recensentin, kolegën Zeqirija Ibrahim, si dhe mbështetë-

sin e këtij projekti, Myftiun e Shkupit, Qenan ef. Ismaili.

Me këtë rast dua t'ju njoftoj se promovimi i parë i kësaj vepre bëhet dhe në Qendrën Kulturore Islame Shqiptare në Staten Island në Nju-Jork, gjatë Javës Kulturore Shqiptare në SHBA, thuhet në njoftimin e Skënder Hasanit.

ATY KU MBJELLIM FERRA NUK LULËZOJNË TRËNDAFILA

Nga Musa Biba

Sot po qajmë për atë që vetë e kemi ndërtuar.

Menduam se, të jetosh si i lirë, do të thotë që ke të drejtë të bësh çka të duash, të flasësh çka të duash, të shkosh ku të duash, të dalësh nga shtëpia dhe të kthehesh kur të duash, të veshësh çka të duash, të ledhatohesh me kë të duash - me arsyetimin se është jeta jote etj. etj., pa i pasur aspak parasysh kriteret morale, kriteret edukative dhe kriteret njerëzore.


Pa dyshim, ky është rezultati.

A mos po mendojmë ne që aty ku mbjellim ferra (a therra), të mbijnë trëndafila?! Sigurisht që JO! Nuk mbijnë trëndafila aty mbjellim ferra.

Ky është rezultat i një njeriu "bashkëkohor", që nuk i njeh kufijtë e vet, të familjes dhe të vendit të vet; ku çdo send i duket në rregull dhe normale. Aty ku, ndonjëherë, edhe kafsha turpërohet më shumë sesa disa "njerëz".

Andaj, harrojeni që nga rrugët që ka zgjedhur shoqëria sot për edukim, me filma degjenerues, me emisione shkatërruese (Big Brother, PërPuthen etj.), me koncerte ku në krye të skenës qëndron "edukatori/ja" dhe ju drejtohet me këngët më të fëlliqura e më provokative, ku mund të jenë çdo gjë - vetëm edukim jo, ku epshi bëhet "zot" dhe Zoti i Vërtetë as që mendohet, diçka tjetër, të hairit, as që mund të pritët.

Në një kaos të tillë, ku çdo gjë llogaritet normale, ku babai e nënçmon djalin pse nuk ka gjetur një femër për të kaluar kohën - sikur ato femra të jenë të përgatitura për këtë "bukurosh", e nga ana tjetër blen teshat më provokuese për vajzën e vet, që të duket "më bukur", pa dyshim se do të prodhohen shkatërrimtarët e familjes dhe të shoqërisë, ku krejt në fund ne do të jemi përsëri ata që do të derdhim lot për fëmijët tanë.



Por, mos të harrojmë: këtë rrugë e zgjedhëm vetë ne, për vete, për fëmijët tanë...

E, pra, "nëse duam diçka ndryshe, le të ndryshojmë"! Sa nuk është vonë, sigurisht.

(Autori është Referent fetar-arsimor në Myftininë e Strugës)

NËNA TEREZE NË FOTO ME MYFTIUN SABRI EF. KOÇI

Nobelista shqiptare, Nena Tereze, në një fotografi të siguruar nga gazeta NewBorn shihet së bashku me hoxhën hafëz Sabri ef. Koçi dhe një motër shqiptare, të quajtur Ançilla.

Kjo fotografi simbolizon një gjë shumë të rëndësishme për shqiptarët: tolerancën ndërfaqetare!

Hoxha Sabri ef. Koçi për vdekjen e nobelistes ka thënë: "Vdekja e Nënës Tereze ishte vdekja më e rëndë për kombin tonë!" (Telegrafi, 2.08.2015)

Kryeministri Edi Rama, ndërkaq, më 28 maj 2017 në "Koha Jonë" ka shkruar: "Haxhi hafëz Sabri Koçi është një prej prijësve më emblematikë të Islamit shqiptar. Është me origjinë nga Librazhdi.

Emancipues i myslimanëve në Shqipëri qysh në kohën e diktaturës, ai nuk do të jetë vetëm një nga rimëkëmbësit kryesorë të kultit islam prej 1990 e kënde, por edhe mishërim i dialogut ndërfaqetar dhe mbarëkombëtar, siç e dëshmon edhe kjo fotografi e vyer së bashku me Shën Terezën e Kalkutës, Nënë Terezën e shqiptarëve."

Fotografi e rrallë, kanë shkruar edhe të tjerë dhe kanë shtuar: Ambasadorja e humanizmit në botë Nënë Tereza me Myftiun shqiptar haxhi hafëz Sabri ef. Koçi.

Nuk janë siguruar të dhënat se kush është autor i fotografisë dhe kur është bërë ajo.

Sabri ef. Koçi (1921-2004) ka qenë Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë prej shkurtit të vitit 1991 deri në tetor të vitit 2003. (HeR/desk)



CILAT JANË PIKËPAMJET E MBRETIT ÇARLS III PËR ISLAMIN?

Interesi për monarkun e ri të Britanisë së Madhe, mbretin Çarls III, është rritur qëkur ai u ngjit në fron pas vdekjes së nënës së tij, mbretëreshës Elizabet II.

Ndërsa 73-vjeçari ka qenë në sy të publikut për dekada, për Islamit Çarls (Charles) ka shprehur mendimet e tij në disa raste dhe ka folur hapur për respektin e tij për të.

Shkrimtari Robert Jobson në librin e tij "Charles at 70: Thoughts, Hopes and Dreams" ka vënë në dukje se monarku e ka studiuar librin e shenjtë të Islamit, Kuranin, ndërsa letrat për udhëheqësit myslimanë i shkruan në gjuhën arabe.

Për dekada, Çarls ka qenë një avokat i hapur i çështjeve mjedisore, duke u kërkuar liderëve botërorë të kërkojnë zgjidhje të menjëhershme dhe afatgjatë për ndryshimin e klimës.

Në një fjalim në Qendrën e Oksfordit për Studime Islame në vitin 2010, bazuar në njohuritë e tij për Islamit dhe Kuranin, Çarls tha se "ka kufizime për pasuritë natyrore". "Këta nuk janë kufij arbitrar; ata janë kufij të imponuar nga Zoti dhe, si të tillë, nëse kuptimi im i Kuranit është i saktë, myslimanët urdhërohen të mos i kalojnë ato", tha ka thënë ai. Për më tepër, në të njëjtin fjalim ai ka shtuar: "Ne e ndajmë këtë planet me krijesa të tjera për një arsye shumë të mirë – dhe kjo është se ne nuk mund të ekzistojmë vetëm, pa rrjetin e ndërlikuar të ekuilibruar të jetës rreth nesh. Islami gjithmonë e ka mësuar këtë dhe të injorosh këtë mësim, është të shkelësh kontratën tonë me krijimin."

KARIKATURAT DANEZE

Gjatë një vizite në Universitetin Al-Az'har në Kajro, në vitin 2006, Charles kritikoi botimin e karikaturave në Danimarkë, të cilat talleshin me pejgamberin Muhamed, duke u bërë thirrje të gjithëve të respektojnë besimet e të tjerëve.



"Shenja e vërtetë e një shoqërie të qytetëruar është respekti që u jep pakicave dhe të huajve... Përplasjet e tmerrshme dhe zemërimi i kohëve të fundit mbi karikaturat daneze, tregojnë rrezikun që vjen nga dështimi ynë për të dëgjuar dhe respektuar atë që është e çmuar dhe e shenjtë për të tjerët", ka thënë ai.

Karikaturat çuan në një debat rreth urrejtjes antimuslimane dhe kufijve të fjalës së lirë në Perëndim. Ndërkaq, për Ramazanin Çarls ka thënë se "të gjithë duhet të përfitojnë nga fryma e Ramazanit".

"Nuk është vetëm bujaria, por edhe vetëpërbajtja, mirënjohja dhe shoqëria në lutje që do të sjellë ngushëllim të madh për shumë njerëz në mbarë botën. Bujaria e shpirtit dhe mikpritja e myslimanëve nuk pushon të më mahnit dhe jam i sigurt se, ndërsa hyjmë në kohë gjithnjë e më të pasigurta, komuniteti mysliman do të jetë edhe një herë burim i dhurimeve të jashtëzakonshme të Ramazanit."

ISLAMI DHE PERËNDIMI

Çarls ka mbrojtur prej kohësh afrimin mes botës myslimane dhe Perëndimit dhe pretendon se ka pasur "shumë keqkuptime" të Islamit në Perëndim.

"Nëse në Perëndim ka shumë keqkuptime për natyrën e Islamit, ka edhe një injorancë të madhe për borxhin që kultura dhe qytetërimi ynë i ka botës islame. Është një dështim që rrjedh, mendoj, nga tradita e historisë që kemi trashëguar", ka thënë ai në vitin 1993, gjatë një fjalimi të cituar shpesh, në Qendrën e Oksfordit për Studime Islame.

Çarls (Charles) ka paralajmëruar se ekstremizmi nuk duhet parë si një "vulë dalluese" e Islamit, duke thënë se "nuk është më monopol i Islamit sesa monopol i feve të tjera, duke përfshirë Krishterimin." (tesheshi.com/12.09.2022/në bashkëpunim)

Burimi: <https://tesheshi.com/cilat-jane-pikepamjet-e-mbretit-charles-iii-per-islamit>

JETA E NJERIUT I NGJAN ANIJES NË DET

Një rahmet për këtë botë dhe 99 për botën tjetër.
Mos harroni: profetët kanë pasur misione...



Nga Irfan Agushi

Të gjithë bijtë e Ademit janë mëkatarë, por më të mirë prej tyre janë ata që pendohen! Asnjë nuk e fiton dot mëshirën e të madhit Allah me veprat e tij, por secili shpreson në 99 pjesët e mëshirës, të cilat Allahu i ka rezervuar për të penduarit në botën tjetër.

Si t'i matim ato 99 pjesët të mëshirës së Allahut (xh. sh.), të rezervuara për botën tjetër? Një pjesë nga 100 pjesët e Mëshirës së Allahut janë shpërndarë në tokë, në det, në atmosferë. Prej saj gjallëron jeta në planet. Prej saj rrjedh uji i pijshëm. Prej saj thithim ajrin e pastër. Prej saj shijojmë ngrohtësinë e diellit. Prej saj perimeve, të pemëve, të ushqimeve të detit dhe të tokës, të bulmetrave dhe të mirësive tjera. Prej saj nëna mëshiron fëmijën e vet, i fuqishmi të dobëtin, i pasuri të varfrin etj.

Thotë Muhamedi (salallahu alejhi ve sel lem): "Allahu ka 100 rahmete, mëshira. Njëren prej këtyre mëshirave e ka zbritur mes xhindeve dhe njerëzve dhe mes kafshëve. Me këtë mëshirë ata mëshirohen mes vete - madje edhe egërsira mëshirohen të vegjlit e saj - ndërsa Allahu ka mbajtur për Vete 99 mëshirat tjera, për t'i mëshiruar robtë e Tij në Ditën e Kiame-

tit." (Buhariu dhe Muslimi)

Nëse kaq e madhe është një pjesë e mëshirës së Allahut që na e dhuroi në këtë botë, mendojeni një herë se sa e madhe është pjesa tjetër, të cilën e ka rezervuar për ne në botën tjetër. Për ta merituar mëshirën e Zotit në botën tjetër, duhet plotësuar një kusht e ai është: të vdesim duke besuar dhe adhuruar Allahun si një dhe të vetëm, pa i bërë shok Atij. All lllahumme sal li ala Muhammed.

Jeta e njeriu i ngjan anijes në det, e cila lundron ditë e natë - në kohë të mira dhe në kohë të vështira, në net të errëta dhe në net plot hënë, në një ditë ose në një natë... Pas kësaj, krejt papritur, përfundon lundrimi dhe fillon fundosja.

Nëse e keni dertin e pasurisë mbi anije, atëherë mbusheni atë me pasuri që s'përmbytet dot. Sadakaja do ta vazhdojë lundrimin edhe pasi anija të fundoset; po ashtu dhe sjellja e mirë me njerëzit, bamirësia, shpikjet teknologjike të hairit, lënia pas e një bezi për të të përmendur të tjerët që do të luten pranë tij; një libër i dobi-shëm... Të gjitha këto janë pasuri, të cilat do ta vazhdojnë lundrimin edhe atëherë kur anija jote të ketë përfunduar në shtratin e detit.

Thotë Ibn Kajjimi (Allahu e mëshiroftë): "Nëse doni të merrni pasuri, atëherë"

merrni pasuri e cila nuk do të përmbytet kur të prishet anija."

Shumë politikanë e kanë ngatëruar fjalën "misionar" me atë që ata bëjnë! Një politikan mund të jetë çfarëdo tjetër, por jo "misionar". Një "misionar" nuk bën kompromise, ndërsa politika është kompromis /allishverish/: 'më jep këtë, të ta jap atë'... Në anën tjetër, në fushën e premtimeve nuk ka asnjë lloj etike. Para zgjedhjeve një politikan është në gjendje të premtojë edhe gjërat më absurde.

Habit fakti, ndërkaq, që populli vazhdon t'u besojë gënjeshtrove të njëjta. Nuk do të habitem nëse një ditë, kur të zgjohemi, të na premtohet dhe dalja në det, në një kohë kur detin e kemi mbi 300 km larg.

Mision kanë pasur Profetët, dijetarët e mëdhenj, njerëzit revolucionarë, të cilët i kanë ndryshuar rrjedhën historisë. Në një shtet ku për çdo vit shkollor, në vjeshtë, nxënësit ballafaqohen me mungesë tek-stesh dhe pajisjesh shkollore, nuk mund të flasim për misione e as për misionarë, por për politika të dështuara, pas të cilave qëndrojnë politikanët të dështuar. Le të reflektojmë, sepse: të gjithë bijtë e Ademit janë mëkatarë, por më të mirë prej tyre janë ata që pendohen!

(Zvicër, tetor 2022)

DISA NGA DOBITË E DËRGIMIT TË SALAVATEVE

“Është e vërtetë se Allahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni, pra, atë (duke sjellë salavate) dhe përshëndeteni me selam.” (Ahzab: 56)

Nga Imer Jusufi

Vëllezër dhe motra në Islam! Në këtë ligjëratë do të flasim mbi vlerën e salavatit ndaj Muhamedit (a. s.).

Zbatimi i urdhrit të Allahut për dërgim të salavateve:

“Është e vërtetë se Allahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni, pra, atë (duke sjellë salavate) dhe përshëndeteni me selam.” (Ahzab: 56)

1.Përfitimi i dhjetë salavateve nga Allahu (xh. sh.). Thotë Pejgamberi (a. s.):

“Kush më dërgon një salavat, Allahu atij i dërgon dhjetë salavate.” (Buhariu)

2.Kthimi i salavatit prej Pejgamberit (a. s.):

“Nuk ka asnjë mysliman që më përshëndet me selam e që Allahu të mos ma kthejë shpirtin për t’ia kthyer selamin.” (Imam Ahmed, Ebu Davud)

3.Afërsia me Pejgamberin (a. s.):

“Përparësi në shefa’atin tim në Ditën e Kiametit do të kenë ata që më tepër bien salavate ndaj meje.” (Transmeton Termidhiu)

4.Kushtëzohet pranimi i lutjes pas salavatit:

Transmeton Aliu (r. a.) se Pejgamberi (a. s.) ka thënë: “Nuk ka asnjë lutje që në mes saj e Qiellit nuk ka hixhab (pengesë), përderisa nuk dërgohet salavat mbi mua dhe vetëm pasi të dërgohet salavati ngrihet ajo pengesë.” (Tirmidhiu)

5.Melaqet luten për ata që dërgojnë salavat. Muhamedi (a. s.) ka thënë:

“Allahu ka krijuar një grup melaqesh të cilat i urdhëron të kërkojnë vendtubime aty ku përmendet Allahu. Nëse gjejnë vende të tilla, ndalen pranë tyre, ku bëjnë amin në lutjet e besimtarëve të pranishëm; nëse ata dërgojnë salavat, melaqet së bashku me ta dërgojnë salavat; derisa besimtarët të shpërndahen, pastaj melaqet i thonë njëra-tjetrës: ‘lum për këta që po kthehen të falur prej Allahut’.”

6.Të fituarit e shefa’atit (ndërmjetësimit) të Muhamedit (a. s.):

“Kur të dëgjoni myezinin, përsëritini ato që i thotë ai gjatë ezanit; pastaj dërgoni salavat tek unë, pastaj prej Allahut kërkon vesilen për mua, pozitë që i jepet vetëm robit të Allahut, shpresoj jam unë; prandaj, kush kërkon vesilen për mua, më është lejuar t’i bëjë shefa’at atij.”

7.Përkujtimi për Pejgamberin (a. s.):

“Prej ditëve më të mira tuajat është dita e xhuma, në të cilën ditë u krijua Ademi (a. s.); në atë ditë edhe vdiq; atë ditë fryhet në sur dhe atë ditë ngjan kiameti, prandaj dërgoni shumë salavate atë ditë; sepse, vërtet salavatet tuaja arrijnë tek unë.” Sahabët e pyetën: “O i Dërguar, si të vijnë salavatet atëherë kur nuk do të jesh më?” Pejgamberi (a. s.) u pergjigj: “Allahu ia ka ndaluar Tokës t’i gëlltit trupat e pejgamberëve.”

(Ebu Davud, Ibni Maxhe, Nesaiu, Ahmedi)

8.Dërgimi i salavateve gjatë hyrjes në xhami:

Transmeton Ebu Hurejra (r. a.) se Pejgamberi (a. s.) ka thënë: “Kur dikush të hyjë në xhami, le të më përshendet me selam dhe le të thotë: ‘O Allah, më hap dyert e mëshirës Sate’.” (Ibni Hibbani)

9.Shpëtimi nga vështirësitë:

Nga Sehl ibn Sad transmetohet të ketë thënë: “Erdhi një njeri te Pejgamberi (a. s.), duke iu ankuar për problemet e shumta jetësore - varfëria e madhe dhe vështirësitë e ndryshme. Atëherë Muhamedi (a. s.) i tha: ‘Kur të hysh në shtëpinë tënde, jep selam – qoftë të jetë aty dikush ose jo; pastaj më dërgo salavat mua dhe lexo **Kul Huvallahu Ehad.**’ Ky njeri filloi të vepronte në këtë mënyrë, derisa gradualisht filloi t’i përmirësohet gjendja. Zoti ia shtoi pasurinë aq shumë, sa që ai u shpërndante të afërmeve dhe fqinjëve të tij.”

10.Në vend të dhënies së sadakasë:

Nga Ebi Seid (r. a.) transmetohet se Muhamedi (a. s.) ka thënë: “Kur dikush nuk ka mundësi të japë sadaka, në lutjen e tij le të thotë: **‘Allahumme Sali ala Muhammedin abdike ve Resulike ve Sali alel Muminine vel Muminat vel Muslimine vel Muslimat.’** (O Allah, derdhi bekimet mbi robin dhe të dërguarin Tënd – Muhamedin (a. s.) dhe mbi besimtarët dhe të nënshtruarit Tu).”

11.Përfitimi i mëshirës hyjnore:

Nga Umer ibni Hattabi transmetohet se Muhamedi (a. s.) ka thënë: “Kushdo që ka marrë avdes, le të thotë më pas: **‘Eshhedu en la ilahe il-Allah ve enne Muhameden abduhu ve Resuluhu.’** Pastaj le të më dërgojë salavat, sepse këtij besimtari do t’i hapen tetë dyert e xhenetit dhe do të hyjë nga të dojë.”

12.Të paraqiturit e salavatit te Pejgamberi (a. s.):

Nga Ebu Hurejra, Muhamedi (a. s.) ka thënë: “Kush më dërgon salavate pranë varrit tim, e dëgjoj atë; ndërsa kush më dërgon salavat nga larg, unë e di atë.”

13.Salavati mundëson të parit e Resultit (a. s.):

Imam Eshsharaniu thotë se Muhamedi (a. s.) ka thënë: “Ai që thotë këtë salavat, do të më shohë në ëndërr; dhe, kush më sheh në ëndërr, do të më shohë në Ahiret, ku do të pijë nga uji i Keuthe-rit dhe nuk do ta djegë zjarri.” Ky salavat ka këtë përmbajtje: **“Allahume Sal-li ala ruhi Muhamedin fil ervah ve sali ve selim ala xhesedihi fil exhsad ve sali ve selim ala kabrihi fil kubur ve sali ve selim ala ismihi fil-Esmai alihi ve sabihi exhmein.”**

Dhe, në fund, i bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që të na bashkojë në xhenetet e Tij bashkë me Muhamedin (a. s.). Amin. (F. 15.10.2022/në bashkëpunim)

(Autori është Imam i Xhamisë Sulltan Pajazit në Kërçovë. Është nga Radusha, Shkup)

TIRANA SOT

Tirana. Gati-gati, asnjëherë s'më ka tërhequr. Sot, gati-gati, e mendoj ndryshe. Gjithsesi, ajo ngelet metropol. Metropoli i vendit tim.

Metropol evropian? Jo që jo! Metroplet evropiane kanë tjetër sharm, tjetër erë, tjetër zhvillim e tjetër prekje. Metroplet evropiane kanë gjurmë tradite e dritë aveniri.

Metropol lindor? Patjetër që jo! E, sërish, jo! Metroplet lindore kanë tjetër nur. Kanë zhvillim e gjurmë shekujsh, ndryshe. Kanë kulturë e dinamikë të papërshkruar. Kanë...

Tirana është metropol. Ndoshta unik në llojin e vet. Ndoshta..., apo..., kushedi. Metropoli i vendit tim përherë në tranzicion..! /F.20.10.2022/

(Imam Muhamed Bardhyl Sytari, Myftinia Shkodër/në bashkëpunim)



NJË JETË E RE PËR REVISTËN E VJETËR

Nga Agron Vojnika

Aftësia për t'u përshtatur kohës dhe sfidave të ndryshme që vijnë si rezultat i përparimit të teknologjisë, është kritike për suksesin e ardhshëm të çdo shoqërie, organizate apo bashkësie fetare. Sukseset gjithmonë varen nga përqendrimi i strategjive që i jep udhëheqësi dhe motivimi, dëshira e vullneti i punëtorëve që t'i zbatojnë ato strategji, me qëllim që të arrihet sukcesi apo ruajtja e avantazhit dhe aftësimi për të përqaftuar e jo rezistuar ndryshimin.

Para 35 viteve, një grup dijetarësh largpamës të Bashkësisë Fetare Islame vendosën që t'i ofrojnë lexuesit - besimtarit revistën "Hëna e Re", edhe atë në tri gjuhë: shqip, maqedonisht dhe turqisht.

Imagjinoni, në një kohë kur nuk kishte as kompjuter, as telefon celular, as aparate digjitale, pra asgjë e kësaj kategorie. Një karrige, një tavolinë dhe një makinë shtypi e prodhuar në uzinat e ish-Jugosllavisë. Por, në atë kohë ekzistonte dëshira dhe vullneti që besimtari të informohej sa më mirë që ishte e mundur e që lejonte koha. Ky motivim vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Tjetra është histori e njohur, për të cilën më së miri u fol në konferencën shkencore "Hëna e Re, një jetë mes sfidave dhe suksesit".

Në shekullin e njëzetentë një bashkësi fetare adaptive zakonisht mundësohet nga teknologjia digjitale, duke nxitur ndjekësit e saj që të përqaftojnë transformimin digjital, me qëllim të komunikimit sa më të lehtë, të shpejtë dhe të sigurt.

BFI në këtë drejtim gjithmonë ka qenë në hap me kohën, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me besimtarët nëpërmjet faqeve të saj në ueb apo në rrjetet sociale, e posaçërisht nëpërmjet revistës "Hëna e Re".

Në ditët e sotme, kur evoluimi i teknologjisë po zhvillohet me hapa gjigant,



sukcesi gjithmonë varet edhe nga planifikimi përtej teknologjisë dhe qëllimit të qartë, si dhe aftësisë për t'u përshtatur kohës dhe sfidave të ndryshme. Shumë revista e mjete informimi të shtypit nuk ia dolën t'u mbijetojnë këtyre sfidave.

"HËNA E RE" VAZHDON RRËFIMIN E SUKSESIT

Revista "Hëna e Re" është një revistë informative, kulturore, islame, e cila botohet në suaza të BFI. Ajo filloi të shohë dritën e botimit për herë të parë më 1987, edhe atë në tri gjuhë: shqip, maqedonisht dhe turqisht. Me këtë organ të saj informativ, e plotësoi edhe një zbrastër të aspektin e informimit të mirëfillt të pjesëtarëve të saj lidhur me aktivitetet e saj të nduarnduarta në jetën fetare.

Revista "Hëna e Re" i prezantohet lexuesit mysliman, por edhe publikut të interesuar, si e para revistë e specializuar fetare që fokusohet tek arritjet, por edhe te problemet e zhvillimit të jetës fetare islame në Maqedoni, duke përshtetur temën të ndryshme islame, si ato historike, ekonomike, morale, kulturore dhe fetare.

Revista "Hëna e Re" ka për qëllim të manifestojë në shoqëri vlerat edukative,

etiko-morale, tradicionale dhe mbi të gjitha fetare. Të gjitha këto vlera mundohen të gërshetohen me të gjitha fushat e jetës bashkëkohore, duke u munduar që të paraqitet feja islame jo si dogmë fetare, por si sistem jetësor. Revista "Hëna e Re" tani më është shndërruar në një organ vital të Bashkësisë Fetare Islame, që botohet nën drejtimin dhe kujdesin e këtij institucioni.

Vazhdimi i botimit të një reviste si "Hëna e Re", pa sponsorë financiarë të ndryshëm, në një kohë kur mediat e shtypura po shuhën, është një krenari e veçantë për Bashkësinë Fetare Islame, sepse të vetmit mbështetës dhe garantues të jetëgjatësisë së saj janë besimtarët, studentët e nxënësit, të cilët janë lexuesit më besnikë të saj.

SUKSESI MERITOHET

Më lart thamë që sukseset gjithmonë varen edhe nga serioziteti dhe përqendrimi i strategjive që i jep udhëheqësi, në këtë rast Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Pas shumë konsultimeve dhe analizave, e me mbështetjen e njeriut të parë në BFI, të Reis'ul-Ulemasë, u ven-

dos që revista "Hëna e Re" dhe i tërë arkivi e saj të arkivohet në formë digjitale, me qëllim që lexuesit të kenë mundësi dhe qasje që në numrin e parë të kësaj reviste e deri në numrin e fundit të botuar përgjatë këtyre 35 viteve.

Në fund, është me shumë vlerë për ne që të theksojmë se sukcesi dhe e ardhmja e kësaj reviste varen nga dobia e saj për publikun e interesuar. Ne e shohim marrëdhënien me lexuesin si një komunikim të vazhdueshëm bashkëbisedues. Nëse lexuesit e respektuar do të gjejnë te "Hëna e Re" një mundësi efikase konsultimi për vlerësimin e njeriut, atëherë mund të themi se qëllimi i digjitalizimit të revistës është arritur.

DIGJITALIZIMI – MËNYRA MË E SIGURT PËR RUAJTJEN E REVISTËS "HËNA E RE"

Digjitalizimi i revistës "Hëna e Re" nuk është një proces i thjeshtë, i shpejtë dhe i lehtë. Të frymëzuar nga mbështetja e parezervë e Kryetarit të BFI dhe nga ideja se me këtë po i jepet jetë një pune të palodhshme 35-vjeçare, të gjitha stafet redaktuese të kësaj reviste, motivimi dhe dedikimi i stafit që merret me këtë punë, pra digjitalizimin e revistës "Hëna e Re", është maksimal.

Nuk mund të flitet për digjitalizimin e revistës "Hëna e Re" pa u përmendur edhe puna e palodhshme e kolegëve tanë që e mundësuan një gjë të tillë si: z. Driton Dikena, z. Erxhan Xhaferi, z. Halil Berisha, hafëzi i mirënjohur i trevave tona hfz. Evzal Sinani dhe z. Agron Vojnika, si përgjegjës i procesit.

Mijëra faqe të revistës fillimisht u skanuan. Më pas u radhitën sipas numrit të faqes, duke përdorur programe të ndryshme siç janë PDF, JPG, TXT etj. dhe të gjitha këto u bashkuan, duke krijuar një numër të Revistës. Në këtë formë digjitalizohet numri 1 i revistës, e pastaj në të njëjtën mënyrë vjen numri dy, tre e me radhë, deri në numrin 371.

Ne mund t'i konvertojmë të gjitha këto faqe dhe shumë më tepër në një gamë të gjerë të formateve digjitale si: .TXT, .HTML, .XML, .PDF, .DOC, .XLS, .DOCX, .XLSX, .GIF, .JPEG, .TIFF etj. - të gjitha sipas nevojës dhe përdorimit.

Në këtë formë, vazhdoi ndërtimi i një strategjie gjithëpërfshirëse, që varet nga

caku i dëshiruar dhe ndërthurja e imperativit në tërë projektin e digjitalizimit të integruar me teknologjinë dhe fuqinë punëtore. Kur qëllimi është i qartë, edhe puna është më e lehtë.

Qëllimi dhe strategjia drejt së cilës synoi BFI - ruajtja e revistës "Hëna e Re" dhe qasja në të nga të katër anët e botës

Në të kaluarën, letra jo gjithmonë është treguar si material i përjetshëm. Ajo vjetrohesh dhe shkatërrohet lehtësisht. Prandaj, informacionet e rëndësishme të përfshira në revistat e letrës mund të humbasin lehtësisht. Përveç kësaj, gjatë ruajtjes, revistat e letrës marrin hapësirë të konsiderueshme dhe krijojnë shumë probleme të tjera. Arkivimi i tyre kërkon hapësirë të madhe dhe mirëmbajtje ekstreme, duke i ruajtur ato nga lagështia, nga insektet dhe brejtësit, e deri



tek zjarri.

Qasja në informatat që janë në brendi të tyre është e kufizuar fizikisht, sepse shkencëtarët e ardhshëm duhet që të jenë të pranishëm në zyrat e arkivit në një orar të caktuar kohor, për të pasur qasje në këto revista.

Me dhjetëra punime shkencore, tema magjistrature dhe doktorature kanë pasur burim informacioni revistën "Hëna e Re". Të gjithë e kanë pasur të detyrueshme që të jenë personalisht dhe në një kohë të caktuar që t'i shfletojnë revistat një nga një, duke kryer një punë të vë-

shtirë dhe me shumë mund.

Tani, me digjitalizimin e kësaj reviste, të gjithë të interesuarit do të kenë qasje në këtë revistë, kudo qofshin ata, në të katër anët e globit dhe do ta kenë në pëllëmbë të dorës revistën "Hëna e Re", që nga numri i parë deri në numrin e fundit - mjafton të kenë qasje në internet dhe të lundrojnë tek faqja oficiale e Bashkësisë Fetare Islame BFI.MK

RËNDËSIA E DIGJITALIZIMIT

Qasja në revistë, në çdo kohë, nga të katër anët e botës, ruajtja e materialeve dhe shpërndarja e tyre te lexuesi, është qëllimi kryesor i digjitalizimit. Digjitalizimi i arkivave është procesi i skanimit dhe më pas katalogimit dhe indeksimit të të gjithë numrave të revistës në një platformë apo në një e më shumë servere digjitale.

QASJA E SHPEJTË NË INFORMACIONE

Përpunimi digjital i informacioneve, në rastin konkret i faqeve dhe artikujve, mundëson qasje më të shpejtë apo qasje direkte të përdoruesve të të njëjtat. Kërkimi nëpër arkiva të ndryshme për orë të tëra dhe mosgjetja e një numri të dëshiruar apo faqe e shkrimi të kërkuar, shpeshherë krijojnë shqetësim dhe kokëdhembje, sepse fare lehtë revista që kërkojmë mund të jetë në një dosje tjetër. Digjitalizimi i Revistës siguron qasje të menjëhershme të çdo informacioni. Vetëm digjitalizimi paraprak arkivues, do të ndihmojë në gjetjen e shpejtë të revistës së kërkuar, apo të një numri të saj apo të ndonjë artikulli që është me interes.

SIGURIMI DHE RUAJTJA E REVISTAVE NË FORMËN ORIGJINALE

Është shumë e lehtë për t'u dëmtuar dhe humbur revistat nëse ato nuk vendosen siç duhet gjatë arkivimit. Digjitalizimi i tyre eliminon plotësisht dëmtimin e tyre, ndërsa procesi i katalogizimit të përshtatshëm digjital ju lejon që të kërkoni shpejt nëpër to. Është mjaft e lehtë për të përmirësuar efikasitetin e punës sot duke pasur një strategji dhe një plan paraprak që do të lehtësojë qasjen në revistat e dëshiruara.

REZULTATET E DIGJITALIZIMIT TË REVISTËS

Në digjitalizimin e revistës "Hëna e Re" jemi kujdesur që të gjitha numrat e

saj të ruajnë formën dhe origjinalitetin e tyre. Kur një numër i revistës është digjitalizuar, ato renditen sipas numrit rendor të botimit, të datës së botimit dhe sistemohe në server me një softuer të përshtatshëm në bazë të parametrave të caktuar. Në rastin konkret, BFI është përcaktuar që revistat e digjitalizuara t'i sistemojë me formatin PDF, sepse softueri i tillë është i instaluar pothuajse në të gjithë kompjuterët anembanë globit, ose po ashtu është shumë i lehtë për t'u shkarkuar nga interneti dhe për t'u instaluar në cilindo sistem operativ.

Me një prani të gjatë në kohën e digjitalizimit, ne kemi fituar aftësi dhe eksperiencë në shndërrimin e revistës, që do të jetë një fillim edhe për digjitalizimin e arkivit dhe të tërë dokumentacionit në BFI.

PESË IMPERATIVË PËR TË NXITUR TRANSFORMIMIN DIGJITAL

Në bazë të eksperiencave dhe praktikave botërore për sa i përket digjitalizimit, shkencëtarët më në zë të botës së kibernetikës kanë identifikuar pesë imperativë në rezultatin e të cilave ndikon teknologjia dhe mundëson që të ndihmojnë në ndërtimin e gjuhës së përbashkët. Duke menduar në mënyrë tematike për këta pesë imperativa digjitalë - përvojën, njohuritë, platformat, lidhjen dhe integritetin - organizatat mund të komunikojnë ndërmjet funksioneve në një mënyrë që e vendos strategjinë

përpara teknologjisë dhe mund të çojë në iniciativa që ofrojnë një bërthamë teknologjike më modulare dhe fleksibël, që ofron transformim më të mirë dhe vlera strategjike. Në thelb, ato krijojnë një urë për komunikime të koordinuara midis strategjeve të punës dhe teknologjisë dhe drejtuesve të fuqisë punëtore dhe operacioneve.

SHPJEGIMI NË MË SHUMË DETAJE:

1. Përvojat: Përqendrimi në optimizimin e ndërveprimeve me përdoruesit. Marrja e praktikave të mëhershme si shembull, janë një lehtësues i vërtetë i punës së digjitalizimit.

2. Vështirime: Vlerësoni cilat të dhëna, analiza, modeli operativ dhe fuqia punëtore kërkohen për të mundësuar strategjitë organizative. Formatin PDF për momentin dhe për një kohë shumë të gjatë premtan se do të jetë një softuer gjithëpërfshirës dhe aktiv në mundësimin e qasjes në materialet e arkivuara.

3. Platformat: Fokusimi në vendndodhjen dhe menaxhimin e informacionit për një bashkësi fetare ose rrjetin e saj janë të një rëndësie të madhe. Po ashtu edhe shqyrtimi dhe mundësimi i opsioneve të tjera, siç janë serverë të ndryshëm apo rrjete sociale me kapacitet arkivues, për ruajtjen e materialeve dhe qasjen më të lehtë në burimin e informacioneve.

4. Lidhshmëria: Përfshin rrjedhën e informacionit ndërmjet platformave, përvojave dhe njohurive, duke përfshirë të ardhmen e internetit dhe rrjetëzimin me organizata të tjera.

5. Integriteti: Fokusimi në përmirësimin e qëndrueshmërisë, sigurisë, teknologjisë etike dhe besimit në të gjitha sistemet dhe proceset e punës, duhet të jetë prioritet i bashkësive apo organizatave të ndryshme. Ecja e teknologjisë me hapa të shpejtë, krijimi i softuerëve të punës dhe shpikja çdo ditë e "veglave të punës", na detyron të mendojmë se në të ardhmen do të ketë më shumë se një teknologji për t'u marrë parasysh për çdo imperativ. Mendimi për imperativat si kategori, ose "rafte aftësish", mund të jetë i dobishëm. Temat lejojnë që kategoritë e ndryshme të rregullohen ndërsa teknologjia ndryshon. Në këtë mënyrë, mund të marrim në konsideratë teknologjitë e sotme aftësuese siç janë: (ueb, cloud, IoT, blockchain, AI, siguria kibernetike, celulari 5G, realiteti digjital, llogaritja e skajshme kuantike dhe të tjera), të cilat duhet t'i shikojmë si strategji që mund të përdoren apo të hyjnë në fuqi në të ardhmen.

(Kumtesë e paraqitur në konferencën shkencore "Hëna e Re", 35 vjet jetë mes sfidave dhe suksesit", organizuar më 28 dhe 29 shtator, 2022, në Medresenë Isa Beu në Shkup. Autori është Përgjegjës i Shërbimit për Informim në BFI të RMV.)

NJË DELEGACION NGA İHH NË BFI

Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 21 tetor, 2022, priti një delegacion nga organizata e mirënjohur e Turqisë İHH (İnsani Yardım Vakfı), përkatësisht Humanitarian Relief Foundation, udhëhequr nga z. Yusuf Bilgin, anëtar i Këshillit të Lartë; z.

Ismail Osmani, anëtar i Bordit; dhe Mariglen Shehi, Koordinator për Evropë dhe SHBA, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë takim Reis'ul-Ulemanë e shoqëruan dr. Qenan ef. Ismaili, Myfti i Myftinisë së Shkupit; h. Ismet Ademi dhe dr. Abdulkerim Iseni.

Nga mysafirët, Kreu i BFI u njoftua për shumë aktivitete në sferën e arsimit, të humanitetit dhe të diplomacisë, të cilat i bën kjo organizatë. Po ashtu, u bisedua edhe për bashkëpunim të mundshëm në linjën institucionale në sfera



të ndryshme.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulemaja i informoi shkurtimisht për aktivitetin e madh që ka bërë BFI e RMV në momentet më të vështira në Balkan dhe më gjerë, në veçanti gjatë krizës boshnjake dhe kosovare, andaj edhe në këtë kohë bëhen përpjekje në të gjitha sferat për

një angazhim të bujshëm.

Në fund, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i falënderoi mysafirët për vizitën dhe për përpjekjet për të vendosur një bashkëpunim të sinqertë për të mirën e humanizmit në përgjithësi, thuhet në njoftimin e BFI.

TUBIMI DHE SHUMËZIMI I KURANIT

Historia nuk shënon të jetë mësuar ndonjë libër tjetër përmendsh sikurse që është mësuar Kurani. Një ruajtje të tillë të Kuranit ua mundësoi besimtarëve Allahu (xh. sh.), i cili thotë: "Ne vetë e kemi bërë të lehtë Kurandin për nxënien (dhe kuptim), prandaj, a ka kush që do ta mësojë."

Shkruan: Muzemil Osmani

Kurani, që është fjalë e Allahut (xh. sh.), zbriti në intervale të caktuara kohore, suksesivisht brenda periudhës 23-vjeçare, duke filluar në Mekë (610-622) dhe në Medinë (622-632) - qytete këto të cilat, falë punës së madhe dhe reformave të Muhamedit (a. s.), u bënë të njohura jo vetëm në Arabi, por edhe në mbarë rruzullin tokësor.

Kurani si libër i fundit që zbriti në rruzullin tokësor u shkrua në momentin e shpalljes, gjë e cila nuk ka ndodhur me librat tjerë të mëparshëm. Kurani ishte i tubuar edhe në kohën e Muhamedit (a. s.), por nuk ishte i tubuar siç e kemi ne sot. Në këtë formë të cilën e kemi ne sot është tubuar për herë të parë në kohën e Ebu Bekrit (r. a.) dhe, duke vazhduar më vonë, me disa kopje të tjera, në kohën e Othmanit (r. a.).

Për ruajtjen e Kuranit ka garantuar vetë Allahu (xh. sh.), i cili thotë: "Vërtet, ne e zbritëm Kurandin dhe ne do ta ruajme atë." (surja Hixhër: 9)

E lus Allahun (xh. sh.) që ky punim të jetë në dobi të të gjithë atyre që do ta lexojnë.

TUBIMI NË KOHËN E MUHAMEDIT (A. S.)

Kurani si libër i fundit i është zbritur Muhamedit (a. s.) në mënyrë graduale, kohë pas kohe. Zbriste ajeti për të cilin Muhamedit (a. s.) kishte nevojë. Kështu, zbriti në një periudhë prej 23 vjetësh, pjesë-pjesë dhe jo i tërë, përnjëherë,



ndërsa tubimi i Kuranit u bë sa ishte gjallë Muhamedi (a. s.). Tubimi dhe ruajtja e Kuranit gjatë jetës së Muhamedit (a. s.) bëhej në dy mënyra: nxënies së Kuranit dhe ruajtjes së tij përmendsh.

Siç e dimë, Kurani i zbriti Muhamedit (a. s.) që ishte analfabet dhe në gjuhën e një populli që ishte i pashkolluar, prandaj kujdesi më i madh i Muhamedit (a. s.) ishte që myslimanët ta mësojnë Kurandin përmendsh. Njëkohësisht, ai ua mësonte dhe i nxiste sahabët që ta mësonin Kurandin përmendsh.

Këtë më së miri na e tregon vetë Kurani famëlartë: "Ai (Allahu) është Ai që e ka dërguar tek analfabetët Pejgamberin nga mesi i tyre, i cili u citon ajetet e tij, i pastron ata dhe ua mëson librin (Kurandin) dhe urtësitë, edhe pse më parë, ata qartazi ishin në humbje."

Nga ky ajet shihet qartë se Muhamedi (a. s.) dhe sahabët e tij ekskluzivisht i kushtohen nxënies së Kuranit përmendsh, ngase kjo ishte e vetmja mënyrë për të ruajtur Kurandin, sepse shumica e njerëzve ishin analfabetë.

Karakteristikë e hershme e arabëve ishte nxënia përmendsh e mësimëve. Edhe para Islamit ata njiheshin për aftësitë e tyre që të mësonin përmendsh: dihet se para Islamit arabët mësonin përmendsh mijëra vargje të poezisë dhe poezitë më të mira i varnin në muret e

Qabesë.

Këtë aftësi mendore arabët do ta shfrytëzojnë për nxënien e Kuranit përmendsh, për shkak se Kurani është libër hynor, i përkryer - si nga përmbajtja, ashtu edhe nga ndërtimi artistik, stilistik dhe është i paartitshëm në çdo aspekt. Arabët do ta shfrytëzojnë tërë potencialin e tyre për ta nxënë përmendsh Kurandin.

Sujutiu në *El-Itkan* përmend se në fillim zbritën suret e shkurtra dhe fëmijët myslimanë i kishin mësuar të gjitha suret e shkurtra të Kuranit.

Angazhimi i sahabëve në nxënien e Kuranit përmendsh ishte bërë pjesë e jetës së tyre, kudo që të ishin. Transmetohet se Muhamedi (a. s.) i dallonte shtëpitë e sahabëve natën, në bazë të zërave që dëgjonte kur ata lexonin Kurandin në familjet e tyre, edhe pse më parë nuk i kishte ditur shtëpitë e tyre.

Në Xhaminë e Muhamedit (a. s.) dëgjohej zhurmë e madhe nga leximi i Kuranit, saqë Pejgamberi (a. s.) kërkonte nga sahabët që të ulnin zërin e tyre, që mos të pengonin njëri-tjetrin derisa e mësonin Kurandin.

Kështu vilej dhe ruhej Kurani në shpirtin e pastër të sahabëve, në mënyrë shumë të sigurt. Edhe sot e kësaj dite kjo traditë e nxënies së Kuranit vazhdon, kështu që në botë kemi me mijëra hafëza të

Kuranit. Historia nuk shënon të jetë mësuar ndonjë libër tjetër përmendsh sikurse që është mësuar Kurani. Një ruajtje të tillë të Kuranit ua mundësoi besimtarëve Allahu (xh. sh.), i cili thotë: **“Ne vetë e kemi bërë të lehtë Kuranin për nxënie (dhe kuptim), prandaj, a ka kush që do ta mësojë.”**

KURANI VILEJ DHE RUHEJ EDHE DUKE E SHKRUAR

Edhe pse Kurani i zbriti Pejgamberit analfabet dhe te një popull i cili me shumicë ishte analfabet, por Muhamedi (a. s.) nuk e la pa e shkruar Kuranin – i obligoi shokët e vet që dinin shkrimin (e numri i atyre ishte shumë i vogël), caktoi disa njerëz të cilët do të merreshin vetëm me shkrimin e Kuranit dhe këta do të quhen “Shkrues të Kuranit”.

Ndër shkruarit më të njohur të Kuranit janë Katër Hulefai-Rashidinët: Ebu Sufjani, Talha bin Abdil-lahi, Abdullah bin Revaha, Ubejd bin Ka’bi, pastaj Aisha (r. a.), Zejd bin Thabit dhe Alij bin Ebi Talibi. Këta janë disa prej sahabëve më të dalluar.

Kurani gjatë kohës së Muhamedit (a. s.) u shkrua nëpër mjete të ndryshme, siç janë: *lëkurë, eshtë, pllakë druri, fletë papirusi* etj. Gjatë kohës së Muhamedit (a. s.) thuajse i tërë Kurani ishte i shkruar, por nuk ishte i tubuar në një vend, MUS’HAF.

Ndokush ka të drejtë të pyesë se pse nuk është tubuar Kurani në kohën e Muhamedit (a. s.), sikurse e tuboi Ebu Bekri apo Othmani – Allahu qoftë i kënaqur me ta. Dijetarët kanë përmendur shumë shkaqe, por ne do t’i përmendim vetëm disa prej tyre:

- Nuk u paraqit nevoja e tubimit të Kuranit aq shumë, siç u paraqit në kohën e Ebu Bekrit e të Othmanit – Allahu qoftë i kënaqur me ta.

- Në kohën e Muhamedit (a. s.) Kurani ishte në zbritje e sipër, dhe mundësia ishte që disa ajete që zbritnin t’i anulonin disa të tjera.

- Kurani nuk kishte zbritur përmjherë në tërësi, por ishte në zbritje pjesë-pjesë, kohë pas kohe. Po të ishte përmbledhur në tërësi në një vend, atëherë do të ishin të detyruar që t’i ndryshojnë të gjitha shkrimet e Kuranit sa herë që zbrisnin ajete apo sure të tjera.

Kështu është ruajtur dhe është mësuar Kurani gjatë kohës së Muhamedit (a. s.), duke u zbatuar fjala e Allahu (xh. sh.) që thotë: **“Vërtet, ne e kemi zbritur përkujtuesin (Kuranin) dhe ne do ta ruajmë atë.”**

MUHAMEDI (A. S.) NË MODELIN E NJË GJYSHI

Dashuria dhe përkujdesja që ai ka pasur për nipat dhe për mbesat është një shembull për të gjithë njerëzimin.

Shkruan: Besim Barbullushi (Enkas për HeR)

Hadithet e Muhamedit (a. s.) dhe, përgjithësisht, burimet nga historia islame, na bëjnë me dije se i dërguari i Allahut (xh. sh.) ashtu siç ka qenë i mëshirshëm, i dashur dhe i butë me fëmijët e vet, njësoj ka qenë edhe me nipat dhe me mbesat që ka pasur. Edhe pse një gjysh, ai nuk u lodh kurrë në përkujdesjen dhe edukimin e tyre.

Nipi dhe mbesa e parë e Pejgamberit (a. s.) janë Aliu dhe Umame nga vajza e madhe, Zejnebi, me bashkëshort Ebu’l-Ass-in (r. a.). Sipas burimeve të historisë islame, Aliu ka ndërruar jetë që në moshë të vogël, ndërsa Umame do të bëhej në të ardhmen bashkëshortja e Hz. Aliut (r. a.).ⁱ

Brezi, gjenerata e pejgamberit Muhamed (a. s.) dhe vazhdimësia e familjes - duke parë që fëmijët e tjerë kanë ndërruar jetë të gjithë në moshë të vogël - është vetëm nga vajza Fatimja (r. a.) me bashkëshort Hz. Alinë (r. a.). Kjo vazhdimësi erdhi nga Hasani dhe Hyseni (r. a.). Gjenerata e ardhur nga familja e Hz. Hasanit (r. a.) u quajt *“sherif”*, ndërsa gjenerata e ardhur nga Hz. Hysejni (r. a.) u quajt *“sejjid”*.

INTERESIMI, QË NGA LINDJA

Nëse e shohim mënyrën se si është sjellë me nipat dhe me mbesat i dërguari i Allahut, si e ka kaluar kohën me ta, çfarë metodash ka përdorur ai për edukimin e tyre, do të gjejmë një numër të madh burimesh në hadithe të ndryshme të transmetuara. Dashuria dhe përkujdesja që ai ka pasur për ta është një shembull për të gjithë njerëzimin. Kjo përkujdesje dhe ky interesim e të dërgua-

rit ndaj nipave dhe mbesave fillonte që në momentin që ato vinin në këtë dynja. Që në momentin e lindjes ai u lexonte ezanin në të dy veshët dhe bënte kurban *“akika”* për ta.ⁱⁱ Emrat i zgjidhte me kujdes dhe me kuptim të bukur. Nëse kishte ndonjë fëmijë të cilëve në periudhën e xhahilijetit (injurancës) iu ishte vënë ndonjë emër me kuptim jo të përshtatshëm, i dërguari i Allahut atë ia ndërronte.ⁱⁱⁱ

Sa herë që takohej me nipërit Hasanin dhe Hysenin, iu ledhatonte kokën dhe i përqafohte. Ndërsa mbesën Umame e ka mbajtur përherë në supe. Kur falte namazin, ajo ishte mbi supin e Pejgamberit (a. s.) - kur ulej në sexhde, e vinte në tokë dhe kur ngruhej, e vinte përsëri në supe. Gjithashtu, kur ai falte namazin, nipat i hipnin në supe, në shpinë dhe kur ulej ai në sexhde dhe kur ngruhej në kijam, bënte shumë kujdes dhe lëvizte mengadalë, në mënyrë që fëmijët mos të vriteshin. Kur përfundonte namazi, Pejgamberi (a. s.) i merrte dhe i ulte tek gjunjtë e tij.^{iv} Kur i dërguari i Allahut ulej në sexhde dhe nipat i hipnin mbi supe, ai e zgjaste sexhden deri në momentin që ata uleshin.^v Kur i dërguari i Allahut ishte në kijam gjatë namazit, nipat u mundonin të kalonin mes këmbëve të tij dhe ai i lejonte. Ai nuk ishte kurrë kundër që fëmijët të mos luanin. Këtë gjë e shohim edhe gjatë namazit, me ç’rast Pejgamberi (a. s.) nuk është zemëruar kurrë me ta.^{vi}

Transmetohet se një ditë, kur i dërguari i Allahut (a. s.) po ndante disa hurma zeqati, pasi mbaroi punë, e mori nipin e tij Hasanin (r. a.) dhe e vuri mbi supe.^{vii} Në atë moment afër të Dërguarit (a. s.) gjendej sahabia Bera (r. a.). Ai tregon, teksa pejgamberi Muhamed (a. s.) po e vinte Hasanin në supe, tha kështu: *“O Allah, me të vërtetë unë e dua Hasa-*



nin. Duaje edhe Ti.”^{viii} Disa transmetime thonë që ata i ka hipur edhe në devenë e tij.^{ix} Dashurinë, përkujdesjen ndaj tyre ai e shfaqte në çdo vend dhe në çdo moment.

Njëri nga sahabët e nderuar transmeton: *“Një ditë Pejgamberi (a. s.) erdhi tek unë. Në njërin sup kishte Hasanin dhe në tjetrin Hysenin. Gjatë gjithë rrugës një herë përqafohte njërin, një herë tjetrin.”^x*

Një transmetim tjetër, që tregon për dashurinë dhe përkujdesin që kishte i Dërguari për nipat dhe mbesat, nga Ebu Hurejra, thotë: *“Një ditë, bashkë me Pejgamberin (a. s.) shkuam te shtëpia e Fa-*

times (r. a.) Sapo mbërritëm, ai pyeti: Ku është ai burri vogël, ku është ai burri i vogël? (e kishte fjalën për Hasanin r. a.) Kur Hasani erdhi, e përqafoi dhe më pas tha këto fjalë: “O Allah, unë e dua shumë Hasanin; të lutem Ty që Ti ta duash atë dhe të gjithë ata që e duan atë.”^{xi}

FËMIJËT DHE PASURIA JANË SPROVË

Një hadith të ngjashëm e transmeton edhe sahabiu Usame b. Zejd, ku thotë: *“Pejgamberi (a. s.) kur përqafohte Hasanin dhe Hysenin, iu drejtonte Allahut*

me lutjen ‘o Allahu im, unë i dua këta dhe shpresoj që ti duash edhe Ti’.”^{xii}

Këtë mëshirë dhe dashuri për fëmijët i dërguari i Allahut e ka treguar në çdo situatë. Një ditë, atë e thirrën në shtëpinë e një sahabi dhe gjatë rrugës ai pa Hysenin teksa po luante me fëmijët e tjerë dhe në atë moment Pejgamberi (a. s.) përkulet, hap krahët dhe e përqafoi nipin e tij.^{xiii}

Një ditë tjetër, ndërkaq, i dërguari i Allahut po mbante hytben e xhumasë dhe sheh nipat Hasanin dhe Hysenin që po ecnin drejt tij ashtu me zor, si fëmijë që ishin, herë-herë edhe duke u rrëzuar. Pejgamberi ynë i dashur zbriti nga mimeri, i mori nipat në krahë dhe tha: *“Allahu jua ka bërë shkak sprove pasurinë dhe fëmijët (pasardhësit).”^{xiv}* Pasi u ngjiti edhe një herë në mimer, tha: *“Nuk munda t’i lë ashtu, duke ecur dhe duke u rrëzuar fëmijët e mi, andaj zbrita poshtë dhe i mora ata lart.”^{xv}*

Gjithë këta shembuj tregojnë këtë lidhje të veçantë të Pejgamberit (a. s.) me nipërit e tij. Ai kishte një lidhje shumë të veçantë me Hasanin dhe me Hysenin. Transmeton Enes b. Malik (r. a.), se është pyetur Resulallahu (s.a.v.s.): *“O i dërguar i Allahut, cilin do më shumë nga Ehl-i Bejti”,* ndërsa ai është përgjigjur: *“Hasanin dhe Hysenin.”* Në një hadith tjetër Pejgamberi (a. s.) thotë: *“Hyseni është imi dhe unë jam i Hysenit. Allahu e do atë që do Hysenin.”^{xvi}*

(Autori është mësues i lëndëve fetare në medresenë “Haxhi Sheh Shamia” dhe punonjës i Myftinisë Shkodër)

ⁱ Ibn Sa’d, *et-Tabakat*, VIII, 31.

ⁱⁱ Ebu Davud, *Edeb*, 114.

ⁱⁱⁱ Ahmed b. Hanbel, *Musned*, I, 98, 118.

^{iv} Ahmed b. Hanbel, *Musned*, II, 513.

^v Ahmed b. Hanbel, *Musned*, III, 494; Nesai, *Tatbik*, 82.

^{vi} Buhari, *Fedailu’s-Sahabe*, 22, *İlim*, 18, *Salat*, 106; Tirmidhi, *Menakib*, 9, *Birr*, 57; Ebu Davud, *Terexh-xhul*, 15; Ibn Maxhe, *Edeb*, 3.

^{vii} Ahmed b. Hanbel, *Musned*, II, 279.

^{viii} Buhari, *Fedailu’l-Ashab*, 22.

^{ix} Ibnu’l-Esir, *Usdu’l-Gabe*, IV, 126.

^x Ahmed b. Hanbel, *Musned*, II, 440.

^{xi} Buhari, *Menakib*, 27; Muslim, *Fedail*, 17.

^{xii} Buhari, *Menakib*, 27; Tirmidhi, *Menakib*, 31.

^{xiii} Ibn Maxhe, *Mukaddime*, 11.

^{xiv} Kur’an Enfal, 8/28.

^{xv} Tirmidhi, *Menakib*, 31.

^{xvi} Buhari, *Fedail*, 18-22; Muslim, *Fedail*, 32, 56, 58-61, 67; Tirmidhi, *Menakib*, 31; Ibn Maxhe, *Mukaddime*, 27.

BESIMI NË PEJGAMBERËT E ALLAHUT

Besimi te pejgamberët e Allahut është njëri prej bazave të besimit islam, i mbështetur në Kuran, në sunnet dhe në mendimin e njëzëshëm të dijetarëve islamë. Për realizimin e këtij parimi të besimit, duhet besuar në mënyrë të prerë se të gjithë, nga pejgamberi Adem (a. s.) e deri te pejgamberi i fundit, Muhamedi (a. s.), u janë dërguar njerëzve nga Allahu si përfaqësues të Tij për t'u kumtuar atyre urdhrat hyjnorë.



Shkruan: Rexhep Ismaili
(Enkas për HeR)

Besimi vijues nga bazat e imanit, është edhe besimi në pejgamberët e Allahut. Në këtë bazë bën pjesë besimi në të gjithë pejgamberët, të cilët i ka emërtuar Allahu në Kuran dhe besimi se Allahu pos tyre, ka dërguar edhe pejgamberë të tjerë, numrin e të cilëve nuk e di askush, përveç Allahut.

Allahu në Kuran na tregon për dërgimin e tyre: **“Ne kemi dërguar pejgamberë para teje, për disa prej tyre të kemi**

njoftuar me rrëfimet e tyre, e për disa nuk të kemi njoftuar, e asnjë pejgamberi nuk i takoi të sjellë ndonjë argument, vetëm se me urdhrin e Allahut. E kur të vijë koha e caktuar nga Allahu, zbatohet gjykimi me drejtësi dhe aty atëherë dështojnë ata të kotët.”^{vi}

Gjithashtu, Allahu thotë: **“Secili popull kishte të dërguarin e vet; e kur u vinte i dërguari i tyre, bëhej gjykimi i drejtë mes tyre, atyre nuk u bëhet padrejtësi.”**^{vii}

Besimi te pejgamberët e Allahut është njëri prej bazave të besimit islam, i mbështetur në Kuran, në sunnet dhe në mendimin e njëzëshëm të dijetarëve islamë.

Allahu në Kuran thotë: **“I dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij, dhe thanë: “Iu përgjigëm thirrjes dhe respektuam urdhrin. Kërkojmë faljen tënde, o Zoti ynë! Vetëm te Ti është ardhmëria jonë.”**^{viii}

Për realizimin e këtij parimi të besimit, i cili zë vend në Amentu, duhet besuar në mënyrë të prerë se të gjithë, nga pejgamberi Adem (a. s.) e deri te pejgamberi i fundit, Muhamedi (a. s.), u janë dërguar njerëzve nga Allahu si përfaqësues të Tij për t'u kumtuar atyre urdhrat hyjnorë.

Këto njohuri të hollësishme mund të shqyrtohen të grupuara si: **në vetitë e pejgamberëve, në mu'xhizet dhe numrin e tyre.** Të gjitha këto do t'i shqyrtojmë në vijim në pika të shkurtra.

Feja islame e ka bërë të detyruar (farz), pas besimit në Zotin, besimin pa dallim edhe te të gjithë pejgamberët dhe librat që iu kanë zbritur atyre. Qoftë të quajtur nebi, qoftë resul - të gjithë duhet besuar. Veç kësaj, duhen besuar një për një si pejgamberë personat që u përmenden emrat në Kuran, si dhe në tërësi, se çdo fisi apo populli i është dërguar pejgamber. Allahu në Kuran thotë: **“Ju (besimtarë) thoni: ‘Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve; ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur.”**^{ix}

Sepse, në Kuran ka jo vetëm urdhra të hapur të formës **“besojuni të dërguarve”,** por edhe bëhet e ditur se ata që i mohojnë të dërguarit dhe zbulesën e sjellë prej tyre, janë në rrugë të shtrembër dhe se në këtë botë do të dënohen me turp, kurse në jetën tjetër do të hidhen në xhehenem. **“O ju që besuat, besoni vazhdimisht Allahut, të dërguarit të Tij, librit që gradualisht ia shpalli të dërguarit të Tij dhe librit që e pati zbritur më parë. Kush nuk i beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg.”**^x

Dijetarët islamë janë të një mendimi se ata që nuk u besojnë pejgamberëve janë mohues (qafirë/kafir). Në këtë çështje, mes dijetarëve nuk ka ndonjë mosmarrëveshje apo kontradiktë.

Allahu që ka bashkuar besimin në të dërguarit e Tij me besimin në Vetën e Tij, mohimin e njërit nga pejgamberët, ose mohimin e të gjithë pejgamberëve, e ka konsideruar mohim të Vetes së Tij të lartë.

Allahu thotë në Kuran: **“S'ka dyshim se ata që nuk besojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, dëshirojnë të bëjnë dallim mes Allahut dhe të dërguarve të Tij e thonë: ‘Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë’ e mes këtij duam të marrin një rrugë. Të tillët lanë jobesimtarët e vërtetë; e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët. E ata që besuan Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe nuk bënë kurrfarë dallimi në asnjë prej tyre, të tillëve do t'u jepet shpërblimi i merituar. Allahu fal shumë dhe është mëshirues.”**^{xi}

Me Muhamedin, vulën e të dërguarve, Allahu e plotësoi lartësinë e pejgamberisë dhe të vërtetën e mesazheve: **“Shembulli im dhe shembulli i pejgamberëve përpara meje, janë si shembulli i një burri i cili e ka ndërtuar një ndërtesë të bukur dhe e ka zbukuruar atë, por ka lënë pa vënë një tullë në njërin nga këndet e kësaj ndërtese; njerëzit vinin rrotull ndërtesës, çuditëshin dhe thoshin: Çudi! Përse nuk është vënë edhe kjo tullë? Ja, pra, unë jam tulla dhe unë jam vula e pejgamberëve.”**^{xii} Kushdo që vjen pas Muhamedit dhe pretendon pejgamberinë, ai është gënjeshtar; ndërkaq, kush e beson këtë gënjeshtar, është mohues.

DOMETHËNIA E TERMAVE “EN-NEBIJ” DHE “ER-RESUL”

Kuptimi leksikor i fjalës *nebi* është lajmëtar ose i lajmëruar, i bërë me dije, kurse *resul*, është përfaqësues, i ngarkuar me detyrën për të sjellë një lajm.^{xiii} Këto dy terma, edhe pse janë identikë mes vete, janë me një dallim në mes tyre. Sepse, personi i obliguar me shpallje nëse urdhërohet që t'i informojë të tjerët, ai është *nebij* dhe *resul*. E nëse ai nuk urdhërohet që t'i informojë të tjerët, ai është *nebij*.

Një grup dijetarësh është i mendimit se që dy fjalët janë sinonime dhe se ato kanë një kuptim. Pra, sipas këtyre çdo *nebij* është edhe *resul* dhe çdo *resul* është edhe *nebij*. Por, ai quhet *resul* kur shikohet nga këndvështrimi i raportit midis pejgamberit dhe njerëzve. Ndërsa quhet *nebij* kur shikohet nga këndvështrimi midis tij dhe Allahut. Megjithatë, që të dy termat janë të pandarë. I këtij mendimi është Kadi Ijadi prej malikive dhe të tjerëve.^{xiv}

Sipas mu'tezilëve, nuk ka asnjë lloj dallimi mes tyre, sepse Allahu (xh. sh.) i drejtohet Muhamedit (a. s.) edhe me: *Ja ejuher-Resul* “O ti, i dërguar”, por edhe me: *Ja ejuhen-Nebij*, “O ti, pejgamber”. Një numër i madh i dijetarëve thonë

se këta dy terma midis vetes kanë kuptim të përgjithshëm dhe të posaçëm absolut, për arsye se *nebij* është ai person të cilit diçka i është shpallur nga Allahu, pa marrë parasysh se a është i detyruar ta interpretojë e ta kumtojë atë ose jo. Por, nëse ai detyrohet t'ua kumtojë njerëzve atë sheriat apo libër që i është shpallur, atëherë ai është edhe *resul*. Mbështetur në këtë, kuptojmë se çdo *resul* është *nebij*, sepse dërgesa, interpretimi i asaj që i është shpallur, është degë e nubuvetit (pejgamberisë). Ndërkaq, çdo *nebij* nuk është *resul*, pasi që atij mund t'i vijë shpallja pa qenë i detyruar ta interpretojë dhe ta kumtojë atë.^{xv}

Allahu në Kuran thotë: **“Ne nuk dërguam para teje asnjë të dërguar (me shpallje) dhe asnjë pejgamber (të dërguar si vazhdues i shpalljes së mëparshme), e që, kur ai (i dërguari) dëshiroi diç, të mos iu pat hedhur në atë dëshirën e tij djalli, e Allahu asgjëson atë që e hedh djalli, dhe Allahu fuqizon argumentet e Veta. Allahu është shumë i dijshtëm dhe me urtësi të madhe i rregullon çështjet.”**^{xvi}

Në literaturën fetare (por, jo në Kuran), është futur edhe fjala persisht *pejgamber*, që do të thotë *lajmëtar*. Gjithashtu, edhe termi *profet*, që është me origjinë greke dhe është një lloj emërtimi nga politeistët dhe paganët, të cilët aspak nuk i kanë besuar pejgamberët.

VETITË E PEJGAMBERËVE

Me fjalën *vetitë e tyre*, kemi për qëllim atë çka përfshijnë kushtet e pejgamberisë, të cilat duhet të gjenden tek ata, siç flasin për to dhe i theksojnë shumica e dijetarëve të skolastikës (ulema el-kelam). Sepse, vetitë dhe kushtet e tjera të domosdoshme janë të njëjta dhe midis tyre nuk ka ndonjë dallim.

Kryesisht ajo që duhet të kenë pejgamberët janë:

Vetia e parë: **Pejgamberët janë njerëz**

Gjëja e parë e veçantë që duhet ditur për pejgamberët, është se ata janë njerëz. Kështu, çdo pejgamber, si dhe çdo njeri tjetër, lind, rritet, fle, ndien uri, ushqehet, martohet, bëhet me fëmijë, ndikohet nga kushtet e natyrës, do dhe s' do, gëzohet dhe hidhërohet, sëmuret dhe vdes. Allahu (xh. sh.) thotë: **“Mesihu, biri i Merjemes, nuk është tjetër veçse i dërguar; para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë (e ndershme). Që të dy ata ishin që ushqeheshin (si njerëzit tjerë). Ja si u sqarohen atyre argumentet dhe shih**

pastaj se si ia kthejnë shpinën të vërtetës!^{”xii}

Gjithashtu, Allahu thotë: “*Ne dërguam edhe para teje të dërguar dhe atyre u mundësuar të kenë gra e fëmijë. Asnjë të dërguari nuk i takoi të sjellë ndonjë mrekulli vetëm me lejen e Allahut. Për secilin afat ekziston evidencë e caktuar.*”^{”xiii}

Këto cilësi pejgamberët i kanë të përbashkëta me njerëzit, sepse janë njerëz. Edhe fakti që pejgamberët, si të dërguar të Allahut te njerëzit, janë njerëz, është i natyrshëm. Sepse, njeriu vetëm me njeriun krijonë afërsi, ngre lidhje me të, mëson prej tij dhe ia pranon shembullin.

Gjëja që i bën pejgamberët të dallohen nga njerëzit e tjerë është zotërimi prej tyre i një natyre që u siguron të çojnë në vend detyren e përfaqësimit hyjnor; për rrjedhojë, të kenë mundësi të marrin zbuluesin hyjnore, pra të marrin zbuluesin e Allahut. Në Kuran është tërhequr vëmendja mbi këtë çështje dhe është bërë e ditur se pejgamberët janë njerëz si ne, me ndryshimin se atyre u ka ardhur zbuluesia hyjnore.

Allahu thotë: “*Thuaj: ‘Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askë.*”^{”xiv}

Njohuritë që s`mund të merren me anë të shqisave dhe të arsyes, pejgamberët mund t`i dinë vetëm nëpërmjet zbuluesës së marrë nga Allahu.

Allahu në Kuran thotë: “*Thuaj: ‘Unë nuk ju them juve se i kam në kompetencë depot e Allahut (e t`ju sjell mrekulli), as nuk pretendoj se i di fshehtësitë (e t`ju tregoj se kur do t`ju vijë dënimi), as nuk ju them se unë jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua. Thuaj: ‘A janë baras i verbëti dhe ai që sheh?’ A nuk mendoni?’*”^{”xv}

Vetia e dytë: **Të jetë mashkull**

Një tjetër veçori njerëzore e pejgamberëve është se janë meshkuj. Pejgamberia (nubuveti) dhe dërgesa (risale) nuk i vijnë femrës. Në Kuran, duke folur për pejgamberët, është thënë “meshkujt” (burrat). Allahu në Kuran thotë:

“*Ne nuk dërguam para teje vetëm se burra nga banuesit e qyteteve, të cilët i pajisim me shpallje. A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të shihnin se si ishte përfundimi i atyre që ishin më parë? E s`ka dyshim se jeta e botës së ardhshme është shumë më e dobishme për ata të cilët janë ruajtur; a nuk mendoni?’*”^{”xvi}

Gjithashtu, Allahu në Kuran thotë:

“*Ne edhe para teje nuk dërguam tjetër pos burra, të cilëve u dhamë shpallje; e nëse nuk e dini këtë, atëherë pyetni njerëzit e dijshtëm.*”^{”xvii}

Edhe nëse është pohuar se u është dërguar zbuluesi disa nënave të pejgamberëve, si Asija dhe Merjemja, këto, në ndryshim nga pejgamberët burra, nuk janë ngarkuar me detyrë për t`ua kumtuar zbuluesin e marrë njerëzve.^{”xviii} Nuk janë zgjedhur pejgamberë prej femrash sepse ato kanë një ndërtim që nuk i lejon të përballojnë vështirësi, kurse pejgamberia është një detyrë e rëndë, e cila kërkon përballimin e vështirësive të mëdha.

Vetia e tretë: **Pejgamberët janë zgjedhur nga Allahu**

Pejgamberët janë njerëz të zgjedhur nga ana e Allahut (xh. sh.). Asnjë pejgamber nuk e ka arritur pozitën pejgamber me punë dhe përpjekje vetjake. Nga ky aspekt, pejgamberia nuk është e fituar, por e dhënë, e dhuruar. Kjo do të thotë se Allahu e ka përcaktuar që më parë pejgamberin dhe e ka përgatitur qysh në krijim personin që ka për ta bërë pejgamber, me ndërtim shpirtëror dhe fizik të përshtatshëm për këtë detyrë.

Allahu (xh. sh.) thotë: “*E kur iu vjen atyre ndonjë argument i prerë (për Muhamedin), ata thonë: ‘Kurrsesi nuk e besojmë atë (dërgesën e Muhamedit), derisa të mos na jepet edhe neve ngjashëm me atë që iu pati dhënë të dërguarve të Allahut!’ Më së miri Allahu e di ku ta vë dërgesën (risalen) e vet. Ata që bënë krim, do t`i godasë poshtërimi dhe dënimi i fortë tek Allahu, për shkak se vazhdimisht bënë hile.*”^{”xix}

Kjo zgjedhje dhe ky parapëlqim i përkjet vetëm Krijuesit të lartë. Gjithashtu, pejgamberllëku nuk trashëgohet, p.sh me të birin e Nuhut (a. s.).

Në Kuran thuhet: “*Ajo lundron me ta nëpër valë si kodra, e Nuhu e thirri djalin e vet, që ishte në një vend të ndarë: ‘O djali im, hip bashkë me ne, e mos u bë me mohuesit!’*”^{”xx}

Gjithashtu, Allahu thotë: “*(Zoti) Tha: ‘O Nuh, ai (djali) nuk ishte nga familja jote (për të cilën të premtova se do t`i shpëtoj); ai ishte punëkeq, e ti mos më kërko Mua atë që nuk di, Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga injorantët!’*”^{”xxi}

Edhe i ati i Ibrahimit ka qenë mohues. Allahu (xh. sh.) thotë: “*Edhe lufta e Ibrahimit për babain e vet nuk ishte tjetër, pos për shkak të një premtimi që ia pati premtuar atij, e kur iu bë e qartë se ai është armik i Allahut, u largua prej tij. S`ka dyshim, Ibrahimit ishte shumë i ndieshëm dhe i butë.*”^{”xxii}

Vetia e katërt: **Pejgamberët janë të mbrojtur nga mëkatet**

Rënia në mëkat e pejgamberëve të ngarkuar me detyrë për t`u bërë shembull për njerëzit në çdo gjë, veçanërisht në zbatimin e urdhrave hyjnorë, është penguar nga Allahu (xh. sh.) në përputhje me dërgimin e tyre. Mëkatet ndryshojnë për nga rreziku i tyre. Mëkati më i rrezikshëm është kufri (qufri).^{”xxiii} Pra, pejgamberët janë të pagabueshëm, të mbrojtur nga kufri (qufri) si para pejgamberisë, ashtu edhe pas saj. Ndërkaq, për disa gabime që iu kanë ndodhur disa perjgamberëve, si p.sh. Ademi (a. s.) që hëngri nga pema, duke mos e respektura ndalimin hyjnor, si dhe fakti që Musa (a. s.) vrau një njeri pa qëllim, kanë ndodhur në periudhën kur këta të dy nuk qenë të ngarkuar ende me detyren e pejgamberllëkut.^{”xxiv} Kur kanë bërë gabime të vogla, janë paralajmëruar dhe iu është thënë se veprimet në fjalë nuk kanë qenë të përshtatshme. Rasti kur Muhamedi (a. s.) derisa po nisej për në fushën e Tebukut, u dha leje hipokritëve që i kërkuan falje, si dhe rastet kur ai pothuajse është ndikuar që disa çështje, nga fjalët e njerëzve, janë ndër gabimet për të cilat ka marrë paralajmërim hyjnor.^{”xxv} Dijetarët islamë i kanë konsideruar këto raste si rrëshqitje. Atributi pamëkatësi është i posaçëm vetëm për pejgamberët.

Vetia e pestë: **Pejgamberët janë të besueshëm (el-emaneh)**

Pejgamberët janë njerëz të besueshëm si në kryerjen e detyrës si pejgamber, ashtu edhe në marrëdhëniet që i përkasin kësaj bote me njerëzit tjerë. Pejgamberit nuk i shkon tradhtia ndaj amanetit. Personi që e tradhton amanetin, në ditën e kiametit e bart në qafë mëkatin e tradhtisë së bërë. Kjo cilësi e pejgamberëve njihet edhe me emërtimin besueshëm (el-emaneh).

Vetia e gjashtë: **Plotësisht i mençur, i përpiktë dhe i drejtë**

Meqë pejgamberët janë ngarkuar me detyrë për t`i edukuar njerëzit, për t`u prirë atyre, janë pajisur edhe me disa cilësi të larta që nuk e mënjanojnë qenien e tyre njeri. Në krye të këtyre cilësive vijnë aftësitë shpirtërore si: mençuria, zgjuarsia, morali i lartë dhe vetitë fizike si: trupi i bukur etj. Për t`i shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme mesazhet hyjnore që i paraqesin dhe për t`i përballuar siç duhet njerëzit që bartin një karakter shumë polemik, është kusht që pejgamberët të jenë të patëmetë dhe të përsosur nga trupi, si

dhe të pajisur me një mendje dhe zgjuarsia të lartë, të aftë për të nxjerrë argumentet gjatë debateve.

Këto janë disa veti që duhet t`i posedojnë pejgamberët e Allahut dhe ne u munduam në pika të shkurtra të bëjmë sqarimin e tyre.

MU`XHIZET (PËRKUFIZIMI DHE DOMOSDOSHMERIA E BESIMIT NË TO)

Përkufizimi i mu`xhizes: *Mu`xhize është çdo gjë që është e jashtëzakonshme (mbinatyrore, mrekulli), e cila ndodh nga ana e njeriut që pohon pejgamberinë në kohën kur kundërshtohet dhe sfidohet nga ana e mohuesve dhe kjo ndodh në mënyrë që të vihet në dukje (vërtetuar) korrektësia e pohimit të tij.*^{”xxvii}

Me fjalën “*e jashtëzakonshme, mbinatyrore*”, kemi për qëllim të theksojmë se mu`xhizja ndryshon nga ajo që është e zakonshme dhe e përditshme, por megjithëkëtë ajo nuk është në kundërshtim me mendjen dhe me të mundshmen. Kurse me fjalën “*në kohën kur kundërshtohet dhe sfidohet nga ana e mohuesve*”, nga kjo kuptojmë se bën përvajtshim ajo që ndodh papritmas, d.m.th. jo në mënyrën e sfidimit dhe jo duke treguar, a paraqitur (e për të vë në dukje) korrektësinë e pejgamberisë. Përndryshe, kjo atëherë konsiderohet si lloj i ndërimit (keramet) nga ana e Allahut. Por, duhet të theksojmë se nuk është kusht që sfidimi të deklarohet dhe të bëhet publikisht, por mjafton që për një gjë të tillë të tregojë konteksti dhe ndër-lidhja e situatës. Kurse me fjalën “*kjo ndodh në mënyrën që të vihet në dukje (që të vërtetohet korrektësia e pohimit të tij)*”, me këtë kemi për qëllim të bëjmë përjashtimin e ndodhive të jashtëzakonshme, të cilat bëhen me pretendimin për të përgënjeshtuar pejgamberinë; bie fjala, nëse flet gjëja që është e ngurtë dhe flet për të përgënjeshtuar atë pohim të pejgamberit.

Dispozita e sheriatit në besimin e mu`xhizes: Çdo mysliman detyrohet që të besojë se Allahu (xh. sh.) të dërguarit (resulët) dhe pejgamberët (enbijatë) që i ka dërguar te njerëzit, i ka pajisur me mu`xhize (mrekulli), të cilat dëshmojnë korrektësinë dhe vërtetësinë e thirrjes së tyre. Njëkohësisht, këto mu`xhize ua bëjnë të qartë njerëzve lidhjen e pejgamberëve me Allahun (xh. sh.) dhe se ata janë të përkrahur nga Ai. Ndërkaq, nuk ka ndonjë pejgamber që nuk është nderuar me mu`xhize, për t`u tërhequr njerëzve vëmendjen se doemos duhet ta

besojnë atë pejgamber dhe se duhet përfuar patjetër udhëzimi i tij.

Lidhur me këtë i dërguari i Allahut thotë: “*Çdo pejgamber është përkrahur me argumente të patundshme (mu`xhize), sipas të cilave njerëzit kanë besuar, kurse mua më është dhënë vahji, që më është shpallur mua, andaj unë shpresoj që Ditën e Gjykimit të kem më shumë pasues se të gjithë ata.*”^{”xxviii}

Po ashtu, edhe ajetet kuranore që flasin për përkrahjen e Allahut që u ka dhënë pejgamberëve, janë të shumta, por ne do të sellim disa nga ato ajete.

Allahu (xh. sh.) thotë: “*Dhe thanë: ‘Përse të mos i zbrit atij (Muhamedit) një mrekulli nga Zoti i tij?’ Thuaj: ‘S`ka dyshim se Allahu ka fuqi t`ia zbrësë një mrekulli, por shumica e tyre nuk e dinë (se çka do t`i gjente më pas).*”^{”xxviii}

Po ashtu, Allahu thotë: “*Ata u betuan me një betim të fortë në Allahun, se nëse u vjen atyre ndonjë mrekulli, do ta besojnë. Thuaj: ‘Çështja e atyre mrekullive është tek Allahu.’ E ku e dini ju, ndoshta kur të vijë ato nuk u besojnë.*”^{”xxix}

Mu`xhizet e treguara nga Pejgamberët janë tre llojesh:

a) **Mu`xhizet përceptimore**

Janë mrekulli që u flasin shqisave të njerëzve. Mu`xhizet përceptimore, të cilat realizohen sipas lejes, vullnetit dhe fuqisë së Allahut, janë akte hyjnore që i ndryshojnë ligjet e natyres.

“*Ne kemi dërguar pejgamberë para teje, për disa prej tyre të kemi njoftuar me rrëfimet e tyre, e për disa nuk të kemi njoftuar, e asnjë pejgamberi nuk i takoi të sjellë ndonjë argument, vetëm se me urdhrin e Allahut. E kur të vijë koha e caktuar nga Allahu, zbatohet gjykimi me drejtësi dhe aty atëherë dështojnë ata të kotët.*”^{”xxx}

Këto mrekulli, që e fuqizojnë besimin e atyre që dëshirojnë të besojnë, si dhe mohimin e atyre që s`duan të besojnë, janë realizuar shumë herë. Një pjesë e këtyre mrekullive janë *orientuese*, kurse një pjesë tjetër - mrekulli *shkatërruese*.^{”xxxi} Njëra prej mrekullive orientuese, që njoftohet në Kuran, është mrekullia e devesë së Salihut (a. s.).^{”xxxii} dhe fakti që zjarri nuk e dogji Ibrahimin (a. s.), e hedhur aty nga Nemrudi, është një mrekulli e hapur e këtij lloji.

Edhe shndërrimi i shkoptit të Musait (a. s.) në gjarpër, si dhe reflektimi nga dora e tij i një drite të bardhë, janë mrekulli orientuese.

Magjistarët që patën dashur të orien-

tohen, para mrekullive përceptimore të treguar nga Musai (a. s.) i patën besuar pejgamberllëkut të tij, kurse Faraoni dhe përkrahësit e tij i patën konsideruar këto si mrekulli si magji, kurse Musain (a. s.) si magjistar. Kurse Isai (a. s.), i ardhur në botë pa baba, u pati zbritur havarive (apostujve) nga qielli, me kërkesën e tyre, një sofër plot ushqime, me qëllim për t`ua shtuar besimin: duke folur në kohën që ishte ende një fëmijë në djep, pati thënë se Allahu i kishte dhënë libër dhe se e kishte bërë pejgamber, pati ngjallur zogun e bërë prej argjile: pati shëruar të verbërit e lindur dhe të sëmurë të tjerë dhe pati ringjallur të vdekurit.

Ata që nuk u kanë besuar pejgamberëve, pavarësisht nga shumë mrekulli të sjella prej tyre, që i kanë mohuar me këmbëngulje dhe që i kanë poshtëruar, që i kanë munduar dhe kanë tentuar t`i vrasin, kanë kërkuar për vete mrekulli që do t`i shkatërronin. Edhe Allahu i lartë i ka shkatërruar ata me anë të mrekullive shkatërruese, si mrekullia e përmbytjes për fisin e Nuhut, mrekullia e përmbytjes për fisin Themud të pejgamberit Salih, për fisin Ad të pejgamberit Hud, të fisit Medjen të pejgamberit Shuajb, mrekullinë e tërmetit dhe të shiut të gurëve për fisin e pejgamberit Lut dhe mrekullia e çarjes së detit për të prirë ushtrinë e faraonit, i cili këmbëngulte në mohimin e Musait.

Qoftë për orientim, qoftë për shkatërrim, asnjëra prej mrekullive nuk është një dukuri që mund ta realizojë ndonjë njeri. Sepse, realizimi i një mrekullie kërkon njohjen dhe mundësinë e ndryshimit të ligjeve të natyrës. Asnjë njeri nuk e zotëron këtë njohuri dhe fuqi; është vetëm Allahu fuqiplotë.

b) **Mu`xhizet informative**

Mrekullitë informative përbëhen prej informacioneve të dhëna nga pejgamberët jo me ndonjë metodë të tillë si falli, orakulli etj., por duke u mbështetur në zbuluesat e marra nga Allahu drejtpërsëdrejti, ose me ndërmjetësimin e engjëllit. Informacioni i dhënë nga Isa (a. s.) për gjërat që hanin dhe fshihnin njerëzit në shtëpi, njohja nga Muhamedi (a. s.) për ngjarjet e ndodhura mes pejgamberëve të shkuar dhe fiseve të tyre, njohja e hollsishtme e bisedave të bëra mes tyre dhe përsëritja e tyre në prani të dijetarëve hebrenj dhe të krishterë, paralajmërimi prej tij se bizantinët do t`i mundin persianët në luftë, se mbretërimi i Kiskasë do të shembet, se Islami do të përhapet në lindje dhe në perëndim, si dhe vërtetimi i të gjitha këtyre një për një dhe po kështu

në të ardhme - janë mrekulli informative.^{xxxiii}

c) Mu`xhizet njohëse

Nuk ka dyshim se argumenti më i fuqishëm dhe ndikues që provon vërtetësinë e pejgamberisë, është mrekullia njohëse. Me të vërtetë, pejgamberët, me njohuritë e sjella qoftë mbi gjithësinë, qoftë pothuaj të gjitha çështjeve që e interesojnë individin dhe shoqërinë, i kanë treguar njerëzimit rrugët për arritjen e lumturisë së kësaj bote e të përjetësisë. Të gjitha njohuritë e mësuar njerëzimit nga pejgamberët, pa prituri asnjë lloj shpërblimi prej tyre, mund të shprehen në dy koncepte: *urtësi dhe udhëzim*. Po të mos ishin pejgamberët, njerëzit nuk do ta gjenin dot urtësinë dhe nuk do të viheshin dot në udhë të drejtë. Prandaj, në Kuran është urdhëruar që ftesa për në udhën e Allahut të bëhet së pari me urtësi dhe është shpjeguar se urtësinë që u është zbritur me rrugën e zbulesës, pejgamberët ua kanë mësuar njerëzve.

Allahu në Kuran thotë: **“Zoti ynë, dërغو ndër ta, nga gjiri i tyre, të dërguar që t'u lexojë atyre ajetet Tua, t'u mësojë atyre librin dhe urtësinë e t'i pastrojë (prej ndytësisë së idhujtarisë) ata. S'ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijshmi.”**^{xxxiv}

Gjithashtu, Allahu thotë: **“(Sikurse plotësova mirësinë Time ndaj jush) Ashtu siç dërguam nga gjiri juaj të dërguar t'u lexojë ajetet Tona, t'ju pastrojë e t'ju mësojë librin dhe traditën, e edhe t'ju mësojë atë që nuk e dinin.”**^{xxxv}

Dhe shumë ajete të ngjashme, që konfirmojnë urtësinë e pejgamberëve.

Pejgambërët i kanë drejtuar njerëzit për ta interpretuar ekzistencën e gjithësisë, së bashku me gjithçka që përmbahet në të dhe u kanë dhënë atyre mbi këtë çështje njohuri racionale udhëzuese.^{xxxvi}

NUMRI I PEJGAMBERËVE

Në Kuran nuk ka të dhëna për numrin e pejgamberëve; vetëm është thënë se çdo popull dhe çdo zone i janë dërguar pejgamberë që i kanë përgëzuar me xhenet ata që u besojnë urdhrave hyjnorë dhe bëjnë siç thonë ata, kurse i kanë fikësuar me xhehenem ata që i mohojnë urdhrat hyjnorë dhe kundërshtojnë. Emrat e një pjese prej tyre janë përmendur dhe është folur për luftën dhe përpjekjen që kanë bërë ata me fiset e tyre, kurse për pjesën tjetër nuk është folur fare.

Allahu (xh. sh.) më së miri na tregon

në Kuran, ku thotë: **“Dhe (dërguam) të dërguar më parë që të rrëfyem për ta, dhe të dërguar të tjerë, për të cilët nuk të rrëfyem...”**^{xxxvii}

Edhe pse në disa rivajete të dedikuara pejgamberike bëhet e ditur se janë dërguar gjithsej 124 mijë pejgamberë,^{xxxviii} ndër të cilët 315 të dërguar (resulë), meqë kjo s`përbën informacion të saktë, përcaktimi i numrit të pejgamberëve, duke u mbështetur në këtë, s`është me vend. Prandaj, besimi te pejgamberët përmbledh të gjithë pejgamberët të ardhur mes pejgamberit të parë Adem (a. s.) dhe pejgamberit të fundit, Muhamedit (a. s.).

Ndërkaq, është detyrim (farz) të shprehet besimi veç e veç për të gjithë pejgamberët, emrat e të cilëve përmenden në Kuran. Këta janë: Adem, Idris, Nuh, Hud, Salih, Ibrahim, Lut, Ismail, Is`hak, Jakub, Jusuf, Ejub, Dhulkifli, Musa, Harun, Sulejman, Davud, Iljas, Eljesa, Junus, Zekerija, Jahja, Isa dhe Muhamed (a. s.). Profetësia e Uzejrit, Llukmanit dhe e Dhurkarnejnit, ndërkaq, është e diskutueshme.^{xxxix}

Kemi edhe shumë pejgamberë të tjerë, të cilët Kurani nuk i ka përmendur, për të cilët nuk na ka rrëfyer asgjë, por për ta na ka lajmëruar në përgjithësi. Prandaj edhe besimi në ta, në përgjithësi, është i detyrueshëm: pikërisht që të besojmë se Allahu (xh. sh.) ka dërguar edhe shumë pejgamberë (enbija) dhe të dërguar (resul) çdo popull dhe grupi në vende dhe gjatë periudhave të ndryshme. Nga kjo mund të kuptosh shkallën e lartë të injorancës së atyre që parafytyrojnë se Allahu (xh. sh.) me pejgamber (enbija) dhe të dërguar (resul) e ka veçuar rajonin e Gadishullit Arabik. E vërteta është se pejgamberët që u dërguan në këtë rajon të botës janë vetëm një numër i vogël, në krahasim me shumën e pejgamberëve që iu dërguan grupeve të ndryshme të njerëzve në lindje e perëndim të botës.

Allahu (xh. sh.) thotë: **“...nuk pati asnjë nga popujt që nuk pati të dërguar.”**^{xl}

Pra, sipas kësaj, numri i pejgamberëve gjatë periudhave të ndryshme patjetër duhet të ketë kaluar mijëra. Pra, siç thotë Allahu (xh. sh.) në Kuran: **“Dhe (dërguam) të dërguar më parë që të rrëfyem për ta, dhe të dërguar të tjerë për të cilët nuk të rrëfyem...”**^{xli}

Me përcaktimin e numrit (siç thotë dhe Nesefiu),^{xlii} ne nuk jemi të sigurt se nuk kemi përfshirë dikë që nuk është prej tyre, ose të kemi nxjerrë dikë që është brenda tyre.

Literatura:

1. Kurani me përkthim në gjuhën shqipe nga përkthyesi Sherif Ahmeti
2. “Bazat e besimit islam”, prof. dr. Bekir Topaloglu, Prishtinë, 2002
3. “Të vërtetat e patundshme të besimit islam”, prof. dr. Muhammed Seid Ramadan el-Buti, Tetovë, 2004
4. “Rrëfime për të dërguarit e Allahut”, Hafidh Ibn Kethir, Prishtinë, 2005
5. “Hadithe të zgjedhura të Pejgamberit (a. s.)”, Tetovë, 2003
6. “Besimi i myslimanit”, Shkup, 2001

ⁱ. Mu`min: 78

ⁱⁱ. Junus: 47

ⁱⁱⁱ. Bekare: 285

^{iv}. Bekare: 136

^v. En Nisa: 136

^{vi}. En Nisa: 150 - 152

^{vii}. Muhammed Gazali, “Besimi i myslimanit”, Shkup, 2001, fq. 243

^{viii}. Prof. dr. Bekir Topaloglu, “Bazat e besimit islam”, Prishtinë, 2002, fq. 127

^{ix}. Prof. dr. Muhamed Seid Ramadan el-Buti, “Të vërtetat e patundshme të besimit islam”, Tetovë, 2004, fq. 176

^x. Prof. dr. Muhamed Seid Ramadan el-Buti, op. cit. fq.176

^{xi}. El Haxh: 52

^{xii}. El – Maide: 75

^{xiii}. Er – Rad: 38

^{xiv}. El – Kehf: 110

^{xv}. El - En`am: 50

^{xvi}. Jusuf: 109

^{xvii}. El Enbija: 7

^{xviii}. Prof. dr. Bekir Topaloglu, op. cit. fq.143

^{xix}. El En`am: 124

^{xx}. Hud: 42

^{xxi}. Hud: 46

^{xxii}. Et – Tevbe: 114

^{xxiii}. Prof. dr. Muhamed Seid Ramadan el-Buti, fq.196

^{xxiv}. Prof. dr. Bekir Topaloglu, op. cit. fq.144

^{xxv}. Prof. dr. Bekir Topaloglu, op. cit. fq.145

^{xxvi}. Prof. dr. Muhamed Seid Ramadan el-Buti, op. cit. fq.209

^{xxvii}. Prof. dr. Muhamed Seid Ramadan el-Buti, op. cit. fq.210

^{xxviii}. El En`am: 37

^{xxix}. El En`am: 109

^{xxx}. El Mu`minun: 78

^{xxxi}. Prof. dr. Bekir Topaloglu, op. cit. fq.134

^{xxxii}. Shih më gjerësisht ngjarjen në librin e Hafidh Ibn Kethirit “Rrëfime për të dërguarit e Allahut”, po ashtu edhe në Kuran.

^{xxxiii}. Prof. dr. Bekir Topaloglu, op. cit. fq.137

^{xxxiv}. El Bekare: 129

^{xxxv}. El Bekare: 251

^{xxxvi}. Shih më gjerësisht në librin “Bazat e besimit islam” nga autori: prof. dr. Bekir Topaloglu, 137 - 138 - 139

^{xxxvii}. En Nisa: 164

^{xxxviii}. Musned, vëll. V, fq. 266

^{xxxix}. Hafidh ibn Kethir, “Rrëfime për të dërguarit e Allahut”, Prishtinë, 2005

^{xl}. Fatir: 24

^{xli}. En Nisa: 164

^{xlii}. Prof. dr. Muhamed Seid Ramadan el-Buti op. cit. fq.191



MBRESA NGA KAJROJA



Nga Shaqir ef. Fetahu

Kajro, ky qytet i kulturës dhe i civilizimit. Kur e sheh, vërtet nuk të lë ta shohësh vetëm me sy. Ai nxit së pari shpirtin e mandej edhe mendjen. Atë më së shumti e kupton shpirti sesa syri dhe mendja. Fjala është e paaftë ta shpjegojë atë. Mendja vetëm mund të marrë ide aq sa ka mundësi të thellohet në vlerat e tij. Ai më duket si një oqean i kulturave, i civilizimeve, i vlerave, i besimeve, i bindjeve, të cilat i ruan me përkushtimin më të madh.

Thonë se edhe rrugët në Kajro janë mësim. Ashtu është. Thonë se edhe pluhuri atje është kulturë; edhe pasuria, edhe varfëria; gjithçka është pjesë përbërëse e kulturës së këtij qyteti.

Atje sheh gjithçka: të bardhë e të zinj, të varfër e të pasur, të ditur e të paditur, të lumtur e të pikëlluar. Por, mbi të gjitha sheh modelin e të jetuarit në një qytet që ushqen shpirt, moral, paqe, tolerancë, bashkëjetesë, dashuri, solidaritet etj. Me shekuj aty kanë vepruar faraonët, pastaj edhe shqiptarët. Sa bukur tingëllon kur të thërrasin dhe komunikojnë me shprehjen

“Ja Basha”. Dhe pyeta: E çka është kjo thirrje? Më thanë: “Është fjalë respekti dhe e sjelljes ndaj njerëzve, që e ngre vullnetin, dinjitetin, inspirimin, mençurinë, urtësinë. Emri “Basha” është sinonim i reformatorit të madh të Egjiptit modern, Muhamed Ali Pasha, nga i cili rrjedh Dinastia Shqiptare, e cila e udhëhoqi me qindra vjet Egjiptin, deri pas gjysmës së shekullit të kaluar, me rrezimin e mberit Faruk, me çka përfundoi udhëheqja e kësaj dinastie, udhëheqje kjo që i dha kahe moderne Egjiptit, duke e bërë vend të shkencës, të kulturës, të artit e të vlerave të ndryshme njerëzore.

Ajo që më la përshtypje është Radio-Kajro, që emeton lajme dhe emisione në gjuhën shqipe. Ndoshta në shikim të parë të duket diçka e vogël, por mendoj se është një qendër e madhe për shqiptarët dhe një vlerë e madhe për kulturën shqiptare në përgjithësi. Ajo mban përkujtimin e Dinastisë udhëheqëse Shqiptare, pastaj qëndrimin e rilindësve të mirënjohur shqiptarë, të kuadrove teologjike islame të vendit tonë, prej h. Bedri ef. Hamidit, ish-Kryetar i BFI, e deri në kohën e sotme. Sot këtë radio e udhëheq një kua-

dër i mirënjohur nga Miletina e Tetovës, z. Shaban Rexhepi, ish-i diplomuar i Medresesë Isa Beu në Shkup dhe i diplomuar në Universitetin e Ez'herit dhe tani paraqet një personalitet të mirënjohur, mirë të përgatitur, të urtë, të zgjuar dhe aktivistin e madh që me përkushtim të thellë dhe profesionalizëm e kryen detyrën e tij të gazetarit në Kajro, që na bën të rëndësishëm që t'i forcojmë lidhjet tona dhe bashkëpunimin në shumë sfera.

Bazë e kulturës dhe qendër e gjithçkasë në Kajro është Universiteti i Ez'herit, i themeluar që në shekullin nëntë dhe që njihet si universiteti më i vjetër në historinë njerëzore. Në të tani ka me qindra mijëra studentë nga e gjithë bota; pa dallim ngjyre, vendi, hapësire dhe besimi. Vërtet, vatër e shkencës dhe e hulumtimit të Islamit. Më i vjetri në botë. Vatër që mësoi botën si të mësojë, si të hulumtojë, si të silltet e si të bashkëjetojë.

Të kuptosh Kajron, të duhen muaj e vite. Gjithçka në Kajro e ka kuptimin e vet, domethënien e vet. Është qyteti që të mahnit. /F.23.10.2022/

(Autori është Reis'ul-Ulema i Bashkësisë Fetare Islame të RMV)

METODA E THIRRJES NË NAMAZ

“Të bëhesh shkak për udhëzimin e dikujt është më e mirë për ty se gjithë bota dhe çka ka në të.” (Hadith)

Shkruan: Musanif Rufati

E dhe pse ky titull i referohet namazit, e cila është një temë e veçantë, ai mund të quhet një ftesë për udhëzim në terma të përgjithshëm. Sepse, me vendosjen dhe fillimin e namazit, njeriu hyn në një rreth praktik të vazhdueshëm dhe të rregullt të Islamit. Namazi është fillimi i një jete të re. Pas këtij fillimi, personin e presin ndryshime pozitive në strukturën e personalitetit dhe stilin e jetës. Thirrësi duhet ta drejtojë dhe ta ndihmojë atë në rregullimin e çdo aspekti të jetës së tij, në mënyrë që ta bëjë personin të dobishëm dhe besimtar të denjë.

Çështja që thirrësi duhet t'i kushtojë vëmendje këtu është për t'i dhënë atij dijen, besimin dhe guximin e nevojshëm për të organizuar vazhdimësinë e adhurimit në jetën e tij të ardhshme sipas standardeve islame. Më e rëndësishmja, mënyra më efektive që mund të bëjë thirrësi është të japë një shembull të mirë me jetën e tij. Nuk është e lehtë të bësh një ndryshim rrënjësor në jetën e një personi për shkak se ai ka kaluar shumë vite në shkujdesje. Kjo kërkon vëmendje të vazhdueshme. Duke pasur parasysh se braktisja e praktikës së kaluar dhe fillimi i një jete me namaz është gjëja më e rëndësishme për njeriun, thirrësi i cili e fton duhet të jetë i pajisur me dije të thellë fetare. Kjo nuk është dhe aq e lehtë si mendohet. Thirrësi duhet të dijë ajete, hadithe, histori dhe shembuj nga jeta e përditshme për namazin dhe të ketë një shpjegim të mirë. Ai duhet të jetë në gjendje t'u përgjigjet justifikimeve, pyetjeve dhe problemeve të paraqitura në lidhje me namazin dhe t'i hapë rrugën personit.

Thirrësi për në namaz mund të has në vështirësi vetëm te një popull mohues. Në një shoqëri që është e prirur për besim, ekziston një mjedis i gatshëm dhe i lehtë për një thirrës të ditur. Gjërat e nevojshme për këtë mjedis janë: morali i mirë, njohuritë e mjaftueshme, fytyra e qeshur, aftësitë, përpjekjet dhe durimi. Edhe nëse këto cilësi nuk janë të thirrësi, falë qëllimit, sinqeritetit dhe mundimit të tij, cilësitë që nuk i ka, mund t'i jepen si dhuratë hyjnore.



Thirrësi duhet të ketë njohuri dhe përvojë për pengesat dhe zgjidhje për problemet që njerëzit hasin sapo kanë filluar të falen. Pengesat me të cilat ballafaqohet praktikuesi i ri i namazit mund të jenë: shprehi të këqija, dobësi të ndryshme, nënçmim nga ana e familjes, shoqëve apo kolegëve të punës, distancim apo tallje me të. Përveç kësaj ai mund të ketë edhe ndrojtje nga ndonjë shkak tjetër dhe kjo mund të jetë pengesë për namazin e tij. Këto mund të jenë shkaqe që ai të fillojë dhe pastaj ta braktisë faljen e namazit. Dobësitë e tilla thirrësi duhet t'i hetojë dhe të mundohet t'i largojë nga ai.

Si rrjedhim, sinqeriteti, dija dhe vazhdimësia në thirrje vijnë në fillim të kushteve të domosdoshme të saj (të ftesës). Kështu që është e nevojshme të kujdeseni për të pa ndërprerje dhe të mos merrziteni. Lënia e papërfunduar e thirrjes dhe shfaqja e plogështisë i bën të kota të gjitha përpjekjet e mëparshme.

Çështja e udhëzimit, e cila është më e mirë se bota dhe çdo gjë në të, është një profesion i Pejgamberit (a. a.), çmimi i të cilit nuk ngel pa u paguar.

Më poshtë do të paraqesim disa këshilla mbi metodën e thirrjes, të cilat duhet t'i ketë thirrësi gjatë ftesës për namaz:

1. Filloni duke krijuar një bisedë dhe intimitet me personin që do të ftoni në namaz. Jini serioz në këtë çështje.
2. Arsyeja pse ata nuk falen është zakonisht sepse nuk dinë sure apo pjesë nga Kurani, nuk e dinë namazin dhe rregullat e tij, mirëpo këto nuk ia tregojnë askujt nga frika se mos turpërohen. Prandaj, është e nevojshme të bisedoni me ta pa i lënduar. Nxitni ata të flasin lirshëm.
3. Gjithashtu, një nga pengesat më të mëdha për ata që janë larg namazit

janë iluzionet e panevojshme. Identifikoni ato dhe bëni shpjegime. Bëjini ata të flasin duke bërë pyetje.

4. Rrite shpresën dhe guximin duke shpjeguar se sa e lehtë është të zgjidhësh problemet dhe sa e lehtë është të falesh, duke synuar virtytin e faljes dhe madhështinë e shpërblimit të saj.

5. Jepni shembuj nga Kurani, nga hadithet dhe tregimet e ndryshme se si Islami i kushton rëndësi të madhe namazit. Çështja që duhet theksuar në mënyrë të veçantë është vlera e bekimeve që na ofrohen dhe domosdoshmëria për të qenë mirënjohës ndaj tyre.

6. Për një person që sapo ka filluar të falet, rreziku i lënies së namazit është i lartë në kohët e para. Një pengesë e theksuar, një justifikim ose ndikimi negativ i mjedisit të tij mund ta bëjë atë të braktisë namazin. Arsyeja kryesore për këtë është se vetëdija e robërisë ndaj Allahut nuk është vendosur ende te njeriu dhe ai nuk ka informacion të mjaftueshëm për rëndësinë e namazit dhe natyrën e Islamit. Për të plotësuar mangësitë në këtë lëndë, duhet të lexojmë libra që personi mund t'i kuptojë lehtësisht dhe të lehtësojë zhvillimin e tij me mjete audio dhe vizuale.

Edhe pse ka shumë pika që duhet pasur parasysh, në këtë artikull do të mjaftohemi me disa prej tyre.

Thirrësi nuk është një besimtar i zakonshëm. Demonstrimi i një shembulli të mirë të një myslimani është përgjegjësia më e rëndësishme e tij.

Shkurt, myslimani duhet të jetë në konkurrencë me veten e tij. Ai vazhdimisht duhet të përplojë që ta kapërcejë nivelin e vet aktual dhe pengesat për të qenë një person i mirë. Çështjet më të rëndësishme në punën e tij janë: durimi, toleranca dhe kujdesi i vazhdueshëm.

VETMIA VRET, VETMIA NUK SHËRON

Njeriu është qenie shoqërore dhe lidhja e tij emocionale me të tjerët e plotëson dhe e bën më të lumtur. Njeriu, duke u mbështetur te tjetri, e gjen qetësinë dhe përkrahjen. Sa më shumë që të aktivizohet dhe t'u bëjë mirë të tjerëve, aq më shumë ai i afrohet Zotit, Krijuesit, i Cili ka faljen dhe mëshirën e madhe.

**Shkruan: Hfz. Mehas Alija
(Enkas për HeR)**

Falënderimi i takon Zotit të botëve, i Cili ka krijuar, ndër të tjera, kohën dhe njeriun. Kur njeriu e çmon kohën, ai ka vlerësuar një mirësi të Zotit, për të cilën edhe është betuar. Koha ka mundësi të kalohet vetëm, por ka mundësi të kalohet edhe me shoqëri dhe në aktivitete shoqërore. Njeriu i sotëm, si duket, është prirur të distancohet, ta kalojë kohën i vetëm, me dëshirën apo pa dëshirën e tij. Kalimi i kohës në vetmi, njeriut i kanos jetën dhe shëndetin. Vetmimi vetëm me Zotin, vetmia duke u thelluar herë pas here në meditim, sigurisht se është e shëndetshme dhe e kërkuar, por jo të jetë stil dhe modë kohe. Veçimi dhe largimi pa nevojë nga njerëzit, është ikje nga vetvetja, e përshtuar me sfida dhe probleme të ndryshme.

Në dhjetë vitet e fundit mjekësia ka bërë të ditur se vetmia është një nga faktorët e rëndësishëm që ndikon në shkatërrimin e shëndetit dhe në shtimin e sëmundjeve dhe rritjen e numrit të vdekjeve. Sipas disa hulumtimeve më të reja, vetmia shkakton më shumë dëme se sa mund të shkaktojë mbipeshja, shtypja e lartë dhe pirja e duhanit.

Nëse i shfletojmë tekstet fetare, Kurranin dhe traditën profetike, do të shohim se të jetuarit i vetëm, larg njerëzve, nuk është e përkrahur nga Zoti dhe aspak e shëndetshme.

Në faqet e Kuranit fisnik hasim shqetësimin e Zekerijjasë (a. s.), i cili në moshë të shtyrë, nga frika se do të mbetet pa trashëgimtar, iu drejtua Zotit me lutjen: **"U frikësohem të afërmeve të mi pas meje, ndërsa bashkëshortja ime është sterile, andaj më dhuro nga ana jote një pasardhës."** (Merjem: 5)

Lutja e pejgamberit Zekerijja (a. s.), në një kuptim më të gjerë, mund të kuptohet si një shprehje natyrale e frikës njerëzore nga vetmia dhe të mbeturit i vetëm dhe në vetmi.



tohet si një shprehje natyrale e frikës njerëzore nga vetmia dhe të mbeturit i vetëm dhe në vetmi.

Ka njerëz që kanë nevojë të distancohen ngapak prej njerëzve, sepse kështu ndjehen më rehat, por ka dhe të tillë që, edhe përkundër asaj se janë të rrethuar me njerëz, përsëri ndjehen të vetmuar, për mos me thënë më keq, të lënë pas dore.

Vetmia përjetohet më rëndë atëherë kur njerëzit e tu të afërt, me të cilët ke lidhje emocionale, nuk i ke pranë dhe nuk të vizitojnë. Sa shumë nëna dhe baballarë kemi sot të vetmuar? Sa e sa vëllezër u ndanë nga motrat e tyre, nga kushërinjtë dhe shokët, të cilët, për shkaqe të vështirësive dhe nevojave ekzistenciale, u desh të merrnin rrugët e ndarjes nga njëri-tjetri?

Teknologjia bashkëkohore ka bërë që rreziku që vjen nga vetmia të jetë më i

madh dhe të kërcënojë më shumë. Çdo ditë e më tepër kontaktet e gjalla dhe të drejtpërdrejta po zëvendësohen me komunikimin virtual. Edhe pse të rrethuar dhe të lidhur me tërë botën, prapëseprapë të rinjtë e sotëm ndjehen intensivisht të vetmuar dhe të vetëmbyllur. Për më tepër, ata që vuajnë më shumë nga pasojat e vetmisë janë të moshuarit, kështu që sipas disa të dhënave mbi 40% e vetëvrastjeve realizohen nga persona të moshës 65-vjeçare e lart, ndërsa si arsyetim merret zhgënjimi që përjetohet nga ikja e njerëzve të afërt dhe mosinteresimi i shoqërisë për t'u qëndruar afër.

Sot, për fat të keq, gjithnjë e më shumë po shohim se si po rritet individualizmi, egocentrizmi dhe narcizmi, kurse, nga ana tjetër, vrullshëm është pakësuar empatia për njëri-tjetrin, solidariteti dhe dëshira për t'u parë dhe për t'u takuar.



NARRATIVI I LIGJËRIMIT FETAR PËR KONFLIKTET EKSTERNE

Muslimani duhet ta dënojë çdo zullumqar, pa marrë parasysh cilës fe i takon. Duke e dënuar zullumin e zullumqarëve, mund që ta kthejmë në vëmendje edhe zullumin që bëhet ndaj muslimanëve në vende të ndryshme.

Shkruan: Bashkim Aliu (Enkas për HeR)

JO ÇDO LAJM NË KURSINË E XHAMISË

Ngjarjet që ndodhin në çdo anë të globit - qofshin të karakterit global, apo lokal - u nënshtrohen analizave dhe vlerësimeve nga aspekte të ndryshme - si nga institucione publike, po ashtu dhe nga institucione të tjera; si dhe nga individë. Për masën e gjerë dominojnë vlerësimet e analistëve në programe të ndryshme debative, si dhe në kolumna në gazeta dhe në media të tjera elektronike.

Në kohën e mediave sociale janë me qasje edhe analizat e individëve të ndryshëm, të cilët jo domosdoshmërisht i shprehin qëndrimet e veta në media elektronike dhe të shkruara, por mjaftojnë me hapësirën që e kanë në rrjetet sociale për të bërë analiza dhe vlerësime për ngjarje të ndryshme. Në këtë kontekst, nuk mund të mos përmenden edhe institucionet fetare, me theks të veçantë xhamitë, ku ligjëruesit fetarë, në ligjëratën e së premtës, u qasen në mënyra të ndryshme ngjarjeve që paraqesin lajm në momentin aktual, dhe që në ndonjë mënyrë lidhen me aspekte fetare, apo me aspekte tjera të cilat kanë hapësirë për t'u trajtuar nga këndvështrimi fetar.

Me këtë, nuk synoj të jap mbështetje për çdo lajm dhe çdo mënyrë trajtimi që bëhet në foltoren (kursinë) e xhamisë, por thjesht të tregoj për një realitet ekzistues, i cili, në erën e rrjeteve sociale, nuk është i panjohur për lexuesin.

Në parim, nuk e mbështes trajtimin e çdo lajmi në kursinë e xhamisë, pa një seleksionim adekuat konform vendit, masës dhe rrethanave fetare dhe shoqërore e politike, kurse edhe më pak – apo, thënë më mirë, aspak nuk e mbështes përdorimin e çdo lloje gjuhe, qasjeje dhe narrativi gjatë trajtimit të lajmeve, në veçanti të atyre sensibile dhe nevalgjike, shtrirja e të cilave nuk ngelet në një segment, në një hapësirë dhe në një masë të caktuar, por shkon përtej, duke e shndërruar vetë atë trajtim dhe atë qasje në objekt vlerësimi dhe trajtimi nga kritikë dhe palë të ndryshme, që pasojat më pas të jenë të përmasave që nuk i ka pasur parasysh edhe vetë ligjëruesi përkatës.

Në veçanti, kjo është prezente në këtë kohë të shpërndarjes së paparë, më parë, të ligjëratave dhe të shkrimeve, për të cilën figurativisht do të thoshim se janë shndërruar në udhëtarë të cilët nuk njohin kufij. Me theks të veçantë, vëmendjen e kritikëve dhe palëve të ndryshme e tërheqin vlerësimet, analizat dhe trajtimi i lajmeve që kanë të bëjnë me pjesëtarë të një feje, e që bëhen nga pjesëtarë të feve të tjera, siç është rasti me luftën në Ukrainë dhe narrativin që përdoret për të shpjeguar momente të caktuara të kësaj lufte.

Së këndejmi, në këtë frekuencë të madhe të ligjërimeve dhe shkrimeve për ngjarjet që imponohen si kryetitull në momentin aktual, shtrohet edhe çështja e



qëndrimit të muslimanit karshi ngjarjeve ku palë janë jomuslimanët, në veçanti shtrohet çështja e mënyrës së trajtimit të këtyre ngjarjeve në ligjërimet fetare, me qëllim që të mos krijohet përshtypja e gabuar për Islamin si fe për shkak të narrativit të ligjëruesve fetarë.

Keqinterpretimi i ngjarjeve përmes gjuhës së ligjërimet fetar do të çonte në formimin, apo në vazhdimin e shprehjes së një epoke të dominuar prej paragjykimëve, stereotipeve dhe joracionales në formësimin e tablosë për karakterin e fesë islame dhe të muslimanit, e që si zakonisht eskalon për masën perëndimore, në veçanti, duke theksuar dimensionin politik të Islamit dhe të komunitetit musliman. Kjo, sa flet për krizën e racionales dhe të objektivës në Perëndim, në raport me Islamin dhe me muslimanët, që për rrjedhojë do të çonte në sakralizimin e paragjykimëve dhe të stereotipeve, po aq flet edhe për nevojën e rishikimit të vokabularit dhe të mënyrës së qasjes së ligjërimet fetar ndaj ngjarjeve të cilat, krahas aspekteve të tjera, kanë edhe karakter human.

Me këtë rast, do të nënvizojmë disa parime bazë që duhet pasur parasysh në formësimin e qëndrimit të muslimanit ndaj konflikteve në taboret tjera, si dhe në veçanti, në formësimin e ligjërimet fetar për ngjarje të karakterit të këtyre:

-Dimensioni njerëzor: Muslimani duhet të ketë qëndrim human ndaj konflikteve që ndodhin në mes pjesëtarëve të besimeve të tjera, pasi të gjithë njerëzit janë krijesa të Allahut të Madhërishtëm dhe dallimi i tyre prej nesh në besim, nuk e përjashton të qenit e tyre krijesa të Al-

lahut të Madhërishtëm.

Për rrjedhojë, edhe trajtimi i ngjarjeve të këtyre në mesin e jomuslimanëve, në fjalorin e predikuesve fetarë islamë, duhet të nisët nga parimi human dhe njerëzor, pasi njeriu gëzon dinjitet nga vetë fakti se është qenie njerëzore, ndërkaq për besimin që ka, do të përgjigjet para Krijuesit.

Megjithatë, ky dallim në besim nuk mund të merret si alibi për t'ia dashur të keqen, apo për të shprehur kënaqësi me tragjedinë që e ka goditur pjesëtarin e besimit tjetër dhe, aq më pak, mund të shërbejë që narrativi i trajtimit të tragjedisë së tyre, në ligjërimin fetar, të ketë nuanca të shfryrjes së mllefrit, të hakmarrjes për atë që ata nuk janë protagonistë të drejtpërdrejtë, si dhe nuanca cinizmi e humori.

Ky parim ka bazë në Kuranin famëlartë, pasi në të e lexojmë ajetin: “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat). Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.” [El Huxhuratë: 13]

Pikërisht për këtë qasje të Islamit ndaj njeriut si qenie, është e ndaluar shkelja e dinjitetit të njeriut përmes masakrës dhe vrasjes së joluftuesve edhe në luftëra me armiqte, e jo më të mbajmë qëndrim objektiv ndaj konflikteve që ndodhin në mes pjesëtarëve të feve të tjera, ku muslimanët nuk janë palë.

-Të mos i shmangemi drejtësisë: Islami i mëson pjesëtarët e tij që të jenë të drejtë dhe të gjykojnë me drejtësi në çdo

gjë, si dhe urrejtja ndaj dikujt, për shkak të ndonjë padrejtësie, nuk duhet të jetë shkak për të mos qenë i drejtë ndaj tij dhe për të mos gjykuar në mënyrë objektive për gjendjen e tij.

Në Kuran i lexojmë fjalët e Zotit të Madhërishtëm: “...dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë...” [El Maide: 8]

Krijuesi e ndalon muslimanin që t’i shmanget drejtësisë kur gjykon për dikë të cilin e urren, e mos të flasim se ky urdhër, si do të duhej të kuptohej, kur janë në pyetje njerëz apo popuj ndaj të cilëve nuk ka ndonjë urrejtje apo ndjenjë hakmarrjeje.

Në veçanti, ky parim duhet të zë vend themelor në formësimin e ligjërimet fetar gjatë trajtimit të konflikteve ku janë të involvuar palë të cilat dallojnë me muslimanët në besim dhe nuk kanë të bëjnë me ta. Bile, edhe nëse ka një histori jo të mirë të raporteve me muslimanët e njërës apo të të dy palëve të involvuara në konflikt, kjo nuk mund të jetë shkak për të mos qenë i drejtë ndaj viktimës dhe për të mos e dënuar zullumqarin.

Do të ishte në kundërshtim me frymën e këtij ajeti dhe të mësimëve islame, jo vetëm që fjalori i ligjërimet predikues të mos e dënojë tiranin dhe të mos shprehë keqardhje me viktimën, por bile edhe të manifestojë shenja të shfryrjes me tragjedinë e të tjerëve.

PA MLLEF DHE FJALOR HAKMARRËS

Në dritën e këtij parimi duhet parë edhe vlerësimet për sulmin e Rusisë ndaj

Hulumtimet tregojnë se çdo ditë e më tepër kemi njerëz të vetmuar, të rinj dhe pleq të vetmuar. Pikërisht për këto dy kategori të njerëzve ka folur Muhamedi (a. s.), i cili në një hadith thotë: “Nuk është prej nesh ai që nuk i respekton të moshuarit dhe nuk i mëshiron të vegjëlit.”

Njeriu është qenie shoqërore dhe lidhja e tij emocionale me të tjerët e plotëson dhe e bën më të lumtur. Njeriu, duke u mbështetur te tjetri, e gjen qetësinë dhe përkrahjen. Sa më shumë që të aktivizohet dhe t’u bëjë mirë të tjerëve, aq më shumë ai i afrohet Zotit, Krijuesit, i Cili ka faljen dhe mëshirën e madhe.

Duke e kuptuar se jeta nuk ka kuptim pa bashkësinë, pa komunitetin, pa tjetrin, thuhet se gati çdo i katërti evropian merr pjesë aktive në ndonjë organizim vullnetar shoqëror. Gjithashtu, është vërtetuar shkencërisht se ka një lidhje të fortë mes dhurimit e ndihmës dhe kënaqësisë shpirtërore e shëndetit fizik. Sa më shumë që vizitojmë dhe ndihmojmë njëri-tjetrin, aq më shumë e forcojmë sistemin e imunitetit tonë shpirtëror dhe fizik.

I dërguari i Allahut na këshillon se ilaçi kundër vetmisë dhe izolimit është mbajtja e lidhjeve familjare dhe miqësore, me të cilët ndajmë bindjet, mjedisin ku jetojmë dhe ku veprojmë, duke i shtuar sa më shumë veprat e mira:

Ebu Hurejre (r. a.) përcjell se i dërguari i Allahut (a. s.) ka thënë: “Kush ia largon një besimtarin një brengë të kësaj bote, Allahu do t’ia largojë atij një brengë të Ditës së Kiametit. Kurse kush ia lehtëson ndonjë vështirësi atij që ka, Allahu do t’ia lehtësojë në këtë botë dhe në të amshueshmen. Kush ia mbulon të metat ndonjë muslimani, Allahu do t’ia mbulojë atij të metat në këtë botë dhe në tjetrën. Allahu i ndihmon robët të vet për aq kohë sa ky i ndihmon vëllait të vet.” (Imam Muslimi)

E, pa dyshim, këto nivele shpërbliimi dhe përkrahjeje hyjnore nuk mund të arrihen pa u përzier me njerëzit dhe pa e kaluar kohën me ta. Pajtohem: ndonjëherë njeriu ka nevojë për vetminë, por me të ai duhet të sillet si me ilaçin, të cilin e merr vetëm kur i duhet.

/14.10.2022, St. Gallen/

(Autori është Imam i Xhamisë El-Hidaje në Zvicër dhe Kryetar i KMSHZ/DAIGS)

Ukrainës. Agresori duhet të dënohet, megjithatë, kjo nuk nënkupton që palës viktimë t'i falen mëkatet ndaj palëve të tjera. Sjellja e lidershit të viktimës ndaj rasteve ku myslimanët janë viktimë, nuk e amnistion atë nga përgjegjësia morale dhe njerëzore, por, në të njëjtën kohë, nuk mund të shërbejë si alibi për të mos e dënuar zullumin e palëve të tjera mbi popullin e tij dhe as që të shfryhet mbi të mllefi dhe të përdoret fjalor hakmarrës në trajtimin e fatkeqësisë së popullit të tij.

-Kundërshtimi i zullumit: Islami e dënon çdo lloj zullumi ndaj njeriut, dhe me këtë rast Islami nuk bën dallim të njerëzve në bazë të besimit. Në një thënie që i dërguari i Allahut e ka përcjellë prej Allahut të Madhërishtëm, qëndron se ka thënë: "O robërit e Mi, Unë ia kam ndaluar vetes zullumin, dhe e kam bërë të ndaluar mes jush. Për atë, mos i bëni zullum njëri-tjetrit..."

Në dritën e këtij parimi, myslimanit duhet ta dënojë çdo zullumqar, pa marrë parasysh cilës fe i takon. Po ashtu, dënimi i zullumqarit nuk lidhet me dënimin e zullumit edhe nga ata mbi të cilët bëhet zullum, kur janë në pyetje myslimanët. Ky nuk është diskursi islam i dënimit të zullumit.

Është e vërtetë se myslimanët janë viktimë në shumë vende, dhe reagimi i botës nuk ka qenë i duhur, i shpejtë dhe serioz në dënimin e zullumit që është ushtruar dhe vazhdon të ushtrohet mbi ta, sikurse që është në rastin e Ukrainës apo në raste të tjera. Në disa vende me shumicë myslimane me dekada ushtrohet zullum mbi myslimanët, si nga agresioni nga jashtë, po ashtu edhe nga vetë qeveritë e vendeve përkatëse, si dhe nga lufta e brendshme sektare, megjithatë reagimi i institucioneve ndërkombëtare, i shoqatave joqeveritare për të drejtat e njeriut, nuk ka qenë në nivelin e duhur, sikur që shihet kjo në rastin e Ukrainës.

Bile, më e dhimbshme është sjellja e disa shteteve evropiane ndaj civilëve myslimanë të cilët kanë ikur nga vatrat e tyre për shkak të luftës. Megjithatë, kjo sjellje dhe këto standarde të dyfishta, nuk duhet të merren si shkak që mos të dënohet zullumi. Bile, duke e dënuar zullumin e zullumqarëve, mund që ta kthejmë në vëmendje edhe zullumin që bëhet ndaj myslimanëve në vende të ndryshme.

ERRËSIRA SUNDON JASHTË HEKURAVE

Nga Somer Shahade

Lexuesi zbulon se burgu, që duket si vend në romanin "Një sagë e vogël burgu", i shqiptarit Besnik Mustafaj, nuk është thjesht një vend. Romani, i botuar nga shtëpia botuese jordaneze "Al-Aan", me shpërndarje në mbarë botën arabe, përkthyer nga origjinali shqip prej Ibrahim Fadlullah, trajton ndryshimet e thella psikologjike, që shkakton burgu mbi të burgosurit, gardianin dhe familjet e tyre.

Romani ndahet në tre libra. Secili prej tyre tregon një aspekt nga jeta në burg. Romani zbulon botën e errët të burgut dhe, nëpërmjet zbërthimit të padrejtësive, bëhet edhe zbërthimi i njeriut, që ka krijuar burgu, në vend që të dalë andej njëri i ri dhe i shëruar. Romani nuk del jashtë realitetit të egër dhe po kështu atij nuk i mungon shpresa dhe optimizmi.

Në librin e parë: Bardhyl Huta rrefen historinë e babait të tij, Omer Huta. Është një tregim që ai e ka të lidhur me gjyshin, Oso Hutën, me kontradiktat midis të vërtetës së dukshme dhe të asaj që është e fshehur. Gjyshi, gjatë regjimit mbretëror, kishte qenë i dënuar politik. Omeri u rrit në dy periudha të ndryshme: njëra shkon deri në moshën dymbëdhjetëvjeçare. Kjo është një etapë, ku fantazia e tij krijon përfytyrimin për atë baba kreshnik, i cili ka në gjoks një zemër prej dragoi; të babait, me heroizmat dhe trimëritë e të cilit lavdërohen të tjerët. Ai është një burrë që i kundërvihet shtetit, megjithëse i vockël në krahasim me shtetin e fuqishëm. Ky përfytyrim për babanë kreshnik dhe të ndryshëm sa vjen e rritet në fantazinë e fëmijës, si një formë kompensimi për mungesën e babait.

Në krahasim me fëmijët e tjerë, që jetonin nën kujdesin dhe mbrojtjen e baballarëve të tyre, Omeri kishte një baba ndryshe. Ky ndryshim krijon krenarinë e fëmijës, megjithëse është i detyruar të jetojë si të ishte një bonjak. Kur Omeri


mësoi se babai i tij ishte në burg, iu ndez fantazia dhe vendosi që burgu të bëhet edhe fati i tij.

BURGU NUK ËSHTË VETËM KATËR MURE, POR EDHE ËNDËRRIME E MENDIME

Por, një ngjarje rutinë do ta shkatërronte fëmijën. Kur, bashkë me nënën, vizitoi në burg, babain e tij, Oso Hutën, në moshën dymbëdhjetëvjeçare ai zbuloi se i ati s'ishte siç e kishte përfytyruar, por një burrë i dobët dhe i pafuqishëm, i poshtëruar deri në thellësi të shpirtit. Osoja qan dhe përqafon djalin e tij, Omerin, i cili, nga ana e vet, ndjen neveri për babanë e tij të drobitur. I shpërthejnë lotët dhe ikën prej tij, për të paralajmëruar, vite më vonë, djalin e tij, Bardhylin se, nëse do binte në burg, ai nuk do të shkonte ta shihte atje.

Siç vepron fantazia në jetën e fëmijës, po kështu vepron ajo edhe tek i burgosuri, i cili, në librin e dytë të romanit, është vetë Bardhyli. Ai ra në burgun shqiptar pasi vendi u bë Republikë Popullore Socialiste. Bardhyli rikthen jetën e gjyshit të vet pas gjashtëdhjetë vjetëve. Pas njëmbëdhjetë muajsh brenda në burg, ai ka drojë të takojë gruan e tij, Lindën. Fantazia e tij seksuale përflaket kur mendon për një takim me gruan e tij të ligjshme. Por, dy paralajmërime: njëri prej shokut të tij në burg, që sheh se ai po shkon në takimin e premtuar dhe i thotë: "O i gëzuar! Mos u gëzo!" dhe tjetri, që i erdhi nga gardiani, i cili i tha: "Mbaje gozhdë në tru", ia vranë fantazinë.

Ëndrrat poetike të të burgosurit shndërrohen kështu në një lloj halucinacioni, që vërshon gjatë gjithë kohës së takimit me gruan e tij. Ai torturohet nga dyshimi se, bashkë me ta, nëpërmjet mikrofonëve të përgjimit, në dhomën e posaçme të takimeve intime brenda burgut, të jetë i pranishëm, është edhe polici, bartësi i uniformës ushtarake, gjë që e pengon të sillet normalisht me gruan e tij. Plus fri-



këra të tjera, që vërshonin me ngulm në trurin e tij, si ajo për Lindën, humbja e besimit në vetvete, si dhe ajo miza që i gumëzhinte vazhdimisht në vrimën e veshit. Të gjitha këto e shpartalluan afrimin e Bardhylit me gruan. Gjatë përcartjeve dhe rrethanave të tij pasqyrohet sa e madhe është dhuna, që aplikon shteti kundër armiqve të vet. Kjo e bën Bardhylin të mendojë se ajo dhomë takimesh ishte përgatitur për takimin e babait me gjyshin e tij dhe për takimin e atij vetë me gruan e tij. Por, ajo tashmë ua kalon pajisjeve të torturës në burg. Kjo, sepse i burgosuri e kupton dhimbjen që e ka pllakosur, duke shkatërruar, në mënyrë të pandreqshme, përfytyrimin e vjetër për të dashurit e tij.

Në librin e tretë të romanit "Një sagë e vogël burgu" ngjarjet zhvillohen jashtë tij. Për lexuesin bëhet e qartë se i gjithë romani shtjellohet rreth detyrës dhe përgjegjësisë. Shkrimtari tregon historinë e tre shembujve, që e japin këtë preambulë para botës. Kjo, sepse pas largimit të italianëve dhe në pritje të pushtimit të Shqipërisë nga gjermanët, organet e shtetit ishin inekzistente. Por, si gazetari, si gardiani dhe ushtaraku i dalë në pension, mbeten besnikë të përgjegjësive të tyre. Secili prej të treve është shembull i njeriut të cilin e burgosin përgjegjësitë e tij. Burgu nuk është vetëm në kështjellë, por edhe në veprimet që njerëzit kryejnë gjatë jetës së tyre.

SHPËRBERJA E EKSPERIENCËS SË BURGUT NUK DO TË THOTË SE NJERIU DEL PREJ TIJ I SHËRUAR

Linda tregon historinë e gjyshit të saj, Hiqmet Hidit, me qëllim që të kuptojë

kompleksin e nënës së saj për burgun, pasi ajo refuzoi martesën e vajzës së saj me Bardhylin. Ajo deshi ta martojë atë në një vend, ku s'kishte burg politik. Linda arrin te historia e gjyshit: Në kohën kur italianët largohen, të burgosurit ikin nga kalaja-burg, duke marrë me vete gardianët, me qëllim që t'i ndëshkonin për keqtrajtimin që u kishin bërë. Por, ata e lënë Hiqmet Hidit të lirë, sepse ai kishte qenë i mëshirshëm me ta.

Në pritje të udhëheqësve të rinj të Shqipërisë, gardiani Hidi mbledh gurë dhe i vendos nëpër buca. Për këtë ai konsiderohet i çmendur, që bën me turp gruan dhe vajzën e tij, nënën e Lindës. Kjo pas një thashethemi, sipas të cilit, ai do i arrestonte të dyja ato për të bërë një burg të vërtetë me njerëz të burgosur.

Në roman jepen shumë përshkrime rreth çasteve të fundit të Hiqmet Hidit në burg, para se t'i dorëzohej vendimi. Në vend të dhunës shtetërore, romani zbulon një lloj tjetër dhune: dhunën e njerëzve. Në pjesën e fundit jepet historia e një gazetari pa gazetë, e një luftëtari pa ushtri dhe e një gardiani të mbetur pa burg. Në këta shembuj, që jetojnë me një punë në boshllëk, rrjedh shakaja e njerëzve, pas së cilës fshihet poshtërsia e tyre. Në pritje të ardhjes së gjermanëve, përballë egërsisë së njerëzve dhe dhunës së tyre, që vijnë si pasojë e përvojave të këqija lidhur me aparatit shtetëror, mbeten pikëpyetjet e të çmendurit për përfundimin e diktaturës.

Nga errësira e burgut, vend i mbyllur, i cili përbën një laborator të pasur për çdo shkrimtar, Besnik Mustafaj transme-

ton pikëpyetjet për burgun, në mes të mureve të kalasë, te të gjitha llojet tjera të burgjeve, duke filluar nga përfytyrimet e personazheve për veten e tyre dhe për të tjerët e duke përfunduar te përfytyrimet e ndryshme rreth burgut që kanë të tjerët në mejdisin shoqëror, si dhe për arbitraritetin e tyre në fatin e personit. Ndërsa terrina e egër e burgut e merr errësirën e saj nga lidhjet që ka me mendimin dhe nga shkatërrimi që i bën presioni nga brenda.

*Somer Shahade, i lindur në Latakije, qytet kryesor në bregdetin sirian, më 1989, vlerësohet si njëri nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë së sotme arabe. Ai bëri emër qysh me romanin e parë "Fushat e misrit" (2016), për të cilin mori Çmimin El-Tajib Saleh në Hartum. Me romanin e dytë "Ndarje" (2019) mori Çmimin Nagib Mahfuz në Kajro. Artikulli u përkthye në shqip nga Sulejman Tomçini. "Hëna e Re" e ka të drejtën e botimit.

"Një sagë e vogël" arabisht

Nga jehona në shtypin arab për romanin "Një sagë e vogël" të Besnik Mustafajt, botuar në arabisht nga shtëpia botuese Al-Aan, me përkthim nga origjinali të Ibrahim Fadlullah-ut. Ky shkrim është botuar në suplementin kulturor të njëres nga gazetatat më të mëdha arabofone Al Araby, e cila del në Londër dhe shpërndahet në mbarë botën.




LIBRI I PARË TURQISHT

Siç bëhet e ditur, në Turqi është botuar libri “Midis krimeve dhe mirazheve” i Besnik Mustafajt. Që nga data 9 shtator, 2022, libri gjendet në librari. Ky është libri i parë që përkthehet në turqisht nga ky autor.

“Për mua si autor, hyrja në një gjuhë të re përbën një lajm veçanërisht të gëzueshëm. Me parë ky libër është botuar në Francë, në Itali dhe në Gjermani. Turqishtja është gjuha e katërt në të cilën përkthehet”, ka thënë shkrimtari.

Libri është botuar nga shtëpia e madhe botuese “Kirmizi Kedi” me seli në Stamboll.

Shpresojmë që libri të marrë vëmendjen në Turqi. (HeR/desk)



Pejgamberi Muhamed (Paqja dhe bekimet e të Plotfuqishmit qofshin mbi të) në vitin 1935 u nderua nga Gjykata Supreme e SHBA-ve, si një ndër ndikuesit më të mëdhenj në botë mbi ligjin. (F.19.10.2022, Baki Shala/në bashkëpunim)

SYNETIA NË FENË ISLAME

Koha më e përshtatshme për synetimin e fëmijëve është moshë mes adoleshencës dhe pubertetit. Në këtë drejtim ishte praktikë edhe tek osmanlinjtë. Fëmijët e Sulltanit (shehzadet) bëheshin synet në moshën e adoleshencës, e pastaj dërgoheshin në sanxhaqe. Megjithatë, disa mendojnë se synetia nuk duhet të prolongohet shumë pas lindjes, sepse kjo është më e dobishme në aspektin psikologjik për fëmijën, që ai të arrijë në moshën e adoleshencës pa këtë pengesë.



Nga Nebi Bozkurt

Tradita rreth synetisë (rrethprerjes) një normë e parashikuar në fetë qiellore, e bazuar në praktikën e Ibrahimit (a. s.), vazhdoi edhe në Islam. Në Tevrat thuhet se kur Ibrahimit (a. s.) ishte nëntëdhjetenëntëvjeçar dhe djali i tij, Ismaili, trembëdhjetëvjeçar, ata iu nënshtruan urdhrit hyjnor për syneti,ⁱ ndërsa sipas një thënie profetike ai në moshën tetëdhjetëvjeçare u bë synet me një mjet prerës, të quajtur kadumⁱⁱⁱ. Thuhet se kadum është një mjet prerës që përdoret në zdrukthëtarë. Gjithashtu, me emër të tillë njihet një vend në Siri^{iv}.

Kur e komenton ajetin 124 të sures “Bekare”^v, që flet për Ibrahimit (a. s.), që ishte caktuar si udhëheqës i njerëzve, atëherë kur Ibrahimit (a. s.) u testua me disa urdhra dhe i zbatoi me sukses ato, Ibn Abasi (r. a.) në mesin e urdhrave përmend pastërtinë, ku, në një farë forme^{vi}, bie edhe syneti. Pas Ibrahimit (a. s.), edhe hebrenjtë, si edhe arabët, e vazhduan traditën e trashëguar nga paraardhësit e tyre.

Në kohën e injorancës arabe edhe

gratë e zbatonin synetinë. Rregulli i synetisë për gra e kishte bazën te Haxherja, bashkëshortja e Ibrahimit (a. s.)^{vii}. Në ditët tona synetimi i fëmijëve meshkuj kuptohet si një çështje e rëndësishme shëndetësore për gruan dhe burrin dhe kjo praktikë filloi të përhapet edhe në shoqëritë e krishtera. Tradita rreth synetisë së vajzave është përhapur në një pjesë të Arabisë, të Egjiptit, në Afrikën Qendrore dhe Lindore, si edhe në Azinë Juglindore - qoftë në mesin e myslimanëve, të krishterëve, ose në mesin e shoqërive të feve të tjera.

Sot, megjithëse në vendet perëndimore kundërshtohet zbatimi i synetisë për shkak të rasteve të keqzbatuara, që ndonjëherë përfundojnë me vdekje, megjithatë ka studiues dhe shkencëtarë që e mbështesin synetinë - qoftë për shkak të shëndetit, ose për shkak të kënaqësisë intime. Pikëpamjet e juristëve bashkëkohorë myslimanë mbi këtë temë ndryshojnë paralisht me këto diskurse.

Synetia, sipas traditës së profetit Muhamed, llogaritet në mesin e punëve të bëra në përputhje me natyrën primordiale (fitrah)^{viii}. Kjo fjalë (fitrah), ashtu siç i

jepet kuptimi i “adetit dhe sunnetit”, është interpretuar edhe si mosdëmtim i krijimit të formës së parë të njeriut me heqjen e lëkurës së lafshës, por që konsiderohet nga veprimet e mira, pas të cilave njerëzia garon, siç janë prerja e thonjve dhe pastrimi i qimeve në vendet sekrete dhe nën sqetulla. Ashtu siç e urdhëroi Muhamedi (a. s.) personin i cili dëshironte ta pranojë fenë islame, që së pari të bëhet synet^{ix}, në bazë të traditës profetike. Kjo vepër për burrat është sunnet, kurse për gratë konsiderohet nder dhe dëlirësi.^x Madje, edhe nëse i arrin të tetëdhjetat, myslimani nuk guxon të mbetet i pabërë synet^{xi}, megjithëse ka debate për ruajtjen e shëndetit nga efektet e synetisë. Nga fjalët e sahabëve dhe të tabiinëve, kuptohet se personi i pabërë synet nuk do të mund të bëjë tavaf Qabenë, nuk do t’i pranohet namazi, ndërsa nëse ai person ka therur kafshë, kafshës nuk i hahet mishi.^{xii} Kjo flet për rëndësinë e veçantë të kësaj dispozite në kulturën islame. Edhe pse është e njohur për ne se i dërguari i Zotit ka lindur i bërë synet, megjithatë thuhet se Abdylmutalibi, gjyshi i Muhamedit (a. s.), ka

porositur që ai të bëhet synet.^{xiii}

Nga ana e juristëve myslimanë, në lidhje me punën e synetisë, janë bërë vlerësime dhe konceptime rreth traditave të shoqërive myslimane, me mendime dhe konkluzione të ndryshme. Sipas shkollës juridike hanefite dhe malikite, vendimi (hukmi) i synetisë për meshkuj është sunnet (traditë profetike), kurse sipas asaj shafiite dhe hambelite është detyrim (vaxhib). Hanefijtë e konsiderojnë në rangun e njëjtë si ezani, që është një simbolikë e Islamit, që nuk lejohet të braktiset në masë. Transmetohet nga Imam Maliku: “Personi që nuk është i bërë synet, nuk mund të bëhet imam dhe nuk i pranohet dëshmia.” Shikuar nga ky këndvështrim, Hasan Basriu thotë: “Nuk është hulumtuar mjaftueshëm çështja e personave nga popujt e ndryshëm që vinin tek i dërguari i Allahut për ta pranuar fenë islame se a ishin të bërë synet a jo.” Ahmed b. Hanbeli është i mendimit se “nëse një mysliman është në moshë të shtyrë, për të mos e dëmtuar shëndetin e tij, mund të mos e bëjë synetinë”.^{xiv} Sipas hanefijve, synetia e femrave është nder dhe dëlirësi; sipas malikijve është vepër e pëlqyer (mendub), kurse sipas shafiijve dhe hanbelijve është detyrim (vaxhib).

Juristët myslimanë janë të mendimit se ceremonia e synetisë së fëmijëve me motive fetare dhe e zbukuruar, ashtu, në të ardhmen do të luajë një rol pozitiv në kujtesën e fëmijës, duke pasur parasysh traditën profetike për mësimin e fëmijës në namaz, ashtu që koha më e përshtatshme për synetimin e fëmijëve është mosha mes adoleshencës dhe pubertetit. Në këtë drejtim ishte praktikë edhe tek osmanlinjtë. Fëmijët e Sulltanit (shehzadet) bëheshin synet në moshën e adoleshencës, e pastaj dërgoheshin në sanxhaqe. Megjithatë, disa mendojnë se synetia nuk duhet të prolongohet shumë pas lindjes, sepse kjo është më e dobishme në aspektin psikologjik për fëmijën, që ai të arrijë në moshën e adoleshencës pa këtë pengesë.

Shafiitë bazohen në një transmetim se i dërguari i Allahut, Muhamedi (a. s.), i ka bërë synet nipat e tij, Hasanin dhe Hise-nin, në ditën e shtatë të lindjes,^{xv} andaj ata e shohin synetinë në ditën e shtatë të lindjes si vepër të pëlqyeshme (mustehap). Tri shkollat e tjera nuk e shohin transmetimin e këtillë të fuqishëm dhe sipas tyre kjo praktikë i ngjason hebraizmit, andaj e llogarisin si vepër të urreyer (mekruh). Sipas juristëve myslimanë, që e cilësojnë synetin si detyrim (vaxhib), gjykimi për detyrim fillon me pubertetin. Nga ana tjetër, personi që do ta kryejë operacionin e

synetisë duhet të jenë një mjek kirurg i kualifikuar, ose person me përvojë në syneti. Për këtë çështje të ndjeshme, ashtu siç ka paralajmëruar i dërguari i Allahut për personin që e kryen synetinë, transmetimet janë të llojllojshme.^{xvi} Po ashtu edhe Omeri (r. a.) thotë se nëse personi që e kryen synetinë i shkakton dëm fëmijës gjatë këtij intervenimi, ai duhet të paguajë kompensim për të.^{xvii} Ndërkaq, në rast se shkakton vdekjen e fëmijës nga synetia, ai duhet ta paguajë gjakun^{xviii} dhe të burgoset.

Argëtimi dhe zbavitja me rastin e dasmës së synetit është një traditë që mbështetet në kohërat e hershme. Tek arabët, me rastin e synetisë, zbavitja quhej “aziira”. Në këso raste kishte muzikë dhe luheshin lojëra. Edhe pse nuk dihet për kohën e të dërguarit të Allahut për raste të këtilla, ka transmetime se në kohën e sahabëve rastisën dasma të synetisë. Në kohën e kalifit Omer është dëgjuar zëri i dajreve dhe i këngëve dhe ai ka pyetur: “a është kurorëzim, apo syneti?”, duke aluduar se po të ishte njëra nga këto, ai nuk do të ndërhynte.

Ibni Abasi, me rastin e synetisë së djalit të tij, kishte marrë valltar dhe e kishte paguar atë.^{xix} Në periudhën e tabiinëve kishte nga ata artistë që me këngët e tyre kishin fituar shumë famë.^{xx} Juristët që erdhën pas, po edhe katër imamët e shkollave, nuk dolën kundër një tradite të këtillë. Bil-bile prezencën në këtë aheng e llogaritën si vepër të mirë, me kusht që në këto ditë feste dhe në këto ahengje të mos shkelen rregullat e fesë. Në shoqërinë turke qysh moti synetisë i është kushtuar shumë kujdes, andaj dasma e synetisë është shndërruar në një traditë madhore. Edhe tek udhëheqja osmane, kur bëheshin synet fëmijët e sulltanëve, organizohej apostafat dasmë shumë madhështore.

/Burimi: “TDV İslâm Ansiklopedisi”, vol. 38, İstanbul, 2010, fq. 157-159/

Përktheu nga turqishtja: Murtezan Idrizi

Bibliografia:
Abdürrezzâk es-San‘ânî, *el-Muşannef*, IX, 470.

A. J. Wensinck, “*Khitân*”, *a.e.*, V, 20-22.

Ahmed b. Hüseyin el-Beyhakî, *es-Sünenü'l-kübrâ* (nşr. M. Abdülkâdir Atâ), Beyrut 1414/1994, VIII, 324-326.

Buhârî, “*Bed’ü'l-vaḥy*”, 7, “*İsti’zân*”, 51, “*Libâs*”, 61, 62.

Câhiz, *Kitâbü'l-Ḥayevân*, VII, 27.

Fâkihî, *Aḥbâru Mekke* (nşr. Abdülme-

lik b. Abdullah b. Dehîş), Mekke 1407/1986-87, I, 21.

Fuat Günel, “İbn Süreyc, Ubeydul-lah”, *DİA*, XX, 366.

G. Posener, *A Dictionary of Egyptian Civilization*, London 1962, s. 45-46.

Haifaa Jawad, “Female Circumcision: Cultural Necessity or Religious Obligation?”, *Proceeding of Annual Conference of the British Society for Middle Eastern Studies 12-14 July 1994, Culture: Unity and Diversity* (yayımlanmamış tebliğ), The University of Manchester, s. 324-341.

Hâkim, *el-Müstedrek* (Atâ), III, 603.

Herodotos, *Tarih* (trc. Perihan Kuturman), İstanbul 1973, s. 85.

“*Ḥitân*”, *Mv.F*, XIX, 26-31.

“*Khafd* (or *Khifad*)”, *EP* (İng.), IV, 913-914.

İbn Ebû Şeybe, *el-Muşannef* (nşr. Kemâl Yûsuf el-Hût), Beyrut 1409/1989, V, 420, 421.

İbn Kayyim el-Cevziyye, *Tuhfetü'l-mevdûd bi-ahkâmi'l-mevlûd* (nşr. Abdül-mün'im el-Ânî), Beyrut 1403/1983, s. 106, 107, 108-111, 112, 113, 114, 140-144.

Müsned, V, 75.

Nebi Bozkurt, *Hadiste Folklor Eğlence*, İstanbul 1997, s. 67-69.

Nebi Bozkurt “*Sünnet*”, *İslâm'da İnanç, İbadet ve Günlük Yaşayış Ansiklopedisi* (ed. İbrahim Kâfi Dönmez), İstanbul 2006, IV, 1842-1843.

Sâmî ez-Zîb, *Ḥitânü'z-zükûr ve'l-inâş inde'l-yehûd ve'l-mesîhiyyîn ve'l-müslimîn*, Beyrut 2000, s. 45, 275, 369, 399.

Taberî, *Câmi'u'l-beyân*, I, 571.

¹ Prerja e lafshës së organit gjenital të fëmijës.

² Tekvîn, 17/10-14, 23-27.

³ Buhârî, “*Enbiyâ*”, 11; në një transmetim tjetër shihni: İbn Kayyim el-Cevziyye, s. 108-110.

⁴ Ahmed b. Hüseyin el-Beyhakî, VIII, 326;

İbn Kayyim el-Cevziyye, s. 107.

⁵ El-Bakara 2/124.

⁶ Taberî, I, 571.

⁷ Câhiz, VII, 27.

⁸ Buhârî, “*Libâs*”, 63, 64; Müslim, “*Tahâret*”, 49, 50.

⁹ Ebû Dâvûd, “*Tahâret*”, 129.

¹⁰ *Müsned*, V, 75.

¹¹ Ahmed b. Hüseyin el-Beyhakî, VIII, 324.

¹² Vepra e lartpërmendur, VIII, 325-326.

¹³ İbn Kayyim el-Cevziyye, s. 140-144.

¹⁴ İbn Kayyim el-Cevziyye, s. 113.

¹⁵ Ahmed b. Hüseyin el-Beyhakî, VIII, 324.

¹⁶ Shih shembullin: Hâkim, III, 603.

¹⁷ Abdürrezzâk es-San‘ânî, IX, 470.

¹⁸ İbn Ebû Şeybe, V, 420.

¹⁹ Fâkihî, I, 21.

²⁰ Shih, për shembull: *DİA*, XX, 366.

MENDIME TË NDRYSHME NGA DIJETARËT

Ka thënë Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi vesel-lem) në hadithin të cilin e transmeton Buhariu, nga Abdullah ibni Amr (r. a.): “Transmetoni (komunikoni) nga unë edhe nëse është një ajet (verset). Tregoni nga beni israilët, sepse nuk ka vështirësi (diçka të keqe). Kush gënjen ndaj meje (pretendon dhe ma përshkruan atë, që në të vërtetë unë nuk e kam thënë), ai le ta përgatit vendin e tij nga zjarri.”

Shkruan: Melek Bislimi



Medhhebi tretë (shafi'i): Dijetarët e këtij medhhebi janë të mendimit se, nuk lejohet të veprohet me hadith të dobët në asnjë mënyrë; as në veprat e mira, as në dispozitat.¹

Në literaturën e shkencës së hadithit vërehet dhe haset se një numër i konsiderueshëm i dijetarëve të kësaj shkence dhe shkencave të tjera nuk lejojnë të veprohet me hadithin daif. Ndër dijetarët të cilëve iu përshkruhet (*thuhet se*; ar. *junseb ilajhim* يُنسب إليهم) që nuk pranojnë të veprohet me hadith të dobët janë:

Jahja İbni Meiiin يحيى بن معين .

Kadi Ebu Bekr ibni el-Arabi أبو بكر القاضي بن العربي.

İbni Hazm ابن حزم .

İmam Buhari الامام البخاري.

İmam Muslimi الامام مسلم .

İmam Ahmedi الامام أحمد .

Ebu Shame Makdisiz أبو شامة المقدسي .

Shevkani الشوكاني.

Ebu Hatim أبو حاتم.

Ebu Zurate Razi أبو زرعة الرازي .

İbni Ebi Hatim ابن أبي حاتم .

İbni Hibban ابن حبان.

Ebu Sulejman Hattabi سليمان الخطابي .

أبو .

İbni Tejmijje ابن تيمية .

Devvaniz الدواني.

Sadik Hasen Han صديق حسن خان .

Ahmed Muhamed Shakir أحمد محمد شاكير .

Albani (Muhamed Nasiruddin) لباني (محمد ناصر الدين).

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Shejh Muhamed Tahir Xhezairi الشيخ محمد طاهر الجزائري .

Mirëpo, disa dijetarë bashkëkohorë janë të mendimit se dijetarët e mëhershëm të kësaj shkence, siç janë: Jahja Ibni Meinin, Imam Buhari, Imam Muslimi, Imam Ibni Tejmije, Kadi Ebu Bekr ibni el-Arabij dhe të tjerë, janë të mendimit se lejohet të veprohet me hadith daif. Këtë e vërteton fakti se nuk ekziston ndonjë tekst i qartë nga ana e tyre, përmes të cilit ata kanë shënuar qëndrimin e tyre se nuk lejohet të vepruarit me hadith daif.²

Ndërkaq, dijetarët e mëvonshëm dhe bashkëkohorë në lidhje me këtë çështje shprehën në mënyrë të qartë se nuk lejohet të vepruarit me hadithin daif. Ndër këta dijetarë janë Imam Shevkani, Sadik Hasen Hani, Ahmed Muhamed Shakiri, Shejh Tahir Xhezairi dhe Nasiruddin Albani.

Në vazhdim do të shënojmë qëndrimin e disa dijetarëve në lidhje me këtë çështje, pastaj do të shënojmë qëndrimin e dijetarëve që lejojnë të vepruarit me hadithin daif, respektivisht ata që demantojnë qëndrimin dhe mendimin e atyre që ndalojnë të vepruarit me hadith daif.

1. Imam Jahja ibni Meinin **الامام يحيى بن معين**. I përshkruhet këtij dijetari se ky nuk lejon të veprohet me hadithin daif. Për qëndrimin e tij dijetarët bazohen në veprën “Ujunul etheri **الاثريعيون**” të autorit Ibni Sejjidin-nas, i cili shënon se Jahja ibni Meinin ka thënë: “Nuk dëshiroj të argumentoj me të (hadithin daif) në farzet (obligimet).³ ما أحب أن أحتج به في الفرائض

Demanti i këtij mendimi: Dijetarët thonë se nga shprehja e Ibni Meinit bëhet e qartë se ai e pranon hadithin daif në lidhje me veprat e mira, sepse shprehja e tij “*nuk dëshiroj të argumentoj me të (hadithin daif) në farzet (obligimet)*” bën të qartë se ai bën dallimin mes dispozitave të shariatit dhe jodispozitave. Sepse, mefhumul muhalefeti (المخالفة) është argument te njerëzit.⁴ Sepse, kjo është sikur Ibni Meini të ketë thënë: Përveç farzeve, e pranoj për argument.⁵

Ajo që e vërteton se Ibni Meini lejon të vepruarit me hadithin daif, janë thëniet dhe tekstet e shumta të tij, si për shembull: ai është prononcuar shumë herë dhe në lidhje me shumë burra (transmetues). Sa për ilustrim do të shënojmë atë që e ka përmendur Abbas Durriji në veprën e tij “Tarihud-duri **تاريخ الدوري**” kur shprehet në lidhje me Zijad ibni Abdulla Bukkai: “Mjafton, nuk është edhe aq, nga ai kam shënuar në lidhje me luftërat.”⁶

2. Imam Ahmedi **أحمدالامام** Këtij Imami i përshkruhet se ndalon të vepruarit me hadith daif.

Demanti: Dijetarët vërtetojnë se Imam Ahmedi ka lejuar të vepruarit me hadith daif. Këtë e mbështesin përmes dy mënyrave:

Sepse ai lejon të veprohet në veprat e mira (ar. fedailul e’ mali). Këtë e vërtetojnë shumë çështje, si për shembull ajo që ka transmetuar Ibni Kajjimi në veprën e tij “Zadul meadi” në lidhje me Hixhamen (lëshimin e gjakut) ditën e shtunë dhe të mërkurë.⁷

Sepse ai i jep përparësi të vepruarit me hadith daif ndaj mendimit të burrave (dijetarëve) dhe analogjisë (logjikës). Këtë e vërtetojnë thëniet dhe tekstet e shumë dijetarëve të medhhebit hanbeli.

Këtë e vërteton vetë Imam Ahmedi, kur në një rast ai pyetet se nëse një njeri jeton (qëndron, banon) në ndonjë vend (shtet), ndërsa në të gjenden dijetarë të logjikës dhe dijetarë të hadithit, të cilët nuk mbajnë mend dhe nuk kanë njohuri për hadithin daif, e as (nuk kanë njohuri) për senedin e fortë, cili prej tyre duhet të pyetet? Ka thënë: Pyeten dijetarët e hadithit dhe nuk pyeten dijetarët e logjikës, sepse i dobëti (transmetuesi) në hadith është më i mirë sesa mendimi i Ebu Hanifes.⁸

عن الامام نفسه: أن رجلاً يقيم في بلد، فيه من أصحاب الرأي، و من أصحاب الحديث، لا يحفظون ولا يعرفون الحديث الضعيف، ولا الإسناد القوي، فلمن يسأل، قال: يسأل أصحاب الحديث، ولا يسأل أصحاب الرأي، ضعيف الحديث خير من رأي أبي حنيفة.

“IMAM BUHARIU NUK E PRANON DAIFIN”

3. Imam Buhari **البخاريالامام**. Imam Kevtheriu, Imam Xhemaluddin Kasimi dhe Albani janë të mendimit se Imam Buhariu nuk pranon të vepruarit me hadith daif.

Demanti: Por, ajo që e vërteton se Buhariu pranon hadithin daif, është ajo që kemi shënuar më parë, respektivisht kur kemi shënuar emrat e dijetarëve që pranojnë të vepruarit me hadithin daif.

Po ashtu, fakt tjetër dhe argument shumë i fuqishëm është se vetë Albani në veprën e Imam Buhariut “Edebul mufred **الادب المفرد**” gjatë recensimit (ar. tehkik) ka konstatuar se në atë vepër gjenden 215 hadithe dhe thënie të dobëta të sahabëve.

Kjo vepër e Imam Buhariut përmban 1.322 hadithe, të ndara në 644 kapituj. Shumica e haditheve janë të sakta (sahih), por në të gjenden edhe hadithe

josahih. Ndërkaq, shkaku që Buhariu në këtë libër nuk iu ka përbajtur kushteve që i ka kushtëzuar në sahihun e tij, është se kjo vepër ka të bëjë me edukatën dhe veprat e mira, por jo me dispozitat. Prandaj, nga kjo kuptohet qartë se Imami në veprat e mira e pranon hadithin daif.

4. Imam Muslimi **الامام مسلم**. Sipas dijetarëve, nuk ekziston dhe nuk është transmetuar ndonjë thënie gojore apo me shkrim në mënyrë të qartë dhe deklarative nga Imam Muslimi që e vërteton apo e mohon të vepruarit, respektivisht të mosvepruarit, me hadith daif. Por, ai që ia përshkruan këtë qëndrim Imam Muslimit është Shejh Xhemaluddin Kasimi, sipas të cilit edhe Imam Muslimi ka të njëjtin qëndrim sikur Imam Buhariu. Dhe, para këtij është edhe Imam Hafidh ibni Rexheb Hanbelij, i cili thotë se Imam Muslimi nuk pranon hadithin daif, i cili në veprën e tij “Sherhul ilet **شرح العلة**” thotë: Ajo që kuptohet në shikim të parë (formal, ar. dhahiren) nga ajo që ka përmendur në hyrjen e librit të tij, nënkuptohet se nuk transmetohen hadithet e ngjalljes së dëshirës për veprim dhe tërheqjes frikë, vetëm nga të cilët transmetohen (hadithet) e dispozitave.⁹

ظاهر ما ذكره مسلم في مقدمة كتابه، يقتضي أنه لا تُروى أحاديث الترغيب والترهيب، إلا عن ثروى عنه الأحكام.

Demanti: Mirëpo, disa dijetarë janë të mendimit se edhe Imam Muslimi është i mendimit se lejohet të vepruarit me hadith daif.¹⁰ Qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje e kemi shënuar më parë, kur kemi shënuar emrat e atyre dijetarëve që lejojnë të vepruarit me këtë lloj të hadithit.

Megjithatë, mund të përfundojmë se dijetarët në lidhje me Imam Buhariun dhe Imam Muslimin ndajnë dy mendime - disa janë të mendimit se ata nuk pranojnë hadithin daif, ndërsa disa të tjerë janë të mendimit se ata pranojnë hadithin daif dhe secili grup qëndrimin e tyre e bazojnë në argumente. Allahu e di më së miri.

5. Kadi Imam Ebu Bekr ibni el-Arabij **القاضي أبو بكر بن العربي**. Dijetarët thonë se qëndrimi i Ibni el-Arabijit mund të mësohet në disa libra të shkencave të hadithit. Sa për ilustrim do të shënojmë vetëm disa nga ato vepra ku është shënuar mendimi i këtij dijetari.

Shënohet në veprën “Kitabu Zerkeshij Ala ibni Salah **كتاب الزركشي**

على ابن الصلاح, në të cilin transmetohet se Ibni el-Arabij ka thënë: Vërtet me hadithin daif, në asnjë mënyrë nuk veprohet **إن الضعيف لا يُعمل به مطلقاً**.

Gjatë komentimit në mënyrë të shkurtër të “Muvetit **الموطأ**” të Imam Malikut, vepër kjo e cila quhet “El-Kabes **القيس**”, kur flet për *sutren* (sutre në jurisprudencën islame do të thotë: sendin që vendon falësi i namazit para vetes, si shkop, apo diçka tjetër, për të penguar kalimtarët të kalojnë mes tij dhe sendit të venduar), ai thotë se për këtë ekzistojnë disa hadithe. Ndër ato hadithe është edhe hadithi që e transmeton Ebu Hurejreja (r. a.), në të cilin Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi vesel-lem) ka thënë: “*Nëse dikush prej jush falet, le të vë para vetes sutren, që mos ta lejojë dikë të kalojë para tij.*” Pastaj, thotë Ibni el-Arabij, disa dijetarë veprojnë sipas këtij hadithi. Në krye të tyre është Imam Ahmedi. Pastaj thotë: Ky hadith nëse do të ishte sahih, ne do të thoshim (vepronim) me të, porse ky është me të meta (ar. ma’lul, i dobët), prandaj nuk ka ndonjë kuptim përcaktimi (vënia e sendit) gjatë tij (faljes së manazit).¹¹

Po ashtu, ai gjatë komentimit të zgjeruar të “Muvetait **الموطأ**” të Imam Malikut, e cila quhet “El-Mesalik fi sherhi muvata Malik **شرح موطأ مالك**” thotë: Mos u merrni (mos u preokuponi) me hadithin me asgjë, përveç me hadithin sahih (të saktë).¹² لا تشتغلوا من الحديث بشيء، إلا بالصحيح منه

Ngjashëm me këtë thotë edhe në veprën e tij “Ehkamul Kur’ani **القرآنأحكام**”: Mos u merrni me hadithet që nuk kanë sened (zinxhir) të shëndoshë (sahih).¹³ لا تشتغلوا من الأحاديث بما لم يصح سنده.

Demanti: Mirëpo, nga thëniet e tij në veprat tjera kuptohet se ai e pranon të vepruarit me hadithin daif. Sa për ilustrim do të shënojmë disa nga prononcimet e tij:

TRANSMETIMI I HADITHEVE TË DOBËTA NË DEVOTSHMËRI

Në veprën e tij “Aridatul ehvedhi **الاحادي عارضة**”, derisa flet në lidhje me Imam Harith Muhasebij (v. 243 H), të cilin Ibni Haxheri e ka cilësuar si një nga dijetarët e hadithit dhe të logjikës (apologjetikës), në lidhje me këtë person Ibni el-Arabij thotë: Ajo që mendoj unë në lidhje me atë (Allahu e di më së miri) është ashtu si kemi transmetuar nga Ahmed ibni Hanbeli, i cili lejon transmetimin e haditheve të lehta (të dobëta) në devotshmëri. Allahu



goftë i kënaqur me Buhariun, i cili nuk e pa (të udhës, të arsyeshme) që zemra dhe feja të lidhen vetëm me (hadith) sahih dhe ne kështu themi. Porse, nëse ne anojmë nga medhhebi i Ahmedit, atëherë lidhja me hadith të lehtë (të dobët) nuk do të ishte përveç në këshillat (ar. vaidh), përmes të cilave zbuten zemrat, kurse në çështje bazë, nuk mundet përmes tyre (haditheve daife).

Gjithashtu, në komentimin e Tirmidhiut, gjatë shpjegimit të hadithit në lidhje me teshtimën (teshtitjen), për të cilën hadithi thotë “Atij që teshtin i kthehet tri herë العاطس ثلاثاً يُشمتُ”, në lidhje me këtë hadith ai thotë se ky hadith është *garib* dhe senedi i tij është i panjohur (ar. seneduhu maxhhul). Pastaj Ibni el-Arabiji thotë se, edhe pse senedi i tij është mexhhuë, porse është mustehab të vepohet me të, sepse ajo është lutje për të mirë, është afrim për kuvendarin (për atë që është së bashku në mexhliis) dhe afrim ndaj tij (kuvendarit).¹⁴

حديث غريب، و إسناده مجهول، (قال ابن العربي) و هو و إن كان مجهولاً ، فإنه يُستحب العمل به، لأنه دعاء بخير، و صلةً للجليس، و تودد له.

Po ashtu, shënohet në veprën “Tenzih sheria تنزيه الشريعة” se Ebu Bekr ibni el-Arabiji në veprën e tij “Meraki zulfa مراقي الزلفى” ka thënë: Është e urryer të shikuarit; edhe unë them (jam i këtij mendimi), sepse lajmi (transmetimi, informimi) edhe nëse nuk vërteton urrejtin, porse transmetimi (informimi) i dobët është më prioritar (apriori) te dijetarët sesa mendimi (i dijetarëve) dhe analogjia (kijasi).¹⁵

6. Imam Ibni Tejmije الامام ابن تيمية I përshkruhet Imam Ibni Tejmijes se ai ndalon të vepuarit me hadith daif.

Demanti: Mirëpo, dijetarët eminentë thonë se Ibni Tejmije lejon të vepuarit me hadith daif, për faktin se veprat e tij e vërtetojnë një qëndrim të tillë, respektivisht përmes veprave të tij kuptohet se ai lejon.

Sa për ilustrim do të shënojmë disa thënie të tij, ashtu siç janë shënuar në veprën e tij “Mexhmu-ul fetave مجموع الفتاوى 18/ 65-68. Ndër tjera ai thotë:

Thënia e Ahmed ibni Hanbelit se nëse vjen (është në pyetje) hallalli (e lejuara) dhe harami (e ndaluara), ne jemi të ashpër (rigoroz) në zinxhirët (senedet e haditheve). Ndërkaq, nëse vjen në lidhje me ngjalljen e dëshirës për veprim (ar. tergib) dhe tërheqjen

frikë (ar. terhib), ne jemi tolerantë në zinxhirë (të haditheve). Po ashtu, ajo që dijetarët kanë lejuar të vepuarit me hadithin daif në veprat e mira (ar. fedailul e’ mali), nuk do të thotë se mustehabi vërtetohet me atë hadith me të cilin nuk argumentohet, sepse mustehabi është dispozitë ligjore (e sheriatit), prandaj ajo nuk vërtetohet përpos me argument legjitim (nga sheriatit). Dhe ai që informon (tregon, vërteton) në emër të Allahut se Ai (Allahu xh. sh.) dëshiron (don) ndonjë vepër prej veprave pa ndonjë argument legjitim (të sheriatit), vërtet ai ka ligjësuar (ka vënë) në fe atë që atij Allahu nuk ia ka lejuar, ashtu sikur të vërtetojë (të ligjësojë) obligimin apo ndalimin. Mu për këtë dijetarët mes vete kanë kundërthënie në lidhje me mustehabin ashtu siç kanë kundërthënie në çështjet tjera. Bile, kjo është baza e fesë legjitime.

Por, qëllimi i tyre me atë (që ka thënë) është se vepra duhet të jetë në bazë të asaj që është vërtetuar se atë e do Allahu, apo prej atyre (veprave) që i urren Allahu (që janë të vërtetuara për mes tekstit - argumenti tekstual) apo konsensusit (ixhmait), siç është leximi i Kuranit, tesbihi, lutja, sadakaja, lirimi (i robit), sjellja e mirë ndaj njerëzve, të urryerit të gënjeshtres, tradhtia dhe ngjashëm me këto.

Prandaj, nëse transmetohet ndonjë hadith në lidhje me vlerën e disa veprave mustehabbe (të preferuara) dhe shpërblimin e tyre (sevapin) dhe (transmetohen hadithe) në lidhje me urrejtin e disa veprave dhe ndëshkimin e tyre: sasia e shpërblimit, e ndëshkimit dhe llojet e tyre (në lidhje me këto) nëse transmetohet ndonjë hadith, që ne nuk e dimë se ai është hadith mevdu (i trilluar, i vënë, apokrif): (hadithi i tillë) lejohet transmetimi i tij dhe (lejohet) të vepuarit me të. Kjo do të thotë (ka kuptimin) se: shpirti (njeriu, personi) shpreson shpërblimin e tillë apo frikësohet nga ndëshkimi i tillë. Si shembulli i një njeriu (personi) që e di se tregtia është fitimprurëse, porse është informuar se në tregti ka shumë fitim të madh; ky person nëse i beson kësaj (se ka shumë fitim të madh), kjo është e dobishme për të, e nëse nuk i beson dhe e përgënjeshtrohet, atij (mosbesimi) nuk do t’i bëjë dëm. Ngjashëm me këto janë edhe: ngjallja e dëshirës për veprim dhe tërheqje frikë përmes *israilijateve* (tregimeve në lidhje me *beni israilët*), ëndrrat, fjalët e të parëve (selefeve) dhe

djetarëve, ngjarjet dhe ndodhje që ju kanë ndodhur dijetarëve dhe ngjashëm me ato, gjëra këto që thjesht përmes këtyre nuk mund të vërtetohet ndonjë dispozitë e sheriatit, porse këto mund të përmenden në lidhje me ngjalljen e dëshirës për veprim dhe tërheqjes frikë, për shpresim dhe frikësim.

ARGUMENTET E SHERIATIT

Ajo që është e ditur dhe e kuptuar mirësia apo keqësia e saj përmes argumenteve të sheriatit, prej gjësë së tillë ka dobi dhe nuk ka dëm. Pavarësisht se në vetë çështjen gjendet e vërteta (hakk), apo e kota (e pavërteta); nëse dihet dhe kuptohet se ajo është e kotë e trilluar, nuk lejohet që ajo të merret në konsideratë, sepse gënjeshtria nuk bën asnjë dobi dhe të mirë. Por, nëse vërtetohet se ajo është sahih (e saktë), përmes saj vërtetohen dispozitat, por nëse (transmetimi) jep mundësinë për dy çështjet, (hadithi i tillë) transmetohet, sepse mund të jetë i besueshëm dhe për faktin se nuk ka ndonjë dëm nëse e përgënjeshtrojmë atë. Kurse në lidhje me atë që është shprehur Imam Ahmedi se nëse vjen në lidhje me ngjalljen e dëshirës për veprim (ar. tergib) dhe tërheqjen frikë (ar. terhib), ne jemi tolerantë në zinxhirët (e haditheve). Do të thotë (ka kuptimin) se ai ka thënë: ne transmetojmë në lidhje me atë me zinxhir (senede) edhe nëse transmetuesit nuk janë prej të besueshmëve (ar. thikat), të cilët merren për argument.

Gjithashtu, është edhe thënia e atyre që kanë thënë se vepohet me të (hadithin daif) në veprat e mira. Vërtet vepohet me të, kur veprat e tilla janë prej veprave të mira, siç janë: (leximi) i Kuranit, dhikri (të përmendurit e Allahut xh. sh.) dhe të larguarit nga ato (vepra) që janë të urryera.

Ngjashëm me këto është thënia e Pejgamberit (sal-lall-llahu alejhi vesellem) në hadithin të cilin e transmeton Buhariu, nga Abdullah ibni Amr (r. a.), i cili ka thënë: “*Transmetoni* (komunikoni) *nga unë edhe nëse është një ajet* (verset). *Tregoni* nga *beni israilët, sepse nuk ka vështirësi* (diçka të keqe). *Kush gënjen ndaj meje* (pretendon dhe ma përshkruan atë, që në të vërtetë unë nuk e kam thënë atë), *ai le ta përgatit vendin e tij nga zjarri*.” Me thënien e të dërguarit të Allahut (sal-lall-llahu alejhi vesellem) në hadithin sahih (të saktë): “*Nëse Ihtarët e Librit*

(ehulul kitabi) *ju tregojnë diçka, ju atyre as mos u besoni, por as mos i përgënjeshtrooni*.” Kështu që, lejoi të bisedohet (flitet) për ata, edhe pse ndaloj që atyre t’u besohet apo të përgënjeshtrohen. Prandaj, sikur të mos kishte pasur dobi nga të biseduarit për ata, nuk do të kishte lejuar të bisedohet në lidhje me ata (*beni israilët*) e as nuk do të kishte urdhëruar për biseda të tilla. Sikur të lejohet që t’u besohet atyre, thjesht vetëm se është treguar ndonjë tregim për ata, nuk do të kishte ndaluar që atyre t’u besohet. Prandaj, njerëzit (shpirtrat) kanë dobi në ato sende që supozojnë dhe mendojnë se ato në vende dhe raste janë të besueshme dhe të vërteta.

Nëse hadithet në lidhje me veprat e mira përmbajnë në vete sasi dhe përkufizim të caktuar, si për shembull faljen e namazit në kohë të caktuar, me lexim të caktuar dhe me cilësi dhe mënyrë të caktuar, kjo nuk lejohet kështu, sepse të bëhet mustehab kjo cilësi e caktuar, nuk është vërtetuar me argument nga sheriatit (argument legjitim). Përkundër asaj, nëse transmetohet diçka në lidhje se, nëse dikush futet dhe hyn në treg dhe thotë: **Lailahe il-lall-llah**, ai do të shpërblehet me kaq e kaq, sepse të përmendurit e Allahut në treg është mustehab, sepse ajo është përmendje (e Allahut) në mesin e gafilave (të shpërkujdesurve). Ashtu siç ka ardhur në hadithin e njohur: “*Përmendësi* (ai që përmend) *i Allahut në mesin e gafilave* (të shpërkujdesurve) *është sikur pema e gjelbër në mesin e pemëve të thata*.”

Ndërkaq, sasia dhe vlerësimi i shpërblimit, që është transmetuar në të, as nuk bën dëm nëse vërtetohet, e as nëse nuk vërtetohet ai (shpërblimi). Mu për këtë ka ardhur (është transmetuar) hadithi të cilin e ka transmetuar Tirmidhiu: “*Kujt i ka ardhur* (është informuar) *prej Allahut për ndonjë send* (diçka, ndonjë gjë), *në të cilin ka mirësi* (vlerë) *dhe me atë ai ka vepuar duke shpresuar atë të mirë dhe vlerë, Allahu atij do t’ia japë atë edhe nëse ajo nuk është ashtu*.”

Përfundimi i kësaj është se në këtë kapitull (në këtë temë) transmetohet dhe vepohet me të (hadithin daif) në ngjalljen e dëshirës për veprim (ar. tergib) dhe tërheqjen frikë (ar. terhib), jo në mustehabb. Pastaj (ndërsa) sasia e shpërblimit dhe ndëshkimit varet nga argumenti i sheriatit (argumenti legjitim).

Në bazë të kësaj që shënuam këtu për Imam Ibni Tejmijen dhe atë që kemi shënuar më parë, kur kemi shënuar se Imam Ibni Tejmije lejon të vepohet me hadithin daif, mund të përfundohet se ky imam lejon të vepohet me këtë lloj të hadithit, por ai për veprimin me këtë hadith vë disa kushte:

Hadithi i tillë të tregojë për ndonjë vepër, ligjshmëria e së cilës është vërtetuar përmes argumenteve të tjera, siç është rasti me leximin e Kuranit, të dhikrit, tesbihit, të larguarit nga veprat e këqija etj.

Të vepuarit me hadith daif është në formë lejimi (ar. xhevap, ibaha), por jo në formë të mustehabb (ar. istihbab).

DOBËSIA E HADITHIT TË MOS ARRIJË NË SHKALLËN E HADITHIT MEVDU

Hadithit daif me të cilin vepohet ia bashkëngjiti edhe *israilijatat*, ëndrrat e njerëzve të mirë, *fjalët e salefit* dhe ngjarjet e dijetarëve.

Ndërkaq, hadithet që përmbajnë në vete sasi dhe përkufizime, për shembull: faljen e namazit në kohë të caktuar, me lexim të caktuar dhe me cilësi dhe mënyrë të caktuar, të cilat nuk janë të ligjësuara me argument të vërtetuar, në këto nuk lejohet të vepohet me hadith daif.¹⁶ E gjitha është: dobësia e hadithit të mos arrijë në shkallën e hadithit *mevdu*.

Shejh Muhamed Nuh Nexhati (Muhamed Nasirudin Albani) është njëri nga dijetarët më të njohur i cili ndaloj dhe kundërshtoi të vepuarit me hadithin daif. Qëndrimin e tij ai e shënoi në hyrjen e disa veprave, të cilat ai i recensoi, si për shembull ai vlerësoi hadithet sahiha dhe ato daife në sunenin e “Ebu Davudit, Tirmidhiut, Nisaiut dhe Ibni Maxheh (ar. Kutub sunen erbeati)”, pastaj librin “Edebul mufred” të Imam Buhariut, librin “Tergib ve terhib” të Imam Mundhiriut dhe librin “Xhamius-sagir” të Imam Sujutiut.

Sa për ilustrim do të shënojmë qëndrimin e tij ashtu siç e ka shënuar në veprën e tij “*Silsiletu-daife السلسلة الضعيفة*”, ku ndër tjera thotë: Prej fatkeqësive më të mëdha, të cilat zbriten (i përfshin) mbi myslimanët që nga periudhat e para, është përhapja dhe shpërndarja e haditheve daife (të dobëta) dhe mevdua në mesin e tyre (myslimanëve). Nuk përjashtoj asnjërin prej tyre, edhe nëse ata janë dijetarët e

tyre, përpos atyre që deshi Allahu nga dijetarët e hadithit dhe kritikuesit e tij (të hadithit), siç janë Buhariu, Ahmedi, Ibni Meini, Ebu Hatimi dhe disa të tjerë. Përhapja e tij (hadithit daif) shkaktoi prishje të shumta, disa prej tyre (prishjeve) ishin në çështjet e besimit të padukshëm dhe disa prej tyre në çështjet e legjislacionit.¹⁷

(Punimi, në disa vazhdime, është temë diplome e autores në FSHI)

¹ Muhamed Axhxhaxh Hatib, *El-vexhiz fi ulumil hadith*, matbaatul xhedide, Damask, 1401-1402 / 1981-1982, fq. 325. Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tebtiki ve da’va, Darul juri darul minxaxhi, Medine Munevvere, 1438 H - 2017 M, fq. 136. Es-sujuti, Hafidh Xhelaluddin Abdurrahman, *tedriburr-r ravi fi sherhi tekribun nevani*, mektebetu darut turathi, Kajro, 1973, fq. 198.

² Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tebtiki ve da’va, Darul juri darul minxaxhi, Medine Munevvere, 1438 H - 2017 M, fq. 127.

³ Ibni Sejjidin-nas, Ebu Fet’h Muhamed Ibni Muhamed Ibni Muhamed, *ujunul ethri fi fununil megazi vesh-shemali ves-sijeri*, daru turath, medine munevvere & Darul fikri, Bejrut, 1/54, 59 dhe 61.

⁴ Mefhumul muhalefeti do të thotë: T’i vërtetohet çështjes së heshtur dispozita e kundërt nga ajo që është kuptuar nga shprehja. (T. Bislimi, Hyrje në usuli fikh, 511.

⁵ Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tebtiki ve da’va, Darul juri darul minxaxhi, Medine Munevvere, 1438 H - 2017 M, fq. 172.

⁶Po aty, 36.

⁷ Ibni Kajjim el-Xhevzije, Imam Shemsuddin Ebu Abdullah Muhamed ibni Ebu Bekr, *Zadul meadi fi hedji hajril ibadi*, muessesetur rivale, Bejrut & Mektebetul menarul islamije, Kuvajt, 1405 H - 1985 M, 4/60.

⁸ Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tebtiki ve da’va, Darul juri darul minxaxhi, Medine Munevvere, 1438 H - 2017 M, fq. 175.

⁹Po aty, 180.

¹⁰ Po aty, 180.

¹¹Po aty, 193.

¹² Ibni el-Arabij, Imam Hafidh Ebu Bekr Muhamed Ibni Abdullah Ibni Muhamed Andalosi Ishbili, *El-mesalik fi sher muvt-ta malik*, dar garbul islami, 1428 H, 3/487.

¹³ Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve tebtiki ve da’va, Darul juri darul minxaxhi, Medine Munevvere, 1438 H - 2017 M, fq. 194.

¹⁴Po aty, 195.

¹⁵ Po aty, 195.

¹⁶Po aty, 212.

¹⁷ Albani, Muhamed Nasruddin, *Silsiletu ehadith daife ve mevdua*, Darul mearif, Rijad, 1412 H, 1/47.

BFI, NJË LIDHJE E QENDRAVE ISLAME

Përpjekjet me intensitet më të theksuar rreth formimit të saj nisën qysh në nëntor të vitit 2012. Ajo lindi si nevojë e domosdoshme e kohës për mërgatën shqiptare në përgjithësi dhe në veçanti të shqiptarëve të Qendrave islame, që të ulen e të bisedojnë mes vete, për të marrë përgjegjësinë fetare në këtë shtet. Më parë shumica e shqiptarëve i kryenin ritualet fetare dhe punët kombëtare në objektet e përbashkëta me komunitetet tjera.

Shkruan: Zejnulla Sadiku

U.A.M.I. në planprogramin e saj ka dhe aktivitetin e seminareve, të cilat i ka zhvilluar me përmbajtje dhe tematika të ndryshme fetare. Në këto seminare janë ftuar hoxhallarë dhe njerëz të përgatitur nga lëmenj të ndryshëm si brenda Italisë, ashtu dhe nga jashtë. Seminaret janë zhvilluar në periudha kohore për dy ditë, në disa vende të ndryshme. Gjatë kohës së pandemisë Covid-19 kjo ka funksionuar në distancë, përmes rrjetit social zoom. Një nga temat e seminareve të mbajtura ishte: *Përshkallëzimi i misionit profetik*, i mbajtur më 26 mars 2021¹

Projekti i Institutit për Studime Fetare, i Unionit të Shqiptarëve Myslimanë

në Itali, lindi si nevojë e një gjenerate aktivistësh të angazhuar në thirrjen islame në Itali. Instituti është i shtrirë në një periudhë 3-vjeçare, me takime periodike në klasë dhe mësim në distancë. Projekti filloi me 23 vijues të regjistruar. Në program parashikohen 12 referenca nga lëmenj të ndryshëm fetarë (një libër çdo 3 muaj), duke nisur nga shkencat e Kur'anit, hadithit, historisë islame, usulifik'hut etj.

Disa nga titujt e librave që janë trajtuar e shpjeguar nga prof. Sabahudin Jashari dhe Rushit Musallari, janë: "Si të bashkëveprojmë me Sunnetin" (Jusuf Kardavi), "Fikhu Sira" i Imam Gazaliut, "40 hadithet" i Imam Neveviut, "Besimi: bazat - esenca - negacioni" i autorit Muhamed Nuajm Jasin.

BASHKËSIA FETARE ISLAME NË ITALI (BFII)

Ideja për themelimin e Bashkësisë Fetare Islame të Italisë ka filluar qysh herët, por përpjekjet me intensitet më të theksuar rreth formimit të saj nisën qysh në nëntor të vitit 2012. Pra, lindi si nevojë e domosdoshme e kohës për mërgatën shqiptare në përgjithësi dhe në veçanti të shqiptarëve, të qendrave islame në Itali, që të ulen e të bisedojnë në mes vete, për të marrë përgjegjësinë fetare në këtë shtet. Më parë shumica e shqiptarëve i kryenin ritualet fetare dhe kombëtare në objektet e përbashkëta me komunitetet tjera. Themelimit të saj i kanë paraprirë paraprakisht disa takime me Qendrat islame në Itali. Deri atëherë Qendrat janë vetorganizuar rreth pritjes e përcjelljes së

muajit të Ramazanit, përgatitjes së imsa-kijeve e kalendarëve, fillimit e mbarimit të muajit të Ramazanit. Në Itali kishte nevojë të krijohet një strukturë organizative, e cila rreth vetes do të tubonte imamët dhe Qendrat shqiptare me strukturat udhëheqëse.

Duke i pasur parasysh këto rrethana, janë zhvilluar disa takime radhazi prej nëntorit të vitit 2012 e deri në shtator të vitit 2013. Pas disa takimeve të suksesshme dhe komunikimeve mes imamëve dhe Qendrave në Itali, me ndihmën e Allahut të madhërisëm u arrit që të harmonizohet qëndrimet dhe u vendos që të themelohet Bashkësia Fetare Islame e Italisë. Kështu, pra, më 3 nëntor 2013 në Qendrën Islame Shqiptare "Nur-Drita" në Pessaro erdhi deri te themelimi i Bashkësisë Fetare Islame, si dhe zgjedhja e organeve drejtuese dhe përpilimi i statutit. Në foto shihet që në këtë takim nga hoxhallarët ishin: Reshat Ibishi, Altin Braka, Gazmend Agushi, Zejnulla Sadiku, hoxhë Skenderi (...), Naser Baftiu, si dhe përfaqësues të xhamive. Duke pasur parasysh territorin e gjerë të Italisë, ka pasur vështirësi të mëdha derisa janë gjetur qendrat shqiptare, por në fund, me ndihmën e Allahut, kjo është arritur. BFI është një lidhje e qendrave islame në mbarë Italinë, dhe si e tillë ka për qëllim t'i përfaqësojë dhe t'i avancojë interesat e të gjithë anëtarëve në mbarë rajonin që mbulojnë këto qendra. Në ditën e themelimit të BFI-së së Italisë, përkatësisht më 3.11.2013 në selinë e dytë të saj, në xhaminë "Nur-Drita" në Pessaro-Urbino, në

Gallo, u mbajt mbledhja e parë zyrtare, ku nga gjithsej 28 qendraⁱⁱⁱ që deri atëherë u paraqitën, për shkak të largësisë dhe territorit të madh morën pjesë 23 qendra islame.

Secila qendër firmosi deklaratën me shkrim për pranimin dhe zyrarizmin e BFII-së, që t'i përfaqësojë në përgjithësi në instancat dhe nivelet e larta shtetërore në Itali dhe jashtë saj. Më pas edhe disa Qendra të tjera që janë bërë pjesë përbërëse e BFII-së. Koordinimet bëhen me konsensus të përbashkët. Komunikimet shpesh bëhen përmes shfrytëzimit të mjeteve elektronike të komunikimit: what's app, facebook, viber, skype... po edhe drejtpërsëdrejti, gjatë vizitave tona që i bëjmë bashkërisht me anëtarët dhe organet tjera të BFII-së.^{iv}

Bashkësia Fetare Islame e Italisë ka paraparë që të shtrijë ndikimin e saj në sfera të ndryshme, të shumta, me aktivitete në planin fetar dhe kombëtar në gjithë territorin e saj. Kjo BFII-në e bën tamam si një bashkësi serioze dhe të shëndoshë islame, me plot kuptim, në të gjitha fushat ekzistuese.

Më 1.11.2013 është organizuar një solemnitëti i madh me rastin e njëvjetorit të BFII-së. Kishte mysafirë nga shumë vende të Evropës, përfaqësues nga Austria, Zvicra, në mesin e të cilëve ishte edhe Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë, Reis'ul-Ulema Sulejman ef. Rexhepi. Qëllimi i këtyre organizimeve është që të mbahen lidhjet e mërgatës me vendlindjen.

Krahas solemniteteve për bajrame,

rregullisht janë organizuar manifestime solemne për shënimin e 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit, si dhe për shënimin e 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Kosovës.

Në këto manifestime vazhdimisht janë ftuar mysafirë nga autoritetet lokale italiane dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme, të cilët e nderojnë BFII-në me prezencën e tyre. Xhamitë, përmes kultivimit të ndjenjave fetare, kanë edhe rolin e kultivimit të ndjenjave kombëtare. Kemi mbështetur dhe mbështesim aktivitetet kulturore të shoqërive artistike, ndërsa shpesh pjesëmarrësit kanë ardhur dhe i kanë vizituar xhamitë, me ç'rast u janë dhënë broshura e materiale islame.

Disa vite me radhë nga xhamia "Nur-Drita" e Casaloldos dhe në disa xhami në Itali është organizuar edhe aksioni humanitar tradicional "Dije: Gjaku yt shpëton jetën e një njeriu!". Kjo traditë e dhurimit vullnetar të gjakut bëhet në shenjë solidarizimi me qytetarët, të cilët kanë nevojë për gjak. Para aksionit mbahen edhe seminare, për të sensibilizuar qytetarët që të japin gjak për të mirën e shëndetit të tyre, por edhe për të ndihmuar njerëzit që kanë nevojë.^v

RAPORTET ME KOMUNITETET TJERA

U.A.M.I. mund të themi se që nga fillimi ka qenë e hapur për bashkëpunim, jo vetëm për slogan: janë bërë lëvizje, ka pasur pjesëmarrje aty ku është ftuar dhe gjithmonë në takimin vjetor të saj janë ftuar dhe përfaqësues të shoqatave të tjera



Nga aktiviteti i Institutit të UAMI.




Përvjetori i themelimit të BFII në Bolonja, 2014.

islame në Itali, kryesisht Unionet e shoqatave arabe etj. Gjithmonë ka pasur bashkëpunim.

Gjithashtu, Shoqata edhe me vendlindjen ka qëndruar në kontakt si: me Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe Shqipërinë, por dhe me Mali Zi, edhe pse pjesëmarrësit aty ishin mbi 90% shqiptarë të Shqipërisë që vinin tek takim vjetor ose takimet ose aktivitetet tjera. Sidoqoftë, kjo ka qenë fryma që të mos humben kontaktet dhe të mos vijë tek izolimi në një grup të ngushtë. Janë bërë përpjekje që kontakte të vihen edhe me komunitetet tjera në Itali, që janë të shumta, si p. sh. me komunitetin nga Bangladeshi, nga Nigeria, Senegali etj. Shoqata natyrisht ka qenë në kontakt me arabët dhe gjithmonë ka pasur bashkëpunim. Në takime janë ftuar profesorë universitar, përfaqësues nga Kisha, ndërsa aktivitetet janë transmetuar edhe nga disa radiotelevizione. U.A.M.I ka qenë pjesë e konsultës tek Ministria e Brendshme "Konsulta për Islamin në Itali", si dhe në vitin 2017 ka firmosur paktin për njohjen e Islamit si fe zyrtare në Itali. Kjo ishte një marrëveshje shumë pozitive, me të cilën u fillua që myslimanët të kenë disa favore, duke filluar nga njohja e të drejtës së hoxhallarëve që të shkonin të kryenin aktivitetet nëpër burgje dhe që t'u njihet autoriteti nga Ministria e Kultit. Pra, si në marrëdhënie me publikun, me shoqatat, me shoqërinë civile dhe me fetë tjera, U.A.M.I. ka qenë aktive aq sa ka pasur mundësi, sepse nuk është edhe një shoqatë e madhe për t'u hapur në shumë drejtime. Si e tillë, ajo ka dhënë kontribut dhe ka qenë e pranishme gjithandej ku është dashur të jetë. Me rëndësi është që U.A.M.I. përmendet dhe është mirë që ata që studiojnë në nivel akademik në Itali, e njohin atë dhe e kanë përmendur në studimet e tyre.^{vi}

Raportet e BFII me komunitete tjera kanë qenë të hapura: ka pasur disa takime ndërfaqetare në qytetin e Laquillas, në takim ka qenë prezent edhe Kryetari i qytetit të Laquillas dhe 4 priftërinj të provincës së Abruzzos.

Titulli i takimit ka qenë "Dhuna nuk ka emër": çdo fe e dënon terrorin, në asnjë fe nuk ka dhune; pastaj takimi në bashkëpunim me RABITA-n në qytetin e Romës etj. Ka pasur takime diplomatike me Ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me Kryetarë komunash, me udhëheqës në nivel të Republikës së Maqedonisë së Veriut; gjithashtu, ambasadori i Maqedonisë së Veriut shpesh e ka vizituar këtë Qendër, me të është marrë pjesë në disa takime folklorike, në promovime librash



Xhamia e madhe në Romë.

dhe të disa shoqatave joislame shqiptare këtu në Itali. Gjithashtu, Shoqata ka bashkëpunim edhe me Bashkësitë Islame vendore, si atë Maqedonisë së Veriut, të Kosovës dhe të Shqipërisë.^{vii}

XHAMITË NË ITALI

Luca Baucio, një avokat penalist italian nga Milano, i cili prej vitesh është marrë me diskriminimin në adhurimin fetar, në veçanti atë islam, me pakicat fetare më të rëndësishme në Itali, thotë: "Të thuash që myslimanëve u mohohet liria e adhurimit në Itali në përgjithësi, do të ishte e pasaktë, nëse vetëm dikush merr parasysh praninë në të gjithë gadishullin - të xhamive dhe të qendrave islame, ku bashkësia islame dhe myslimanët lirisht mund të mbledhen dhe të luten. Por, të thuash se ka raste në të cilat me Kushtetutë u mohohet e drejta, kjo i përmbahet realitetit. Në fakt, nuk mungojnë administratorë të cilët haptas deklarojnë 'jo xhami'. Kur flasim për të drejtën e lutjes dhe adhurimit, ne po flasim për një të drejtë kushtetuese, e cila - si e tillë - nuk mund të kufizohet dhe mbi të gjitha ka një vlerë që tejkalon çdo ligj ose rregullore rajonale ose komunale. E drejta garantohet me nenin 19 të Kushtetutës: 'Çdokush ka të drejtë të deklarojë lirshëm besimin e tij fetar në çdo formë, privatisht ose publikisht, për sa kohë që nuk është një ritual në kundërshtim me moralin.' Vendimi i Këshillit të Shtetit, në thelb, bën dallimin midis së drejtës për lutje dhe së drejtës për vend adhurimi. E drejta për lutje nuk mund të parandalohet kurrë. E drejta e vend adhurimit gjithashtu nuk

mund të parandalohet, por duhet të ushtrohet brenda ligjeve të planifikimit urban. Këshilli i Shtetit për xhamitë thotë se duhet të ndërtohen në përputhje me planin rregullues dhe ligjet e planifikimit urban. Por, kjo nuk do të thotë që myslimanët nuk mund të luten", shpjegon avokati.^{viii}

Sipas të dhënave të përditësuara më 31 gusht 2016, të marra nga Policia e Shtetit dhe në pronësi të Ministrisë së Brendshme, në Itali gjithsej ka 1.251 mesxhide, ku nga shteti njihen si shoqata ose vende të kultit, por jo si xhami.^{ix}

Vendi më i vështirësuar për këto çështje (ndërtimin e xhamive) në nivel evropian është Italia. Është vërtet shumë e vështirë të ndërtohet një xhami, ose të konvertosh një ndërtesë ekzistuese në xhami. Kushtetuta italiane garanton lirinë fetare dhe kjo mund të shihet në nenet 3, 7, 8, 19, 20 të saj.

Ligjet shumë të vjetra dhe të pazbatuara ose të përditësuara, janë një realitet i larmishëm i Islamit italian, të cilat nuk janë pa pika fërkimi brenda tij. Vullnetet e diskutueshme politike, vështirësitë e lidhura me çështjet e imigracionit - japin të kuptosh se për momentin themelimi i një vendi të kultit islam (hapje të xhamisë) është jashtëzakonisht e komplikuar për komunitetet myslimane.^x

Sekretari e UCOII dhe koordinator i Bashkësisë Islame të Bolonjës, në një intervistë është shprehur: "Është e vërtetë se sot mundësia për të pasur një vend për t'u lutur (xhami) komuniteti mysliman italian, varet ekskluzivisht nga disponueshmëria dhe fleksibiliteti i Kryetarëve të bashkive dhe administratave komunale,

pasi nuk ka asnjë ligj kombëtar që rregullon hapjen e xhamive ose dhomave të lutjeve islame.^{xi}

Italia është e katërt për popullatën më të madhe myslimane në Evropë, por ka një problem me mungesën e xhamive. Ka një total prej tetë xhamive, me një sipërfaqe vetëm të dedikuar për lutje, si dhe elemente të njohura arkitektonike si një kupolë ose një minare, ku myezini e thërret ezanin për namaz. Për krahasim, Franca, e cila ka një popullsi myslimane tre deri në katër herë më të madhe se Italia, ka 2.200 xhami, ndërsa në Mbretërinë e Bashkuar, me një popullsi myslimane rreth dy herë më shumë se Italia, ka 1.500 xhami.

Sipas Maria Bombardierit, një studiuese shkencore në Universitetin e Padovës dhe autore e librit "Xhamitë e Italisë", ka rreth 800 qendra kulturore dhe mesxhide të cilat janë dhoma joformale për namaz, të strehuara shpesh në garazhe, bodrume dhe depo. Ato funksionojnë si një vend adhurimi dhe një vend takimi kulturor dhe arsimor. Mungesa e xhamive aktuale është shkaktuar nga disa faktorë. Së pari, Islami nuk njihet zyrtarisht nga Italia siç njihet Kisha; edhe nëse ka pasur një mënyrë të lehtë për të marrë financime publike për xhami, leja për të hapur xhami vështirë merret nga autoritetet dhe ndërtimi është kundërshtuar shpesh nga komunitetet lokale.^{xii}

Lista e xhamive:

- Në vitin 1988 inaugurohet Xhamia në Segrate (e para në Itali me një kupolë dhe minare).
- Në vitin 1995 inaugurohet Xhamia e Romës (më e madhja në Evropë deri në 27 shtator 2012).
- Në vitin 2012 inaugurohet Xhamia e Re në Catania (më e madhja në jug të Italisë).
- Në vitin 2013 inaugurohet Xhamia në Albenga (më e madhja në rajonin Liguria).
- Në vitin 2013 inaugurohet Xhamia e Torinos.
- Në vitin 2013 inaugurohet Xhamia në Ravenna (kjo është xhamia e dytë më e madhe në Itali, pas asaj të Romës).
- Në vitin 2013 inaugurohet Xhamia në Colle Val d'Èsa në Siena.
- Në vitin 2017 inaugurohet Xhamia në Forlì.^{xiii}
- Në vitin 2021 inaugurohet edhe Xhamia në Piacenza, si dhe Xhamia Rogno.^{xiv}

QENDRAT (MESXHIDET) SHQIPTARE

Themelimi i xhamive në mërgatë ka qenë një nga hapat më të qëlluar të po-



Xhamia "El-Hilal" në Grosseto.

pullatës sonë për ta mbrojtur identitetin dhe për t'i kultivuar vlerat fetare dhe kombëtare te brezat e rinj. Xhamitë tek mërgata kanë qenë institucionet më të rëndësishme të frymëzimit të popullatës myslimane dhe bartëse kryesore e aktiviteteve madhore që kanë qenë në funksion të kauzës sonë fetare dhe kombëtare, si dhe që kanë synuar ta mbrojnë indin fetar dhe kombëtar të popullatës sonë, në veçanti në aspektin arsimor, përmes mejtepeve, dhe aspektin humanitar, përmes grumbullimit të ndihmave në mënyrë të vazhdueshme.^{xv}

Të flasësh për xhaminë, do të thotë të flasësh për një institucion i cili prek çdo shtresë të shoqërisë dhe reflekton me ndikimin e vet në të gjitha poret e jetës. Kjo, ngase xhamia nuk është thjesht një faltore ku kryhen vetëm lutje dhe adhurime në kuptimin e ngushtë të fjalës *lutje dhe adhurim apo falje*, por xhamia ka një rol polidimensional, si për individin, ashtu dhe për shoqërinë.^{xvi}

Kërkesa e shqiptarëve për të hapur xhami në Itali për herë të parë është bërë në vitin 1997, ndërsa ajo u pranua nga autoritetet komunale në mars të vitit 1998. Kërkesa është bërë nga një grup xhemaatlinjsh shqiptarë, të cilët kanë jetuar, punuar dhe vepruar në provincën Pesare Urbino. Iniciues të saj ishin Jonuz Memeti, Ajet Islami, Nezir Bakija, Ferat Sulejmani dhe disa të tjerë. Kështu që, lindi Komuniteti Islam në Pesaro Urbino në kuadër të U.C.O.I.I.

Pastaj, më vonë, më 3 maj 2005 bëhet themelimi dhe hapja e xhamisë "Nur-Drita" në Mantova, përkatësisht në Casaloldo. Si iniciues dhe themelues i kësaj qendre ka qenë Halil Kastrati, në të cilën qendër ka shërbyer edhe imam. Pastaj hapja e xhamisë "Fat" në Pergine dhe Cembra – Trentino.^{xvii}

Xhamia "El-Hilal" në Grosseto është themeluar me iniciativën e bashkatdhetarëve tanë në mars të vitit 2010. Në këtë xhami ka shërbyer si imam nga themelimi i saj deri në prill të vitit 2019 edhe autori i këtij punimi.

Më vonë bëhet hapja e qendrave të tjera, si:

- Xhamia Nur-Drita në Gallo di Petriano- Pesare Urbino
- Xhamia Hëna e Re në Forlì
- Xhamia Nur-Drita në L'aquila
- Xhamia Blu në Ciaravale Ankona
- Qendra islame kosovare Pendimi në Bolonja.
- Xhamia Iman në Teramo.
- Xhamia Humana në Perugia
- Xhamia Mugello në San Lorenzo-Firencë
- Xhamia Hëna e Re në Montespertoli-Firencë
- Xhamia Hëna e Re në Bibiena-Arezzo
- Xhamia Teuhit Jakup Asipi në Guastalla.
- Qendra Kulturore Shejh Albani, Cereeto D'esi
- Shoqata Shqiptare në Liguri, në Genova.^{xviii}



Pamje nga realizimi i intervistës me Imam Zejnulla Sadikun nga gazetari Stefano Vidori (TGR).

AKTIVITETET E QENDRAVE SHQIPTARE NË ITALI

Xhamitë në mërgim kanë qenë institucionet më të rëndësishme të frymëzimit të popullatës myslimane dhe bartëse kryesore të aktiviteteve madhore. Drejtori i Sektorit të Mërgatës pranë Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dr. Selver Xhemaili, në fjalën e tij thotë: “Besimtarët mysliman shqiptarë, të cilët kudo që janë në mërgim, janë duke treguar një vetëdije të lartë fetare-kombëtare dhe ky fakt po dëshmohet edhe me vepra konkrete.^{xix}

Reis’ul-Ulema i BFI të RMV h. hfz Sulejman ef. Rexhepi (është koha kur ky ka qenë Kryetar i BFI-së) nënvizon virtytin e shqiptarëve gjithandaj në shtetet e Perëndimit, të cilët manifestojnë një kujdes të veçantë në shprehjen e ndjenjave të tyre fetare islame: “Kudo që kam pasur takime me autoritetet e larta të shteteve ku jetojnë dhe veprojnë shqiptarët përkatës të fesë islame, kam dëgjuar fjalë miradije dhe për këtë krenohem. I ftoj vëllezërit e mi shqiptarë që të vijnë edhe më tej që me kulturën shqiptare, me fenë, me respektin dhe me të gjitha vlerat e mrekullueshme kulturore e civilizuese, të lënë përshtypje pozitive te banorët vendës, si dhe tek autoritetet e shteteve perëndimore.^{xx}

Drejtori dr. Selver Xhemaili, i shoqëruar nga imami i Xhamisë së Rinisë në Tetovë, hfz. Ibrahim Alija, kanë vizituar xhematet shqiptare në Itali, përkatësisht Xhaminë Drita në Laquila dhe Xhaminë Shqiptare në Teramo. Më 7 prill 2018, pas namazit të iqindisë në Xhaminë Drita në Laquila u zhvillua tribuna me titull “Xhamia dhe adhurimi - kultivues të mirësjelljes në shoqëri”.^{xxi}

Në kuadër të shoqatave dhe xhamive nuk kanë munguar as edhe aktivitetet sportive dhe kulturore ndërmjet komuniteteve të ndryshme islame dhe joislame,

të organizuara nga shoqatat lokale për integrimin e të huajve në shoqërinë italiane. Më 10.05.2015 rinia e Xhamisë El-Hilal në Grosseto mori pjesë në Turneun e organizuar në futboll nga Uisp-Grosseto, me pjesëmarrje të disa ekipeve nga disa komunitete të tjera, të ndryshme, që jetojnë dhe veprojnë në qytetin e Grossetos, ku si fitues në vendin e parë doli ekipi i Xhamisë El-Hilal, duke marrë medalje nga Uisp në emër të Xhamisë dhe për këtë mirënjohjet i shkojnë rinisë së Xhamisë. Allahu i ruajt dhe i bëftë të hairit dhe shembull për të mirë.^{xxii}

BASHKËPUNIMI MES XHAMIVE

Imamët dhe Qendrat islame në Itali bashkëpunojnë dhe kanë raporte të shkëlqyera mes vete dhe së bashku i bashkërenditin aktivitetet e tyre. Bashkëpunimi është si në aspektin kulturor e fetar, si në aspektin social, psikologjik, duke ofruar këshilla e sugjerime, duke intervenuar në raste të veçanta për zgjidhjen e problemeve familjare. Gjithashtu, përmes debateve, tribunave e diskutimeve shikohet të depërtohet në shoqëri, për të artikuluar sa më mirë e në mënyrë dinjitoze qëndrimet, të cilat vijnë nga Kurani dhe Sunneti. Deri më tani shqiptarët kanë qenë një shumicë e heshtur dhe nuk u është dëgjuar zëri sa duhet, duke mos qenë zë i fuqishëm në përballje me realitetin aktual. Kështu shprehet Reshat Ibishi, Kryetar i BFII.

Raportet me institucionet janë të mira, në nivel të dukshëm. Shpesh komunikohet dhe kërkohet stabilitet ndërmjet Qendrave tona nga Ministria e Brendshme. Bashkëpunimi më i dukshëm është me Ministrinë e Kulturës, me të cilët jemi në bashkëpunim.^{xxiii}

Prej aktiviteteve është edhe pjesëmarrja e imamit të Xhamisë, Zejnulla Sadiku dhe e Kryesisë së Xhamisë El-Hilal

në konferenca për media dhe në takime me institucionet shtetërore dhe ato fetare, me Kishën katolike në qytetin e Grossetos në vitin 2015 (tema ishte: Islam Toscana Contro terrorismo - Islami në Toskana kundër terrorizmit) etj.^{xxiv}

(Teksti që po botojmë këtu në vazhdimë është punim diplome, FSI, Prishtinë, 2021. Mentor: dr. asoc. Fahrush Rexhepi. Përpunimi: “Hëna e Re”. Sqarim: Për shkak të vendit, nuk janë dhënë të gjitha fotografitë e dorëshkrimit.)

- ⁱ <http://uamionline.it/u-zhvillua-seminari-me-titull-edukimi-i-f%26d1%91mij%26d1%91ve-sipas-m%26d1%91simeve-t%26d1%91-islamit/>
- ⁱⁱ <http://uamionline.it/corso-avanzato-degli-studi-islamicici-parte-3/>
- ⁱⁱⁱ <http://uamionline.it/apre-i-battenti-il-corso-avanzato-di-studi-islamicici/>
- ^{iv} Disa qendra që kanë prezantuar kanë qenë nga kuadri dhe menaxhimi i xhamive dhe komuniteteve të tjera, përgjithësisht arabe; gjithashtu tri Qendra ishin të nacionalitetit torbesh (maqedonas-muslimanë).
- ^v Reshat Ibishi intervistën e realizuar përmes zoom-it më 17 mars 2021.
- ^{vi} Reshat Ibishi në intervistën me zomm dhe portalin Paqja, e cituar.
- ^{vii} Altin Braka, Kryetar i UAM-it; intervistë e bërë me zoom me 4 mars 2021.
- ^{viii} Reshat Ibishi, intervistë e cituar.
- ^{ix} <https://www.osservatoriodiritto.it/2019/08/13/liberta-di-culto-in-italia-costituzione-islam/>
- ^x <https://www.agensir.it/italia/2016/11/17/in-italia-1-251-luoghi-di-culto-islamico-panorama-fluido-privo-di-una-normativa-quadro/>
- ^{xi} Davide Tacchini, Islam e integrazione in Italia, tetor 2014, pg. 104.
- ^{xii} <https://ucoii.org/2018/03/23/legge-nazionale-moschee>
- ^{xiii} <http://mediaelire.net/lajm/4868/mbi-16-milione-muslimane-ne-itali-por-vetem-tete-xhami/>
- ^{xiv} <https://it.quora.com/Quante-moschee-esistono-in-Italia>
- ^{xv} <https://montagnepaesi.com/inaugurata-la-moschea-a-rognosara-111-in-italia/>
- ^{xvi} <https://www.laluce.news/2021/03/26/una-moschea-ufficiale-per-la-comunita-di-piacenza-parla-arian-kajashi>
- ^{xvii} Bashkim Aliu, Roli i xhamisë në mbrojtjen e identitetit fetar dhe kombëtar në Perëndim, Shkup, 2016, fq. 84.
- ^{xviii} <https://www.tetovasot.com/2019/12/fatkeq-seite-natyrore-dhe-rol-i-humanitar-i-xhamive-te-shqiptareve-ne-diaspore/>
- ^{xix} Jonuz Memeti, ish-nënkryetar i BFII dhe iniciues i themelimit të saj, si dhe ish-kryetar i Xhamisë Drita në Gallo.
- ^{xx} Reshat Ibishi, Altin Braka, cituar.
- ^{xxi} Revista mujore informative islame “Hëna e Re”, nr. 325, shtator-tetor, 2018, fq. 7.
- ^{xxii} Revista mujore informative islame “Hëna e Re”, nr. 319, prill, 2018, fq. 10.
- ^{xxiii} Revista mujore informative islame “Hëna e Re”, nr. 319, prill, 2018, fq. 16.
- ^{xxiv} Rauf Emimi, Kryetar i Xhamisë dhe shoqatës “El-Hilal” në Grosseto. Intervistë, 24 mars 2021.
- ^{xxv} Reshat Ibishi.
- ^{xxvi} <https://www.rainews.it/dl/rainews/TGR/media/Toscana-islam-contro-terrorismo-9d52c44a-72fc-4528-bca2-1c8a8ba58767.html>

NGUSHËLLIME PËR FAMILJEN RAMADANI



Me rastin e ndërrimit jetë të të riut nga Kumanova Erdon Ramadani, shprehim dhimbjen tonë të thellë. Humbja e këtij të riu shqetësoi pa masë dhe dhimbja u bë pjesë e gjithë kombit dhe popullit. Andaj, në emër të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, në emrin tim, familjes së të ndjerit i shprehim ngushëllime të thella, merhumit - të ndjerit Allah u plotfuqishëm t'i falë xhenetin e Tij të amshueshëm, duke e përfshirë në mëshirën e Tij të pakufishme, ndërsa familjes - durim të paluhatshtëm, thuhet në telegramin e ngushëllimit të Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu drejtuar familjes Ramadani nga Kumanova.

Më 4 tetor, 2022, të udhëhequr nga Myftiu i Kumanovës, h. Abedin ef. Imeri, vizituam për ngushëllime familjen Ramadani me rastin e ndërrimit jetë të të riut Erdan Ramadani, thuhet në njoftimin e Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu publikuar në faqen vet në Facebook.

Shprehëm ngushëllimet tona në emër të BFI të RMV dhe të institucioneve të saj. Babain Naserin me familjen e tij i gjetëm me një durim të nivelit të lartë, që tregon besimin e paluhatshtëm në caktimin e Allahut fuqiptotë.

Ne i dëshiroam qëndrueshmëri, durim dhe përkrahje në këto momente të

vështira.

Edhe një herë i bëjmë lutje Allahut fuqiptotë që familjes t'i japë fuqinë e imanit dhe të durimit në këto momente të rënda dhe pikëllimi, të ndjerin Allahu fuqiptotë ta përfshijë në rahmetin e Tij, duke e shpërblyer me xhenetin e amshueshëm, ka shkruar Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Më 28 tetor, 2022, ishte raportuar se “nuk është gjetur asnjë gjurmë nga i riu Erdon Ramadani nga Kumanova, i cili duke u kthyer nga Tetova me makinën Golf 4 nga autostrada ka përfunduar në lumin Vardar”. Trupi i tij është gjetur në ujërat e lumit Vardar më 2 tetor 2022.

PJEKJE NË LESHNICË TË KËRÇOVËS



Sot, i shoqëruar nga Myftinjë h. Sabahudin ef. Zendeli, mr. Salim ef. Sulejmani dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Irsal ef. Jakupi, vizituam familjen Zeqiri nga Leshnica e Kërçovës, me qëllim të shprehjes së ngushëllimeve me rastin e ndërrimit jetë të bashkëshortes së hoxhës së nderuar h. Mexhait ef. Zeqiri dhe të nënës së hoxhës së mirënjohur h. Ferit ef. Zeqiri, thuhet në njoftimin e Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu publikuar në Facebook.

Ishte obligim moral dhe institucional

që të respektojmë në këto momente të dhimbjes, sepse vetë hoxha i nderuar h. Mexhait efendiuri tërë jetën ia ka kushtuar organizimit të jetës fetare islame në Myftininë e Kërçovës - jo vetëm si imam, por edhe në funksione të ndryshme. Hoxhë Ferit Zeqiri, biri i tij, vazhdon me vetëdijen më të lartë dhe me përkushtim të jetë udhëheqës fetar i xhamisë (qendrës) më të madhe në Regensburg të Zvicrës, ku me suksesin më të madh udhëheq bashkatdhetarët tanë në ngritjen e vetëdijes islame, për të qenë në shërbim të Zotit

dhe të popullit.

Në këtë pjekje, në këtë vizitë ngushëllimi, na priu Myftiu i Kërçovës, z. Qamil ef. Rushiti, me bashkëpunëtorin mr. Xhemail Ahmeti (Sekretar).

Familjes Zeqiri i shprehëm ngushëllime të thella, duke lutur Allahun fuqiptotë që familjes t'i japë durimin e pashoq, ndërsa merhumen - të ndjerin ta shpërblejë me Xhenetul Firdeus.

Faleminderit për pritjen vëllazërore, ka shkruar Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.



Agjencia për Hallall Standard
Агенција за Халал Стандард
Helal Standard Ajansı
Agency for Halal Standard
مكتب شهادة للمنتجات الحلال



Bashkësia Fetare Islame e R.M.V.

Add: Cairska 52.1000 Skopje, North Macedonia.
Tel: + +389(0)2 3117410; 3117 412.
Fax: + +389 (0)23117 883

websait: www.bfi.mk
email: halal.bfi@gmail.com